



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 662 Akti

Nr. 734 Vendimi

Tiranë, më 22.1.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Suela Zhegu	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 18.1.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ilir Hoxha**, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Ilir Hoxha, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët: Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Roland Ilia dhe Genta Tafa (Bungo). Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.1.2021 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisioner Roland Ilia. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatorja e çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Elka Ermenkova. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, si dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:
 - *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të pasurive të përfituara me dëshmi trashëgimie nga babai;*
 - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2019.

6. AKSIK-ja² ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar.
7. KLP³-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.
8. Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues i mbledhur në datën 5.12.2023, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin mbi rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht, duke u bazuar në të tria kriteret, në vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Ilir Hoxha, njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet paraprake të hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
10. Për një proces të rregullt ligjor subjektit të rivlerësimit i janë garantuar të drejtat, si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; njoftimi mbi përbërjen e trupit gjykues; dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit. Në datën 11.12.2023, subjektit iu dërguan rezultatet paraprake të hetimit administrativ dhe iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.
11. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur pranë Komisionit kërkesën⁴ e datës 15.12.2023 për deklasifikimin e plotë të informacionit të administruar pranë AKSIK-së, si dhe vënien në dispozicion të të gjithë dokumentacionit të administruar në ngarkimin e tij nga AKSIK-ja apo çdo institucion tjetër.
11.2 Në përgjigje të kërkesës së tij, trupi gjykues, pasi e shqyrtoi atë, në datën 18.12.2023 njoftoi subjektin në rrugë elektronike, duke e orientuar se kërkesa e tij duhet të adresohet pranë KDZH-së, bazuar në nenin 5 të VKM-së Nr. 662, datë 15.11.2017, "Për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror".
12. Subjekti i rivlerësimit përmes kërkesës⁵ së datës 19.12.2023 i ka kërkuar Komisionit riçeljen e hetimit administrativ, me qëllim marrjen e informacioneve dhe provave të reja shpresore dhe thirrjen e dëshmitarëve. Trupi gjykues, me vendimin e datës 20.12.2023, pasi mori në

² Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 10.10.2022, të KDZH-së.

³ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 7.9.2018.

⁴ Kërkesë e dërguar me *email* datë 15.12.2023, si dhe shkresën e regjistruar nr. *** prot., datë 18.12.2023.

⁵ Kërkesë e regjistruar pranë Komisionit nr. *** prot., datë 20.12.2023.

shqyrtim kërkesën e subjektit, ka vendosur ta refuzojë, duke e njoftuar subjektin me arsyetimin e këtij refuzimi, në përputhje me nenin 49/6 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit përmes kërkesës⁶ datë 20.12.2023 ka kërkuar pranë Komisionit dhënien e informacionit dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit të administruar në ngarkim të tij lidhur me kontrollin e figurës. Në përgjigje të kësaj kërkesë, në datën 21.12.2023, subjekti u informua se i është vënë në dispozicion çdo informacion i deklasifikuar dhe i aksesueshëm për subjektet e rivlerësimit.
14. Përmes postës elektronike me *email*, datë 26.12.2023, subjekti ka kërkuar⁷ zgjatjen e afatit për paraqitjen e provave/shpjegimeve me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit. Komisioni, në datën 27.12.2023, i komunikoi në rrugë elektronike subjektit afatin e ri të dërgimit të parashtrimeve lidhur me kriterin e figurës, brenda datës 10.1.2024.
15. Z. Ilir Hoxha, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në prapësimet e datave 27.12.2023 dhe 10.1.2024 për kriterin e figurës. Subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se nuk është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni.
16. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 11.1.2024. Përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit, znj. R.Z, përmes postës elektronike me *email* datë 12.1.2024 ka kërkuar përshpejtimin e datës së seancës dëgjimore të caktuar në datën 16.1.2024 ose caktimin e një date tjetër, pasi ndodhej në një seancë tjetër gjyqësore. Komisioni, pasi u njoh me kërkesën e subjektit, ka vlerësuar ta shtyjë seancën dëgjimore për në datën 18.1.2024 për subjektin e rivlerësimit Ilir Hoxha.
18. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 18.1.2024, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.
19. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti nuk pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Subjekti i rivlerësimit Ilir Hoxha ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ subjekti Ilir Hoxha ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr.

⁶ Kërkesë e regjistruar pranë Komisionit nr. *** prot., datë 21.12.2023.

⁷ Kërkesë e regjistruar pranë Komisionit nr. *** prot., datë 26.12.2023.

84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

22. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
23. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
24. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
25. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.
26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
 - a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
 - b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
 - c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
 - d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private;
 - e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
 - f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
 - g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
 - h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

27. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, me burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, mundësitë për fshehje të pasurisë, deklaram të rremë apo konfliktin e interesit.
28. Në deklaratën e pasurisë *Vetting* (shtojca 2), dorëzuar në ILDKPKI, në datën 25.1.2017, subjekti ka deklaruar pasuritë në vijim:

29. Apartament⁸ me sipërfaqe 110 m², në P, me 2/3 pjesë takuese

29.1 Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se kjo pasuri është privatizuar në datën 15.11.1993, në vlerën 41.400 lekë, ku 2/3 e apartamentit është blerë nga subjekti gjatë martesës me kontratën e shitblerjes datë 2.10.2006, në vlerën 200.000 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit

29.2 Nga informacioni i ardhur nga ASHK Drejtoria Vendore Pogradec⁹ konfirmohet pasuria apartament me sip. 110 m², nr. ***, vol. *, fq. **, zk. ***, të regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Ilir Hoxha dhe G.H.

29.3 Nga aktet e administruara në dosje ka rezultuar se babai i subjektit, shtetasi G.H, përmes kontratës për privatizimin e banesës të vërtetuar nga noteri, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.11.1993, ka blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesa Pogradec një apartament me nr. ***, të ndodhur në rrugën “Unaza”, shk. *, kati i ***, në Pogradec, në vlerën 41.400 lekë.

Subjekti Ilir Hoxha, duke qenë anëtar madhor i familjes në datën 1.12.1992, në kuptim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” ka përfituar 1/3 pjesë të kësaj pasurie, ndërsa prindërit e tij 2/3 pjesë. Subjekti dhe prindërit e tij janë pajisur me certifikatë pronësie në datën 2.12.2004, duke zotëruar secili 1/3 e pasurisë.

29.4 Nga aktet evidentohet se prindërit G dhe N.H i kanë shitur subjektit pjesët e tyre takuese mbi apartamentin përmes kontratës së shitblerjes nr. ** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2006, në çmimin 200.000 lekë, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale, duke u bërë bashkëpronarë me bashkëshorten për pasurinë apartament.

Gjatë hetimit subjekti ka shpjeguar¹⁰ se bashkëshortja e tij G.H është bërë bashkëpronare e apartamentit për shkak të martesës dhe se çmimi i kësaj kontrate prej 200.000 lekësh ka qenë një shumë simbolike sepse në realitet ishte bërë një kalim pronësie nga prindërit tek subjekti dhe jo një veprim juridik i mirëfilltë shitblerjeje.

29.5 Referuar certifikatës familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Pogradec në datën 28.7.2021, rezulton se në datën 24.5.2006, në përbërjen familjare të subjektit kanë qenë

⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin e njësuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 24.10.2016, si vijon: (1) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 25.6.2015, të pasurisë apartament me sip. 110 m², nr. ***, ndodhur në Lagjen *, rruga “U”, Pogradec, e regjistruar në emër të shtetasve Ilir Hoxha (2/3 pjesë) dhe G.H (1/3 pjesë). Bashkëlidhur harta treguese e regjistrimit të pasurisë; (2) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.6.2015 e shtetasit Ilir Hoxha, i cili deklaroi se është trashëgimtar i radhës së parë të trashëgimlënësit G.H dhe se i ka humbur certifikatën e pronësisë së pasurive nr. *** dhe nr. ***, për të cilat kërkon të pajiset nga ZVRPP Pogradec; (3) aplikim nr. ***, datë 3.6.2015, i kryer pranë ZVRPP-së Pogradec për regjistrim të aktit të trashëgimisë për pasuritë nr. ***, nr. *** dhe pasuria nr. ***; (4) aplikim për regjistrim dhe lëshim certifikate drejtuar ZVRPP-së Pogradec, datë 5.10.2006; (5) kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2006, nënshkruar ndërmjet palës shitëse G.H e N.H dhe palës blerëse Ilir Hoxha, për shitjen e pjesës takuese të apartamentit me sip. 110 m², në Pogradec, kundrejt shumës 200.000 lekë; (6) certifikatë për vërtetim pronësie datë 2.12.2004 të pasurisë nr. ***, në emër të shtetasve G.H, N.H dhe Ilir Hoxha. Bashkëlidhur harta treguese e regjistrimit të pasurisë; (7) kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, apartament me sip. 110 m², Lagjia Nr. *, rruga “U e **”, Pogradec, regjistruar në emër të shtetasve G.H, N.H dhe Ilir Hoxha. Në seksionin “E” të hipotekave përshkruhet se pasuria në datën 23.12.2004 është vendosur hipotekë për ProCredit Bank dhe në datën 21.3.2006 është hequr nga hipoteka, me deklaratë noteriale datë 16.3.2006; (8) kërkesë drejtuar Komisionit të Privatizimit të Banesave Shtetërore Pogradec, nga G.H për blerjen e apartamentit ku banon si qiramarrës, në adresën Rruga e **, pallati **, shk. *, ap. * dhe kalimin e tij në pronësi të shtetasve G.H, N.H, Ilir Hoxha, G.H; (9) kontrata për privatizimin e banesës shoqëruar me vërtetim nënshkrimi të noterit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.11.1993 dhe certifikatë pronësie e lëshuar nga Zyra e Hipotekës Pogradec në datën 26.11.1993; planimetria; mandatpagesë nr. ***, datë 1.7.1991; akti i dhënies dhe i marrjes në dorëzim të banesës shtetërore datë 10.6.1991; procesverbal për kryerjen e punimeve jashtë preventivit; (10) shkresë nr. *** prot., datë 10.1.2017, nga ZVRPP-ja Pogradec drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ku konfirmohet se pasuria apartament me nr. ***, ndodhur në z. k. ***, figuron e regjistruar në emër të shtetasve Ilir Hoxha dhe G.H. Bashkëlidhur shkresat përkatëse për kërkim informacioni (njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 23.1.2017).

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2022 (e regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 24.10.2022), si dhe praktika e regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 28.9.2022 (për aplikimin nr. ***, datë 20.9.2022).

¹⁰ Përgjigjet e pyetësorit standard.

prindërit, motra, bashkëshortja dhe dy fëmijët e tij, ku tek shënimet përkatëse evidentohet se prindërit e subjektit kanë bërë ndarjen nga trangu familjar në datën 17.4.2007. Gjatë hetimit, subjekti ka deklaruar se prindërit e tij janë shpërngulur në Tiranë në fundvitin 2006, ndërsa motra e tij G.H është shkëputur *de facto* nga familja e prindërve në momentin kur ka filluar studimet e larta në Tiranë (shtator 1997) dhe pas mbarimit të studimeve në vitin 2001 dhe fillimit të punës, motra e tij është shkëputur përfundimisht nga familja.

Lidhur me të ardhurat e prindërve

29.6 Gjatë hetimit subjekti ka shpjeguar¹¹ ndër të tjera se babai ka qenë me detyrë oficer për një kohë të gjatë, 1966 – 1992. Subjekti ka kërkuar informacion tek Qendra e Personel Rekrutimit pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, por nuk ka marrë informacion mbi të ardhurat e siguruar nga babai nga paga si oficer.

29.7 Sipas subjektit, pas largimit nga Forcat e Armatosura (në atë kohë ka qenë 47 vjeç) babai është marrë me aktivitet tregtar të regjistruar pranë organit tatimor dhe nga ushtrimi i këtij aktiviteti tregtar babai ka siguruar të ardhura, por e ka objektivisht të pamundur të japë informacion konkret shkresor, ku një pjesë e tyre janë përdorur në realizimin e objektit në fjalë.

29.8 Më tej, subjekti ka shpjeguar se nëna e tij ka punuar si arsimtare për një periudhë të gjatë kohe, fundvitet '60 – 2002. Subjekti i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Korçë në datën 17.10.2022, por nuk ka marrë përgjigje nga ky institucion.

29.9 Konstatim i Komisionit

- Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktë pasurinë apartament, pasi deklarimet përputhen me dokumentacionin e administruar në dosje.
- Apartamenti është përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore, ku çmimi i blerjes së apartamentit është në vlera minimale (apo simbolike) dhe në raport me të ardhurat e prindërve nga punësimet (si oficer e mësuese), duhet të kenë disponuar të ardhura të mjaftueshme për privatizimin e apartamentit.

Vlerësimi i Komisionit

- ✓ Nga hetimi i kryer nuk u evidentuan problematika.

30. Ndërtesë¹² me sipërfaqe 30 m², në Pogradec, ndërtim me leje i vitit 1993, pasuri në bashkëpronësi, e trashëguar nga babai, me 1/3 pjesë takuese.

¹¹ Shpjegimet e subjektit dërguar me *email* datë 21.10.2022.

¹² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin e njëzuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 24.10.2016, në vijim: (1) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 5.6.2015, të pasurisë ndërtesë me sip. 30 m², me nr. ***, në Pogradec, e regjistruar në emër të shtetasve G.H, Ilir Hoxha dhe N.H (1/3 pjesë secili). Bashkëlidhur harta treguese dhe kartela e pasurisë së paluajtshme (faqja 1); (2) vendim nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.5.2015, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin G.H dhe përcaktimin si trashëgimtar të radhës së parë fëmijët Ilir Hoxha dhe G.H dhe bashkëshorten N. H. Bashkëlidhur ndodhen certifikatë vdekje G.H, lëshuar në datën 17.3.2015; certifikatë familjare e G.H (përbërja familjare e datës 2.6.2002); certifikatë personale e shtetasve N.H, Ilir Hoxha dhe G.H; (3) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.11.2010, e shtetasit G.H, i cili deklaroi se bazuar në lejen e ndërtimit, lëshuar në datën 17.8.1993, lëshuar nga KRRT Pogradec, ka ndërtuar dhe ka në pronësi një objekt me sip. 30 m², regjistruar me nr. ***, të cilën e disponon dhe shfrytëzon pa ekzistencën e asnjë konflikti gjyqësor për objektin dhe truallin mbi të cilin është realizuar ndërtimi përkatës; (4) certifikatë për vërtetim pronësie datë 2.3.2005 të pasurisë nr. ***, e regjistruar në emër të G.H. Bashkëlidhur harta treguese dhe kartela e pasurisë, me shënimin "Leje ndërtimi nr. **, datë 29.5.1993, seksioni **"; (5) leje ndërtimi datë 17.8.1993, në bazë të vendimit nr. **, datë 29.6.1993, për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe nr. **, datë 29.6.1993, të KRRT, i jepet G.H leje për ndërtimin e një dyqani tek muri i shkollës "K.K". Bashkëlidhur mandatarkëtimi i shumës 2.412 lekë për llogari të Këshillit të Rrethit

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit

30.1 Nga informacioni i ardhur nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Pogradec¹³ konfirmohet pasuria ndërtesë, me sip. 30 m², nr. ***, vol.**, fq.***, zk.***, e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Ilir Hoxha, N.H dhe G.H, secili me 1/3 pjesë takuese të bashkëpronësisë.

30.2 Në DPV-në e vitit 2015 (para fillimit të detyrës)¹⁴ subjekti e ka deklaruar këtë pasuri.

30.3 Nga hetimi ka rezultuar se kjo pasuri është ndërtim me leje i vitit 1993, i kryer nga babai i subjektit dhe nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***rep., nr. *** kol., datë 27.5.2015, është regjistruar në emër të trashëgimtarëve të të ndjerit G.H, ku subjekti është një prej tyre, me 1/3 pjesë të saj.

30.4 Referuar certifikatës së pronësisë të lëshuar në datën 5.6.2015, kjo pasuri rezulton në bashkëpronësi të shtetasve Ilir Hoxha, N.H(nëna) dhe G.H (motra), të cilët disponojnë secili 1/3 pjesë takuese.

30.5 Komisioni i ka kërkuar¹⁵ subjektit të deklarojë vlerën e investimit në momentin e krijimit të pasurisë dhe nëse ka kontribuar në krijimin e kësaj ndërtese, të deklarojë masën e këtij kontributi. Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar¹⁶ se ky objekt është ndërtuar nga babai sipas lejes së ndërtimit datë 17.8.1993, ndërtim i kryer për një periudhë të shkurtër kohe.

30.6 Subjekti ka deklaruar se nuk ka kontribuar në realizimin e objektit, pasi në kohën kur është ndërtuar ka qenë student pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë (gjatë viteve 1990 – 1994), duke depozituar si dokumentacion¹⁷ mbështetës lejen e ndërtimit, certifikatën e pronësisë, dëshminë e trashëgimisë, si dhe diplomën e vitit 1994 të subjektit.

30.7 Nga aktet e administruara evidentohet se kjo pasuri është ndërtim me leje i kryer nga babai në vitin 1993 dhe subjekti ka deklaruar se nuk ka kontribuar në ndërtimin e tij, pasi në atë kohë ishte student dhe në këtë situatë faktike Komisioni nuk ka shkak ligjor për të hetuar e analizuar më tej këtë pasuri.

30.8 Konstatime të Komisionit për ndërtim me sip. 30 m²

- Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosjen hetimore.

nga G.H, si dhe planimetria e objektit; (6) shkresë nr. *** prot., datë 10.1.2017, nga ZVRPP Pogradec, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ku konfirmohet pasuria nr. ***, e llojit “ndërtesë” me sip. 30 m², në emër të shtetasve Ilir Hoxha, N dhe G.H. Bashkëlidhur shkresat përkatëse për kërkim informacioni (njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep. datë 23.1.2017).

¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2022 (e regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 24.10.2022; si dhe praktika me nr. *** prot., datë 23.9.2022, e regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 28.9.2022 ,aplikimi nr. ***, datë 20.9.2022).

¹⁴ Dorëzuar nga subjekti në datën 19.6.2015.

¹⁵ Përmes pyetësorit me *email* datë 12.10.2022.

¹⁶ Shpjegimet e subjektit dërguar me *email* datë 21.10.2022.

¹⁷ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti në datën 21.10.2022: (1) leja e ndërtimit e lëshuar në datën 17.8.1993 nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Pogradec dhe mandatarëtimi nr. ***, datë 27.10.1993; (2) certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë nr. ***, lëshuar në datën 2.3.2005, në emër të shtetasit G.H, harta e regjistrimit të pasurisë dhe kartela e pasurisë; (3) certifikatë vdekje e shtetasit G.H, lëshuar në datën 22.1.2015 nga Zyra e Gjendjes Civile Pogradec; (4) Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.5.2015, i noteres B.S; (5) Certifikatë për vërtetim pronësie me numër serie “****”, lëshuar në datën 5.6.2015, në emër të shtetasve N, G dhe I.H, harta treguese dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme; (6) diploma nr. ***, datë 28.6.1994, e shtetasit Ilir Hoxha dhe lista e notave lëshuar në datën 19.9.1994, nga Fakulteti i Drejtësisë Tiranë; (7) Kërkesa e datës 17.10.2022, drejtuar ing. E.M; (8) kërkesa për informacion datë 13.10.2022 dhe shkresa kthim përgjigje nr. ***, datë 17.10.2022, e Qendrës së Personel Rekrutimit pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, bashkëlidhur ndodhen vërtetimi nr. ***, datë 17.10.2022, si dhe të dhëna personale të shtetasit G. H; (9) kërkesa e datës 17.10.2022, drejtuar DRSSH-së Korçë; (10) kërkesa e datës 19.10.2022, drejtuar Raiffeisen Bank.

- Referuar akteve, kjo pasuri ka kaluar në pronësi të trashëgimtarëve përmes dëshmisë së trashëgimisë ligjore, ku subjekti ka 1/3 sipas pjesës takuese.
- Kjo pasuri është ndërtuar nga babai i tij në vitin 1993, kohë kur subjekti ishte student në periudhën 1990 – 1994 e, për rrjedhojë, subjekti nuk mund të ketë pasur kontribut në krijimin e saj.

Vlerësimi i Komisionit

- ✓ Nga hetimi i kryer nuk u evidentuan problematika.

31. Truall¹⁸ me sipërfaqe 80 m², në Pogradec, i blerë nga babai dhe banorë të pallatit në vitin 2000, pasuri në bashkëpronësi, trashëgimi nga babai me 1/12 pjese takuese. Vlera e deklaruar: 155.400 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

31.1 ASHK Drejtoria Vendore Pogradec¹⁹ ka konfirmuar pasurinë truall në bashkëpronësi të shtetasve E.L, L.L (H), K.(S) N. L, G.L, G.H, A.Sh dhe F.Gj, truall me sip. 80 m², nr. pasurie **, vol. *, f. ***, z. k. ***, ku shtetasi G.H (babai i subjektit) është bashkëpronar me ¼ pjesë takuese të bashkëpronësisë.

31.2 Në DPV-në e vitit 2004²⁰ subjekti ka deklaruar truall ndërtimi në adresën Lagjja Nr. *, rruga “Unaza e *”, Pogradec, pasuri e pandashme, në emër të babait, me vlerë 350.000 lekë, e krijuar në vitin 2000, me pjesë takuese 20% dhe në DPV-në e vitit 2015 (para fillimit të detyrës) subjekti e ka deklaruar këtë pasuri të trashëguar nga babai, në vlerën 155.400 lekë, me pjesë takuese 1/12.

31.3 Nga aktet në dosje ka rezultuar se babai i subjektit G.H, së bashku me banorët e tjerë të pallatit, shtetasit N.L, A.Sh dhe F.Gj, kanë blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.9.2000, nga shitësi G.H (përfaqësues me prokurë i 14 pjesëtarëve të familjes H) një truall me sip. 80 m². Sipas kësaj kontrate, 2/5 pjesë e pandarë e truallit është blerë nga shtetasi N.L, me çmim 103.600 lekë, duke pasur të drejtë të ndërtojë katin e parë dhe të dytë të shtesës së pallatit në bazë të lejës së ndërtimit të miratuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Pogradec, ndërsa 3/5 pjesë e pandarë e truallit është blerë nga shtetasit G.H, A.Sh dhe F.Gj kundrejt çmimit 155.400 lekë, e paguar para redaktimit të kontratës, të cilët bëhen

¹⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën dokumentacionin e njëzuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 24.10.2016 si vijon: (1) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 10.7.2008, të pasurisë nr. ***, lloji “truall” me sip. 80 m², ndodhur në Pogradec, e regjistruar në emër të shtetasve E.L (1/16 pjesë), U.L (1/16 pjesë), K.L (1/16 pjesë), G.L (1/16 pjesë), G.H (1/4 pjesë), A.Sh (1/4 pjesë), F.Gj (1/4 pjesë). Harta treguese e regjistrimit të pasurisë; (2) vendim nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.5.2015, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimtarin G.H dhe përcaktimin si trashëgimtar të radhës së parë fëmijët Ilir Hoxha dhe G.H dhe bashkëshorten N.H; (3) vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. ***, datë 10.10.2000, për pasurinë nr. ** të regjistruar në pronësi të shtetasve G.H, A.Sh dhe F.Gj, si 3/5 pjesë e pandarë e truallit me sip. 90 m², ndodhur në Lagjen Nr. *, Pogradec. Harta treguese e regjistrimit; (4) aplikim kërkesë për regjistrim dhe lëshim certifikate nga A.Sh, F.Gj, G.H; drejtuar ZVRPP Pogradec në datën 10.10.2000; (5) kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.9.2000, nënshkruar ndërmjet palës shitëse G.H (përfaqësues me prokurë i pjesëtarëve të familjes H) dhe palës blerëse N.L, G.H, A.Sh, F.Gj. Shitësit kanë në bashkëpronësi pasurinë nr. ** “truall” me sip. 80 m², prej së cilës deklarojnë se i shesin shtetasit N.L 2/5 pjesë të pandarë të truallit me çmim 103.600 leke, ndërsa blerëseve G.H, A.Sh, F.Gj i shesin 3/5 pjesë të pandarë të truallit kundrejt çmimit 155.400 lekë; (6) vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. ***, datë 5.6.2000, figurojnë të regjistruar në pronësi të familjes H (14 pronarë), pasuritë nr. ***, **, **, **, **, **, **, truall me sip. 1.250 m², ndodhur në Lagjen Nr. *, Pogradec. Harta treguese e pasurisë dhe plani i rievimit; (7) shkresë nr. *** prot. datë 10.1.2017 nga ZVRPP Pogradec drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ku konfirmohet se pasuria nr. **, ndodhur në z. k. ***, lloji “truall” me sip. 80 m² figuron e regjistruar në emër të G.H, në bashkëpronësi, pjesë takuese 1/4. Bashkëlidhur shkresat përkatëse për kërkim informacioni (njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 23.1.2017).

¹⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2022, të regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 24.10.2022.

²⁰ Periudhë kur subjekti ushtronte detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

pronarë secili në 1/5 pjesë të pandarë të truallit me sipërfaqe 80 m², ndërsa shtetasi N.L bëhet pronar i 2/5 pjesë të truallit. Pjesa takuese e babait të subjektit për blerjen e truallit është në shumën 51.800 lekë.

31.4 Pasuria truall është regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 10.10.2000, në bashkëpronësi të banorëve G.H, ASh dhe F.Gj, të cilët zotërojnë së bashku 3/5 pjesë të pandarë të pronës.

31.5 Nga hetimi ka rezultuar se kjo pasuri figuron ende në bashkëpronësi të babait të subjektit G.H me banorë të tjerë të pallatit. Gjatë hetimit subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar²¹ se për këtë pasuri nuk është kryer aplikim për regjistrim të dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin G.H, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2011.

Lidhur me burimin e krijimit

31.6 Në lidhje me të ardhurat që janë përdorur për blerjen e truallit nga babai, sipas pjesës takuese prej 1/5, në shumën 51.800 lekë, subjekti ka shpjeguar se kjo vlerë është kontribut nga pagat e tij ndër vite, që prej datës 1.4.1995.

31.7 Komisioni ka analizuar mundësitë e subjektit për blerjen e truallit sipas pjesës takuese në shumën 51.800 lekë dhe nga përllogaritja e të ardhurave për periudhën 1995 – shtator 2000, bazuar në vërtetimet e pagave në vite, ka rezultuar me një balancë pozitive.

31.8 Konstatime të Komisionit

- Pasuria truall figuron e regjistruar në bashkëpronësi të banorëve dhe referuar aktit babai i subjektit G.H paraqitet si një prej bashkëpronarëve me ¼ pjesë takuese.
- Analiza financiare mbi mundësitë e blerjes së truallit ka rezultuar me një balancë pozitive.

Vlerësimi i Komisionit

✓ Nga hetimi i kryer nuk u evidentuan problematika për këtë pasuri.

32. Shtesë anësore me sipërfaqe 108 m², në pallatin 5-katësh, në Pogradec²². Pasuri në bashkëpronësi, e përfituar me anë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore, me 1/3 pjesë takuese.

²¹ Shpjegimet e subjektit të depozituara me nr. *** prot., datë 2.10.2023, në përgjigje të pyetësorit datë 20.9.2023.

²² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin e njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 24.10.2016, si vijon: (1) tabelë me të dhënat e regjistrimit të objektit informal pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Pogradec nga shtetasi G.H, në Pogradec; (2) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.4.2015, ku shtetasi N.H, Ilir Hoxha dhe G.H deklarojnë se në kuadër të procesit të legalizimit të ndërtimeve informale nga ana e shtetasit G.H janë realizuar: (1) vetëdeklarimi nr. *** prot., datë 8.11.2006 (Njësia Bashkiake Nr. *) pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Tiranë; (2) vetëdeklarimi nr. *** prot., datë 18.9.2006 (formular A1) pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Pogradec; (3) prokurë nr. ***rep., nr. *** kol., datë 15.4.2015, e shtetasve N.H e G.H, të cilët emërojnë si përfaqësues të posaçëm shtetasin Ilir Hoxha për ta përfaqësuar pranë të gjitha institucioneve shtetërore, me qëllim finalizimin e të gjitha procedurave ligjore që shërbejnë në legalizimin dhe regjistrimin e pasurive që ata disponojnë sipas vendimit nr. ***, datë 31.1.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (4) ndërtimi datë 14.6.2000, lëshuar nga Bashkia Pogradec, në bazë të vendimit të KRRT, nr. **, datë 14.12.1999, për miratimin e lejes së ndërtimit për pallatin *** (shtesë pallati * kate). Bashkëlidhur ndodhen mandatarëkëtimet e shumës 32.290 lekë për llogari të Bashkisë nga G.H; planimetri të objektit, si dhe situacion punimesh në shumën totale 1.569.670 lekë; (5) mandatarëkëtime nga Drejtoria e Shërbimit Publik, KESH, Komisarati i Policisë, në shumën totale 13.400 lekë, arkëtuar nga G.H; (6) formular i lidhjes së objektit me infrastrukturë inxhinierike, shoqëruar me planimetritë përkatëse të objektit; (7) shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.12.2016, nga Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila konfirmon se shtetasi G.H ka aplikuar në formularin nr. ***, në Pogradec (e njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. ***rep., datë 23.1.2017).

32.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi se kjo pasuri në bashkëpronësi është ndërtuar në vitin 2000, në tejkalim të lejes së ndërtimit, i vetëdeklaruar për legalizim, trashëgimi nga babai.

Subjekti nuk ka deklaruar vlerë për këtë shtesë ndërtimore.

32.2 Në DPV-në e vitit 2004²³ subjekti ka deklaruar: “*Shtesë shtëpi banimi me sip. 118 m², në adresën Lagjja Nr. *, rruga “Unaza e *”, p. ***, e pahirpotekuar, në vlerën 2.200.000 lekë, e krijuar në vitin 1998, me pjesë takuese 33 %*”.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

32.3 Nga informacioni i ardhur nga institucionet përkatëse ka rezultuar si vijon:

- a) ASHK Drejtoria Vendore Pogradec²⁴ ka informuar se nga verifikimi në bazën dixhitale të vetëdeklarimeve shtetasi G.H.H rezultoi aplikues me vetëdeklarimin nr. *** prot., datë 18.9.2006, për shtesën në objekt ekzistues me adresë në Lagjen Nr. *, rruga “Unaza e *”, Pogradec, për të cilin procedurat e legalizimit nuk kanë përfunduar ende.
- b) ASHK Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë²⁵ ka konfirmuar se shtetasi G.H.H rezultoi vetëdeklarues me nr. ** prot., viti 2005 – 2006, shtesë pa lejë, në Pogradec.

32.4 Nga aktet evidentohet se për ndërtimin e shtesës anësore të pallatit është dhënë leja e ndërtimit datë 14.6.2000²⁶ për shtesë pallati * kat, në pallatin nr. ***, të miratuar me vendimin nr. **, datë 14.12.1999, të Këshillit të Rregullimit të Territorit Bashkia Pogradec.

32.5 Gjatë hetimit subjekti ka shpjeguar²⁷ se kjo lejë ndërtimi është dhënë në favor të të gjithë banorëve të pallatit (të identifikuar në atë kohë me pallatin nr. **), ku pas realizimit të objektit, të kryer në tejkalim të lejes së ndërtimit dhe pas daljes së ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar (i shfuqizuar tashmë), ky objekt informal është deklaruar për legalizim, përkatësisht me vetëdeklarimin nr. *** prot., datë 18.9.2006, formulari A*, ku organi kompetent ende nuk është shprehur me vendim përfundimtar.

32.6 Nga aktet në dosje ka rezultuar se babai i subjektit G.H. përmes formularit të vetëdeklarimit nr. *** prot., datë 18.9.2006, ka aplikuar për legalizimin e 1/5 të shtesës ndërtimore *-katëshe në pallatin nr. ***, Lagjja Nr. *, Pogradec, mbi lejen e ndërtimit të miratuar, me subjekt ndërtues dhe investitor G.H. Sipas këtij formulari, ky ndërtim është deklaruar i përfunduar, ku sipërfaqja e ndërtimit të miratuar ishte 49.5 m², ndërsa sipërfaqja faktike e ndërtuar është 108 m².

32.7 Nga informacioni i ardhur nga ASHK Pogradec²⁸ rezultoi se për këtë pasuri nuk kanë përfunduar ende procedurat e legalizimit dhe, për rrjedhojë, prona rezultoi ende e paregjistruar.

32.8 Përmes prokurës së posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.4.2015, nëna N.H dhe motra G.H kanë caktuar si përfaqësues të posaçëm subjektin Ilir Hoxha për t’i përfaqësuar

²³ Periudhë kur subjekti ushtronte detyrën si oficer i policisë gjyqësore.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2022.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 13.10.2022.

²⁶ Tek leja e ndërtimit e paraqitur nga subjekti, data e lëshimit të lejes paraqitet me shkrim dore “14.6.2000”, ndërsa leja e ndërtimit e dërguar nga ASHK Pogradec nuk përmban datë lëshimi.

²⁷ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2022.

pranë të gjitha institucioneve shtetërore, me qëllim finalizimin e të gjitha procedurave ligjore që shërbejnë në legalizimin dhe regjistrimin e pasurive që ata disponojnë si trashëgimtarë.

Lidhur me koston e ndërtimit të shtesës anësore

32.9 Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar vlerë të kësaj pasurie, ndërsa në DPV-në e vitit 2004 ka deklaruar vlerën e shtesës së banimit në shumën 2.200.000 lekë. Në aktet e ndodhura në dosje evidentohet një situacion punimesh për pallatin *-katësh në vitin 2000 (me datë të palexueshme), i nënshkruar nga shoqëria “P” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi H. P, ndërsa për përfaqësuesit N dhe A dhe K (me mbishkrim G) ka nënshkruar shtetasi G.H, nga ku shpenzimet totale për shtesën anësore të pallatit *-katësh janë në shumën totale 1.569.670 lekë. Në këtë situacion ndodhet një shënim ku thuhet se: “*Vlera e themeleve dhe izolimi i tarracës janë të përbashkëta për pesë familjarët*”.

32.10 Referuar situacionit të punimeve vlera e investimit sipas pjesës takuese prej 1/5 është në shumën 313.934 lekë, në vitin 2000.

32.11 Në lidhje me vlerën e investimit sipas pjesës takuese, gjatë hetimit subjekti ka deklaruar²⁹ se jo vetëm që nuk ka kontribut në ndërtimin e saj, por për shkak të mungesës së babait (i cili ka ndërruar jetë në vitin 2011) e ka objektivisht të pamundur të paraqesë të dhëna të sakta për vlerën e investimit. Megjithatë, subjekti bën me dije se nga dokumentacioni që posedon i rezulton se pas marrjes së lejes së ndërtimit, në emër të babait është prerë mandatarëtimi nr. ***, datë 23.8.2000, në vlerën 32.140 lekë, ku në favor të Bashkisë Pogradec është paguar vlera e lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. **, datë 14.12.1999, të KRRT-së Bashkia Pogradec. Shpenzimet për marrjen e lejes së ndërtimit për shtesën anësore, sipas pjesës takuese 1/5 pjesë, janë në shumën 6.428 lekë.

Burimi i krijimit të kësaj pasurie

32.12 Në lidhje me të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar³⁰ ndër të tjera se një pjesë e tyre janë siguruar nga kursimet e prindërve, nga paga si oficer dhe arsimtare, si dhe depozitat e mundshme të kursimit apo llogaritë bankare që prindërit kanë pasur pranë sistemit bankar, por për shkak të kohës që ka kaluar tashmë, e ka objektivisht të pamundur të paraqesë dokumentacion provues.

32.13 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se babai i tij është marrë me aktivitet tregtar, i regjistruar pranë organit tatimor, ku për një periudhe kohe ka ushtruar aktivitetin e licencuar në emrin e nënës dhe nga ushtrimi i këtyre aktiviteteve prindërit kanë siguruar të ardhura, por e ka objektivisht të pamundur të japë informacion konkret shkresor.

32.14 Subjekti ka shpjeguar³¹ se babai është regjistruar si “person fizik” për ushtrimin e veprimtarisë private “Lojëra elektronike për fëmijë (pa fitim)” nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 19.5.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe pasi e ka ushtruar këtë aktivitet për një periudhë kohore ka vijuar nën emrin e nënës, e cila është regjistruar po si “person fizik” për lojëra elektronike për fëmijë (pa fitim) me vendimin nr. ***, datë 1.3.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

32.15 Subjekti ka depozituar³² si dokumentacion provues:

²⁹ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022.

³⁰ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022.

³¹ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022, në përgjigje të pyetësorit datë 12.10.2022.

³² Dokumentacion i depozituar nga subjekti, regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 24.10.2022.

- vendimin gjyqësor nr. ***, datë 19.5.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për regjistrimin si person fizik të shtetasit G.H;
- vendimin gjyqësor nr. ***, datë 1.3.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për regjistrimin si person fizik të shtetasës N.H;
- shkresën e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë³³, e cila ka dërguar vërtetimin³⁴ e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, ku konfirmohet se shtetasi G.H ka përfituar pension të parakohshëm ushtaraku për periudhën 1.1.1999 – 3.1.2008, ku të ardhurat janë në vlerë totale 1.304.042 lekë dhe pension suplementar për periudhën 3.1.2008 – 30.12.2010, në vlerë totale 161.606 lekë.

32.16 Sipas subjektit, nga fillimi i përfitimit të pensionit të parakohshëm dhe deri në kohën e investimit në realizimin e objektit në fjalë (për periudhën 1.1.1999 – 30.6.2001) babai ka realizuar të ardhura në vlerë totale 272.160 lekë. Për sa shpjeguar më sipër, subjekti pretendon se nëpërmjet trajtimit me pension të parakohshëm të babait, jo vetëm që është siguruar jetesa familjare, por edhe janë siguruar kursime, që janë përdorur edhe në realizimin e objektit në fjalë.

32.17 Komisioni ka hetuar lidhur me të ardhurat e prindërve të subjektit, duke kërkuar informacion pranë institucioneve respektive, si vijon:

- Nga të dhënat e ardhura nga ISSH-ja³⁵ nuk konfirmohen të ardhura të përfituara nga babai G.H, ndërsa nëna e subjektit N.H përfiton pension pleqërie nga muaji qershor 2002.
- Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve³⁶ ka informuar se nga verifikimi i sistemit informatik tatimor C@TS, shtetasit Ilir Hoxha, G.H, G dhe N.H nuk rezultojnë të regjistruar në organin tatimor me aktivitet privat.
- Nga informacioni i ardhur nga QKB-ja³⁷ konfirmohen disa aktivitete tregtare në emër të shtetasit Ilir Hoxha³⁸, dy aktivitete në emër të shtetasës G/G.H, si dhe një aktivitet në emër të shtetasës N.H, por nuk garantohet nëse bëhet fjalë për të njëjtët shtetas, pasi nuk kanë kryer përditësimin e të dhënave në QKB. Bashkëlidhur shkresës është dërguar dokumentacioni si vijon:
 - ekstrakt historik për subjektin tregtar “N.H” person fizik, e regjistruar në datën 1.1.2001, me NIPT K***J, me status aktiv, ku vendi i ushtrimit të aktivitetit është në Pogradec;
 - akti i themelimit dhe statuti i shoqërisë tregtare “K ***” sh.p.k., ku ortakë të saj janë shtetasit G.H.H me 34 % të kuotave, A.Z zotërues i 33 % të kuotave dhe H.Ç zotërues i 33 % të kuotave me administrator shtetasi G.H;
 - vendimi gjyqësor nr. ***, datë 13.3.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur regjistrimin si persona fizikë të kësaj shoqërie;

³³ Shkresa me nr. *** prot., datë 12.12.2016 (e depozituar nga subjekti).

³⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 12.12.2016.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 22.7.2021.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 2.8.2021.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 30.9.2022.

³⁸ Ilir Hoxha figuron i regjistruar si: (1) administrator tek 3 subjekte tregtare: “****” sh.p.k. (NIPT J***B), “****” sh.p.k. (NIPT J***J) dhe “****” sh.p.k. (NIPT J***S); (2) figuron i regjistruar si person fizik në 2 aktivitete (NIPT K***I dhe NIPT K***N), por nuk janë plotësuar të dhënat; (3) figuron i regjistruar si person fizik në 5 aktivitete, por nuk mund të identifikohet pajisja me NUIS (NIPT).

- vendimi nr. ***, datë 19.5.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për regjistrimin si person fizik të shtetasit G.H, për ushtrimin e veprimtarisë private “Lodra elektronike për fëmijë (pa fitim)”, në bazë të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 (neni 5), bazuar në kërkesën e shtetasit G.H.H, i cili deklaroi se është me banim në Pogradec dhe ka marrë me qira një objekt ku kërkon të ushtrojë veprimtarinë private të lojërave elektronike për fëmijë (pa fitim).

d) Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë³⁹ ka dërguar dokumentacionin arkivor të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve për tatimpaguesit të regjistruar si subjekte për ushtrim aktiviteti tregtar si ambulancë “Lojëra elektronike për fëmijë (pa fitim)” në emër të shtetasve G.H dhe N.H për periudhën kohore 1998 – 2003.

32.18 Sa më sipër, subjekti nuk ka mundur të depozitojë dokumentacion mbi të ardhurat e prindërve nga punësimet: nëna si arsimtare dhe babai në detyrën e oficerit. Gjithashtu, edhe nga hetimi i Komisionit nuk u siguruan të dhëna të plota në lidhje me të ardhurat e prindërve, pasi punësimet e prindërve datojnë nga fundvitet ‘60 deri në vitet 2000.

32.19 Konstatime të Komisionit

- Shtesa anësore është ndërtuar nga babai i subjektit dhe banorë të pallatit në vitin 2000, në tejkalim të lejes ndërtimore dhe procedurat e legalizimit nuk kanë përfunduar ende.
- Nuk disponohet dokumentacion i plotë në lidhje me të ardhurat e prindërve dhe në këtë situatë nuk mund të kryhet një analizë për investimin shtesë anësore në vitin 2000, për pjesën takuese të babait prej 1/5, me vlerë rreth 320.000 lekë.
- Ndërtimi i shtesës anësore është kryer vite përpara se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit (qershor 2015).

Vlerësimi i Komisionit për ndërtimin e shtesës anësore

32.20 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar mungesë dokumentacioni justifikues ligjor mbi burimin financiar të prindërve për krijimin e pasurive. Komisioni në rezultatet e hetimit nuk i ngarkoi barrë prove subjektit, duke vlerësuar faktin se Ilir Hoxha nuk ishte subjekt deklarues kur pasuria shtesë anësore u ndërtua nga babai dhe banorë të tjerë, si dhe nuk mund të ngrihen dyshime për pasuri të fshehur. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk gjendet para situatës së parashikuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e për pasojë nuk ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, të cilat nuk janë objekt dhurimi apo huaje. Kjo në përputhje edhe me qendrimet e KPA, referuar Vendimit nr. 15/2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: “...arsyetohet se interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit. Pavarësisht, ky arsyetim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive”.

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2023.

Përfundimisht, mungesa e burimeve të ligjshme nga ana e prindërve mbetet thjesht një konstatim, pa marrë peshë në rivlerësimin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

33. Garazh⁴⁰ me sipërfaqe 108.72 m², në Tiranë, pasuri në bashkëpronësi, blerë në datën 14.6.2013, me pjesë takuese ½, në vlerën 5.400.000 lekë.

33.1 Në DPV-në e vitit 2015 (para fillimit të detyrës) subjekti e ka deklaruar këtë pasuri.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

33.2 Nga informacioni i ardhur nga Drejtoria Vendore ASHK Tiranë Rurale⁴¹ konfirmohet pasuria garazh me sip. 108.72 m², nr. ***-G*, vol. **, f. ***, e regjistruar në pronësi të shtetasve Ilir Hoxha dhe A.Z.

33.3 Nga verifikimi i akteve ka rezultuar se subjekti Ilir Hoxha dhe shtetasi A.Z, përmes kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.6.2013, kanë blerë nga shitësit I.K dhe V.K (R)⁴² pasurinë garazh me sip. 108.72 m², në çmimin 5.400.000 lekë.

33.4 Në kontratë përcaktohet se blerësit e blejnë këtë pasuri dhe bëhen bashkëpronarë në pjesë të pandarë ½ secili dhe vlera e shitjes së saj është likuiduar jashtë zyrës noteriale në formën “me lekë në dorë”.

33.5 Subjekti dhe shtetasi A.Z janë pajisur me certifikatë pronësie në datën 6.8.2013, duke u bërë bashkëpronarë në pjesë të barabarta mbi këtë pasuri.

Burimi i krijimit

33.6 Nga verifikimi i deklaratave të pasurisë, ka rezultuar se në deklaratën *Vetting*, si dhe DPV-në e vitit 2015 (para fillimit të detyrës) subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

33.7 Komisioni i ka kërkuar⁴³ subjektin të deklarojë burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë për pjesën e tij takuese, si dhe të shpjegojë arsyen e mosdeklarimit të saj në deklaratën *Vetting*.

33.8 Subjekti ka shpjeguar⁴⁴ se familja K me kryefamiljar shtetasin I.K ka pasur në pronësi një tokë arë me sip. 255 m² dhe nr. pasurie ***, të ndodhur në Sh, Tiranë, të vërtetuar me certifikatën e pronësisë datë 20.7.2000, pasuri të cilën në vitin 2007 e ka vënë në dispozicion të babait G.H dhe shtetasit A.Z, duke u dhënë të drejtën e ndërtimit mbi truallin e tij të një objekti banimi *-kate mbi tokë dhe 1-kat nën tokë.

Subjekti ka shpjeguar se në marrëveshjen e lidhur në vitin 2007 ndërmjet shtetasve I.K, G. H dhe A.Z, është parashikuar që fondet, kostot dhe të gjitha shpenzimet për realizimin e ndërtimit do të përballoheshin nga shtetasit G.H e A.Z dhe, në përfundim të ndërtimit,

⁴⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën dokumentacionin e njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 24.10.2016: (1) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 6.8.2013, për pasurinë nr. **-G*, lloji “garazh”, me sip. 108.72 m², ndodhur në Sh, Tiranë, në emër të shtetasve Ilir Hoxha dhe A.Z, e shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme; (2) kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.6.2013, nënshkruar ndërmjet palës shitëse I.K e V.K (R), përfaqësuar me prokurë nga shtetasi I.K dhe palës blerëse Ilir Hoxha e A.Z. Çmimi i shitjes 5.400.000 lekë i likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale; (3) prokurë e përgjithshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.10.2007, ku shtetasit V.K (R), A.K dhe E.K deklarojnë se emërojnë si përfaqësues të posaçëm shtetasin I.K, të cilit i japin të drejtën të veprorë në emër dhe për llogari të tyre, me të gjitha tagrat që i njej ligji, në lidhje me pronat që janë në bashkëpronësinë e tyre; (4) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.2.2013, të pasurisë nr. **-G*, ndodhur në Sh, Tiranë, në emër të I.K, shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë.

⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 8.6.2023.

⁴² E përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.10.2008, nga shtetasi I.K.

⁴³ Përmes pyetësorit me *email* datë 12.10.2022.

⁴⁴ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022.

shtetasi I.K, si pronar trualli, do të përfitonte 30% të sipërfaqes ndërtimore, ndërsa pjesa tjetër prej 70% të sipërfaqes ndërtimore do të përfitohej nga shtetasit G.H dhe A.Z.

Sipas subjektit, ky objekt është ndërtuar nga babai dhe shtetasi A.Z, të cilët e kanë përfunduar atë në fund të vitit 2008, si dhe është kryer sistemimi në apartamentet përkatëse, sipas prenotimit të kryer nga familjet që banojnë aktualisht edhe sot, përfshirë këtu edhe familjen e shtetasit I.K.

33.9 Subjekti ka depozituar⁴⁵ kopjen e kontratës paraprake për sipërmarrje ndërtimi me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.4.2007, të lidhur midis pronarit të truallit/porositësit I.K dhe sipërmarrësit shoqëria “K ***” me ortakë shtetasit G.H, A.Z dhe H.Ç. Objekt i kësaj kontrate është vënia në dispozicion të shoqërisë “K ***”, të pasurisë “arë”, me sip. 255 m², nr. ***, për ndërtimin e një objekti shumëkatësh, sipas lejes që do të marrë nga bashkia. Në kontratë përcaktohet se punimet fillojnë jo më vonë se 60 ditë nga zbardhja e lejes së ndërtimit, nga e cila pronari i tokës do të përfitojë 30% të sipërfaqes së ndërtimit. Palët kanë parashikuar se efektet e kësaj shtrihen deri në momentin e daljes së lejes së ndërtimit/9 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

33.10 Referuar dokumentacionit të administruar në dosje ka rezultuar se ky objekt *-katësh është ndërtuar pa lejë dhe legalizuar pranë ALUIZNI-t Tiranë, nën emrin e pronarit të truallit I.K, i pajisur me lejen e legalizimit⁴⁶ nr. ***, datë 20.6.2012 për “Godinë të kombinuar * kate + 1 nëntokë” tek Njësia Administrative Nr. *. Ky objekt është regjistruar më pas pranë ZVRPP-së në vitin 2013, në pronësi të shtetasit I.K, i cili është pajisur me certifikata pronësie për secilën pasuri të paluajtshme (përkatësisht * garazhe, * apartamente dhe * njësi)⁴⁷.

33.11 Gjatë hetimit subjekti ka shpjeguar⁴⁸ se në kuadër të marrëveshjes së lidhur në vitin 2007, shtetasi I.K do të përfitonte 5 pasuri të paluajtshme (përkatësisht * apartamente, * njësi dhe 1* garazh), të cilat përfaqësonin masën prej 30% të sipërfaqes ndërtimore, ndërsa babai G.H dhe shtetasi A.Z do të përfitonin 70% të sipërfaqes ndërtimore, pra 8 pasuri të paluajtshme (përkatësisht * apartamente, * garazh dhe * njësi).

Subjekti ka saktësuar se zgjedhja e këtyre pasurive prej shtetasit I.K ishte bërë në marrëveshje të mëparshme me shtetasit G.H dhe A.Z, ku asnjëra prej palëve nuk kishte kontestime për këtë mënyrë përzgjedhjeje dhe, në respektim të marrëveshjes, shtetasi I.K kishte detyrimin të transferonte pronësinë tek përfituesit realë.

33.12 Në mbështetje të shpjegimeve sa më sipër, subjekti ka depozituar⁴⁹ deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.6.2013, të nënshkruar prej tij dhe shtetasve I.K e A.Z, ku përshkruhen hollësisht të gjitha faktet e evidentuara më sipër. Subjekti ka deklaruar se njohja me këta shtetas ka ardhur vetëm për shkak të marrjes përsipër të detyrimeve që buronin nga i ndjeri, babai.

⁴⁵ Dokument i depozituar nga subjekti me nr. *** prot., datë 2.10.2023.

⁴⁶ Dërguar nga ASHK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 19.10.2023.

⁴⁷ (1) Pasuria nr. ** – G*, e llojit “garazh”, me sip. 47.88 m²; (2) pasuria nr. ** – G*, e llojit “garazh”, me sip. 108.72 m²; (3) pasuria nr. ***, e llojit “apartament”, me sip. 32.6 m²; (4) pasuria nr. *** – N*, e llojit “njësi”, me sip. 31 m²; (5) pasuria nr. *** – N*, e llojit “njësi”, me sip. 93.9 m²; (6) pasuria nr. ***, e llojit “apartament”, me sip. 63.9 m²; (7) pasuria nr. ***, e llojit “apartament”, me sip. 120.2 m²; (8) pasuria nr. ***, e llojit “apartament”, me sip. 90 m²; (9) pasuria nr. ***, e llojit “apartament”, me sip. 94.1 m²; (10) pasuria nr. ***, e llojit “apartament”, me sip. 90 m²; (11) pasuria nr. ***, e llojit “apartament”, me sip. 94.1 m²; (12) pasuria nr. ***, e llojit “apartament”, me sip. 90 m²; (13) pasuria nr. **, e llojit “apartament”, me sip. 94.1 m².

⁴⁸ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022, në përgjigje të pyetësorit datë 12.10.2022.

⁴⁹ Depozituar me *email* datë 21.10.2022.

33.13 Nga verifikimi i praktikës së legalizimit të dërguar nga ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁵⁰ evidentohet se pronari i truallit I.K ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit në datën 7.11.2006, për shtëpi banimi * kat me bodrum, ku ka deklaruar si vit ndërtimi 2006 dhe zaptues shënohet emri i shtetasit A.Z, ndërkohë aktmarrëveshja e lidhur midis babait dhe pronarit të truallit daton në prill 2007.

33.14 Nga pamjet me ortofoto të printuara nga Gjeoportali Kombëtar ASIG⁵¹ për vitet 1994, 2001, 2007, 2015 dhe 2018 në truallin e shtetasit I.K evidentohen gjurmë ndërtimi themelesh në vitin 2007 dhe në vitin 2015 ndërtimi paraqitet i përfunduar.

Gjithashtu, edhe nga verifikimi i pamjeve fotografike të printuara nga *Google Maps* (në *website*) evidentohen gjurmë ndërtimi themelesh në vitin 2007 dhe në qershor 2009 ndërtimi paraqitet i përfunduar.

Lidhur me pasuritë apartamente, njësi dhe garazhe që i përkasin këtij ndërtimi

33.15 Gjatë hetimit subjekti ka shpjeguar⁵² se bazuar në dokumentet që ka mundur të grumbullojë, në kohën e ndërtimit të objektit, babai i tij ka kryer akte noteriale për prenotim/sipërmarrje me shtetas të ndryshëm, duke realizuar edhe veprime financiare me ta.

33.16 Subjekti ka depozituar⁵³ pranë Komisionit disa deklarata noteriale të nënshkuara midis babait dhe shtetasve të ndryshëm gjatë periudhës shtator 2007 – 2008, për shitjen e apartamenteve në ndërtesën *-katëshe të ndërtuar prej tij në truallin e shtetasit I.K, por të pahipotekuar, ku për ndërtesën ka futur letrat për legalizim. Në secilën deklaratë noteriale, palët deklarojnë çmimin e apartamentit të dakordësuar midis tyre, shumën e paguar dhe detyrimin e mbetur të papaguar.

33.17 Subjekti ka sqaruar se në momentin e legalizimit të objektit babai i tij kishte rreth dy vjet që kishte ndërruar jetë dhe, në vijim të marrëveshjes së lidhur në vitin 2007, ishte e domosdoshme që trashëgimtarët të merrnin përsipër vijueshmërinë e përbushjes së detyrimeve ende të papërbushura. Subjekti ka shpjeguar se, mbështetur edhe në traditën dhe zakonet shqiptare, ka marrë përsipër përbushjen e detyrimeve të papërbushura nga babai, duke marrë pëlqimin edhe të trashëgimtarëve të tjerë, përkatësisht të nënës dhe motrës.

33.18 Nga aktet rezulton se shtetasi I.K dhe bashkëshortja e tij kishin lëshuar prokurën e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.6.2013, duke emëruar si përfaqësues subjektin Ilir Hoxha dhe shtetasin K.B (bashkëshorti i motrës) për kryerjen e të gjitha veprimeve juridike për shitjen e 7 pasurive të paluajtshme, duke mundësuar kalimin e pronësisë në emër të

⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 2.11.2023.

⁵¹ Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 23.9.2023.

⁵² Shpjegimet e subjektit me email datë 21.10.2022.

⁵³ Dokumentacion i depozituar nga subjekti me *email* datë 21.10.2022, në përgjigje të pyetësorit datë 12.10.2022:

(1) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.9.2007, të lëshuar nga deklaruesit G.H dhe I.U, për çmimin e apartamentit 22.000 euro (me shkrim dore shënohet se llogaritja është kryer gabim, duhet bërë 26.250 euro);

(2) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2007 dhe deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.6.2009 nga shtetasit G.H dhe A.Gj, për vlerën e apartamentit 5.000.000 lekë;

(3) deklaratë për dhënie lekësh (kapari) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.4.2008, të nënshkruar nga shtetasit G.H dhe A.B, për çmimin e apartamentit 48.300 euro;

(4) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.1.2008 dhe deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.2008 të nënshkruar midis shtetasve G.H dhe D.R, për apartament me çmim 25.500 euro;

(5) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2007 dhe deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.10.2008, të nënshkruar midis shtetasve G.H dhe V.Sh, për çmimin e apartamentit 42.300 euro;

(6) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.11.2007 dhe deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.10.2009, të nënshkruar midis shtetasve G.H dhe Z.Q, me çmim apartamenti 5.000.000 lekë;

(7) sipas shpjegimeve të subjektit shtetasi E.H kishte lidhur marrëveshje verbale për blerjen e një njësie me sip. 93.9 m², që përfaqëson pasurinë nr. ** – N*, duke marrë vlerat monetare për të cilat palët kishin rënë dakord më parë.

përfituesve të secilës pasuri, të cilët kishin kryer më parë prenotime/sipërmarrje me babain e subjektit.

Subjekti deklaron se personalisht ka përfaqësuar pronarin e truallit në nënshkrimin e 3 kontratave të shitblerjeve⁵⁴, ndërsa kontratat e tjera të shitjes⁵⁵ janë nënshkruar personalisht nga shtetasi I.K.

33.19 Lidhur me pasurinë garazh me sip. 108.72 m², të deklaruar në deklaratën *Vetting*, subjekti ka sqaruar se kjo ishte e vetmja pasuri për të cilën babai dhe shtetasi A.Z nuk kishin realizuar shitje tek të tretët dhe, për këtë arsye, është realizuar edhe kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.6.2013, midis pronarit të truallit I.K dhe blerësve A.Z e Ilir Hoxha. Subjekti thekson se kjo kontratë është nënshkruar vetëm nën emrin e tij, si një prej trashëgimtarëve të shtetasit G.H, duke marrë pëlqim edhe nga trashëgimtarët e tjerë. Gjatë hetimit subjekti ka sqaruar⁵⁶ se pavarësisht se në kontratën e shitjes përcaktohet çmimi i shitjes prej 5.400.000 lekësh, i likuiduar jashtë zyrës noteriale, në realitet për këtë kontratë nuk janë kryer veprime financiare dhe transferime fondesh nga blerësit tek shitësi.

Sipas subjektit, vlera e çmimit në këtë kontratë është shënuar vetëm për shkak se kjo pasuri ka qenë e rivlerësuar sipas legjislacionit të kohës dhe blerja e pasurisë me këtë kontratë shitblerjeje nuk përfaqëson një veprim të mirëfilltë juridik.

33.20 Subjekti ka shpjeguar se ky veprim juridik është përdorur vetëm si një mekanizëm ligjor, pasi në situatën e gjendur është vlerësuar se ishte i vetmi veprim që ekzistonte për të përmbushur marrëveshjen e lidhur në vitin 2007, dhe për këtë pasuri nuk është kryer shpenzim i fondeve monetare nga ana e tij apo shtetasit A.Z.

33.21 Lidhur me arsyen e mosdeklarimit të burimit të krijimit në deklaratën *Vetting* për këtë pasuri, subjekti ka shpjeguar⁵⁷ ndër të tjera se duke qenë se deklarata *Vetting* përbënte edhe deklaratën e tretë të deklarimit të pasurisë (e para ka qenë ajo e datës 19.6.2015 “para fillimit të detyrës” dhe e dyta ka qenë ajo e datës 15.3.2016 “periodike vjetore”), rrethanë që lidhet edhe me fitimin e një përvoje në plotësimin e deklaratave, perceptimi i tij ka qenë vetëm në detyrimin për deklarim të çdo pasurie. Për rrjedhojë, mosdeklarimi i burimit të krijimit ka ndodhur vetëm për shkak të perceptimit të gabuar të kërkesës së ligjit.

33.22 Komisioni i ka kërkuar⁵⁸ subjektit të deklarojë marrëdhënien që ka me bashkëpronarin A.Z, për të cilën subjekti ka shpjeguar⁵⁹ se shtetasi A.Z ka qenë krejtësisht i panjohur prej tij

⁵⁴ (1) Kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.12.2013, e lidhur me shtetasin F.U, përfaqësuar nga I.U për pasurinë nr. *** , me çmim shitjeje 6.300.000 lekë, vlerë e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

(2) Kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.8.2013, e lidhur me shtetasit A.Gj dhe V.Gj për pasurinë nr. *** , për çmimin e apartamentit 6.660.000 lekë e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

(3) Kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.8.2013 e lidhur me shtetasin E.H, për pasurinë e paluajtshme nr. *** – N*, për çmimin e apartamentit 13.200.000 lekë, vlerë e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

⁵⁵ (1) Kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.1.2021 e lidhur me shtetasen D.R, për pasurinë nr.***, e llojit “apartament”, me sip. 63.9 m² (kontrata paraqitet jo e plotë);

(2) Kontratë Shitjeje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2021, e lidhur me shtetasin V.Q, djali i shtetasit Z.Q, për pasurinë nr. ***, e llojit “apartament”, me sipërfaqe 90 m² (kontrata paraqitet jo e plotë);

(3) Kontratë Shitjeje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.9.2020, e lidhur me shtetasin A.B (i përfaqësuar nga shtetasi P.B), për pasurinë nr. ***, e llojit “apartament”, me sip. 120.2 m² (kontrata paraqitet jo e plotë);

(4) Kontratë Shitjeje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr.*** kol., datë 23.1.2021, e lidhur me shtetasin V.Sh, për pasurinë nr. ***, e llojit “apartament”, me sip. 94.1 m² (e cila paraqitet jo e plotë);

(5) Kontratë Shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.6.2013 e lidhur me shtetasit Ilir Hoxha dhe A.Z, për pasurinë garazh me sip. 108.72 m², nr. pasurie ***-G*.

⁵⁶ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022.

⁵⁷ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022.

⁵⁸ Përmes pyetësorit me *email* datë 12.10.2022.

⁵⁹ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022.

deri në momentin kur babai ka ndërruar jetë, ku e vetmja marrëdhënie që ka krijuar me të ka qenë vetëm ajo në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që buronin prej babait të tij nga marrëveshja e lidhur në vitin 2007.

33.23 Në lidhje me destinacionin e përdorimit të garazhit, subjekti ka shpjeguar⁶⁰ se në kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes garazhi ka qenë vetëm në rrethim me tulla, e pasuvatuar nga brenda, e pashtuar në dysheme, e pasistemuar në tërësinë e saj dhe e mbyllur me derë. Kjo pasuri ka të njëjtën gjendje edhe sot. Në asnjë moment, për këtë pasuri nuk është lidhur asnjë kontratë për furnizim me energji elektrike apo për furnizim me ujë të pijshëm dhe as nuk është dhënë në përdorim, me apo pa shpërblim tek të tretë. Subjekti ka depozituar dokumentacion mbështetës⁶¹ si pamje fotografike të garazhit, ku evidentohet gjendja aktuale e kësaj pasurie.

Analiza financiare mbi mundësitë e subjektit për të blerë 1/2 e garazhit

33.24 Referuar aktit ligjor, kontratës së shitblerjes datë 14.6.2013, në të cilën përcaktohet se palët janë likuiduar jashtë zyrës noteriale për çmimin e blerjes prej 5.400.000 lekësh, Komisioni kreu analizë kumulative duke analizuar të ardhurat e ligjshme për periudhën 2005 – 2015, mbi mundësitë financiare të subjektit për blerjen e garazhit, për 1/2 pjesë, në shumën 2.700.000 lekë, që i përket periudhës para marrjes së detyrës.

33.25 Analiza kumulative u krye për periudhën 2005 – qershor 2015 (periudhë para emërimit në detyrën e prokurorit), ku janë analizuar edhe pasuri të tjera të krijuara prej tij (si automjet në vitin 2007 në shumën 220.000 lekë, garazh në vitin 2013 në shumën 2.700.000 lekë, kursime *cash* në vitin 2015 në shumën 900.000 lekë, kursime *cash* në shumën 7.000 euro të dhëna hua shtetasit A. H. në vitin 2014, si dhe likuiditete në llogari bankare në shumën 1.143.702 lekë).

33.26 Analiza kumulative u krye për periudhën 2005 - qershor 2015, (periudhë para emërimit në detyrën e prokurorit), pasi subjekti ka krijuar edhe pasuri të tjera (si automjet në vitin 2007 në shumën 220.000 lekë, garazh në vitin 2013 në shumën 2.700.000 lekë, kursime *cash* në vitin 2015 në shumën 900.000 lekë, kursime *cash* në shumën 7.000 euro të dhëna hua shtetasit A.H në vitin 2014, si dhe likuiditete në llogari bankare në shumën 1.143.702 lekë), duke marrë në konsideratë faktet si vijon:

- i. Referuar akteve, subjekti ka lidhur martese ligjore në vitin 2002, dhe veçimi nga trungu familjar është kryer në vitin 2007;
- ii. Si oficer i policisë gjyqësore ka deklarime periodike për vitet 2003 dhe 2004;
- iii. Në deklaratën e vitit 2004, nuk janë deklaruar kursime nga puna në vite;
- iv. Subjekti nuk ka qenë subjekt subjekt deklarues nga viti 2005 deri në qershor 2015;

33.27 Sa më sipër, Komisioni vlerësoi që për periudhën para marrjes së detyrës (qershor 2005-qershor 2015) të kryejë një analizë kumulative, mbi mundësitë e subjektit për krijimin e pasurive dhe likuiditeteve.

33.28 Në analizën financiare u përllogaritën të ardhurat e ligjshme nga pagat për subjektin dhe bashkëshorten, sipas tabelës vijuese.

⁶⁰ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022.

⁶¹ Depozituar nga subjekti me nr. *** prot., në datën 2.10.2023.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare 2005 – qershor 2015

<i>PERSHKRIMI</i>	2005-qershor 2015
PASURI	4 963 702
<i>Gjendje kumulative</i>	
Automjet blere ne 2007	220 000,00
Garazh 108,72 m2 ne dt. 14.06.2013	2 700 000,00
<i>Shtesa/Pakesime likuiditete</i>	<i>2 043 702</i>
Likuiditete Gjendje	2 043 702
Gjendje cash sipas DPV	900 000
DETYRIME	
PASURI NEIIO = Pasuri - Detyrime	4 963 702
TE ARDHURA	11 202 690
Te ardhura nga paga e subjektit	7 384 873
Te ardhura nga paga e b/sh	3 117 818
Kredi RZB per mobilim	700 000
Kthim borxhi nga A. H	
SHPENZIME	9 514 561
Shpenzime jetese	6 227 224
Shpenzime udhetimi TIMS	630 688
Shpenzime mobilimi	654 504
Shpenzime shkollimi	114 000
Dhenie huaje shtesatit A. H	980 770
Shpenzime kest dhe principal kredia	907 374
REZULTATI	-3 275 572

33.29 Konstatime të Komisionit

- Pasaktësi në deklarin, pasi nuk është deklaruar burimi i krijimit për pasurinë garazh, në deklaratën *Vetting* dhe as në DPV-në e vitit 2015 para fillimit të detyrës.
- Ka mospërputhje në deklarime, pasi gjatë hetimit subjekti deklaroi se nuk ka kryer veprim financiar për blerjen e kësaj pasurie, ndryshe nga sa shkruhet në kontratën e shitblerjes.
- Analiza financiare kumulative për periudhën 2005 – 2015 ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e ½ së garazhit dhe krijimin e pasurive të tjera, duke rezultuar me balancë negative në shumën 3.275.572 lekë.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime të Komisionit subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

33.30 Subjekti përmes prapësimeve të tij ka parashtruar të njëjtat rrethana, siç ka shpjeguar edhe gjatë hetimit administrativ, lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë së pasurisë garazh, të ndodhur në objektin *-katësh të ndërtuar nga babai në kuadër të marrëveshjes së lidhur në vitin 2007 me pronarin e truallit I.K dhe shoqërisë ndërtuese “K ***”.

Sipas subjektit, e vetmja pasuri për të cilën babai apo edhe shtetasi A.Z nuk kishin realizuar më parë shitje tek të tretë ishte pasuria garazh, dhe duke qenë se shtetasi I.K dëshironte të “çlirohej” nga pasuritë që nuk i përkisnin atij, po në datën 5.6.2013 është përpiluar kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., për shitblerjen e kësaj pasurie.

Subjekti sqaron se të dhënat e regjistrimit të kontratës, si numri i repertorit dhe ai i koleksionit, janë shënuar nga noterja në datën 14.6.2013, pasi vetëm në këtë datë ajo ka

poseduar kartelën e pasurisë së paluajtshme të rifreskuar, që e lejonte të ekzekutonte kontratën e shitblerjes.

Subjekti ka shpjeguar se përpilimi i kontratës së shitblerjes datë 14.6.2013 nën emrin e tij është bërë me pëlqim verbal edhe nga trashëgimtarët e tjerë, konkretisht të nënës dhe motrës.

33.31 Në lidhje me çmimin e garazhit të përcaktuar në kontratën e shitblerjes, subjekti ka shpjeguar se ky veprim juridik është përdorur vetëm si një mekanizëm ligjor për të përmbushur detyrimin që buronte nga kontrata e sipërmarrjes së vitit 2007. Pavarësisht faktit se në kontratë është cilësuar çmimi i shitjes prej 5.400.000 lekësh, në realitet, ndryshimi i pronësisë së pasurisë nuk është shoqëruar me kryerjen e veprimeve ekonomiko-financiare. Sipas subjektit, çmimi i vendosur në kontratë është shënuar vetëm për shkak se kjo pasuri ka qenë e rivlerësuar sipas legjislacionit të kohës, vlerë kjo diçka më e lartë se vlera e çmimit të evidentuar në kontratë.

33.32 Në lidhje me mungesën e burimeve për blerjen e pasurisë, subjekti përmes parashtrimeve sa më sipër pretendon se ka argumentuar dhe provuar në mënyrë bindëse se pasuria garazh ka kaluar në favorin e tij, dhe pa u shoqëruar me përdorim apo shpenzim të fondeve monetare.

Sipas subjektit, elementet e pasqyruara tek kontrata e shitblerjes datë 14.6.2013, ku çmimi i shitjes prej 5.400.000 lekësh është likuiduar jashtë zyrës noteriale në formën “me lekë në dorë” dhe se palët nuk kanë asnjë pretendim për likuidimin e vlerës totale të çmimit, janë elemente përbërëse dhe shabllone të një kontrate, por që në rastin konkret nuk përfaqësojnë realitetin.

33.33 Subjekti i është referuar nenit 681 të Kodit Civil, sipas të cilit parashikohet se: *“Kur interpretohet një kontratë duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës”*. Sipas subjektit, referuar këtij parashikimi, rezulton e qartë se qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, si dhe nga sjellja e tij para dhe pas lidhjes së kontratës shpreh transferimin e pronësisë dhe lidhja e kontratës së shitblerjes datë 14.6.2013 ka qenë pikërisht për “zhveshjen” dhe/apo “çlirimin” e shtetasit I.K nga një pasuri që, në zbatim të marrëveshjes së vitit 2007, nuk përfaqësonte një pasuri që do t’i kalonte atij në pronësi.

33.34 Në vijim, subjekti ka prapësuar se sjellja e tij përputhet edhe me përmbajtjen e nenit 683 të Kodit Civil, ku parashikohet se *“Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të ketë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt”*, si dhe nenit 684 të Kodit Civil, ku parashikohet: *“Kushtet e kontratës, që mund të merren me dy kuptime, interpretohen sipas praktikës së vendit ku është përfunduar kontrata. Kur njëra nga palët është sipërmarrëse, kushtet me dy kuptime interpretohen sipas praktikës së vendit ku ndodhet selia e ndërmarrjes”*.

33.35 Subjekti ka referuar edhe një vendim unifikues nr. 932, datë 22.6.2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me interpretimin e kësaj dispozite⁶², duke

⁶² “Përmbajtja e kësaj dispozite dhe atyre që përcaktojnë kushtet e përgjithshme të kontratave të çon në përfundimin që edhe liria e kontraktimit nuk është absolute. Ajo gjithsesi mund “të kufizohet” nga disa faktorë ekonomikë e moralë, siç janë edhe ato që përmendëm në dispozitën e sipërcituar, e që duhet t’i ketë parasysh edhe gjykata në zgjidhjen e çdo çështjeje konkrete. Injorimi i faktorëve të mësipërm të çon në mungesë proporcionaliteti, apo, siç shprehet ligjvënësi, në dëmtim të shpërpjesëtuat të interesave të palës kontraktuese, gjë që nënkupton që vullneti (pëlqimi) i kësaj pale nuk ka qenë krejt i lirë”... Sipas nenit 686/2 të Kodit Civil, “Janë të pavlefshme kushtet e përgjithshme që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuat të

argumentuar se kontrata e shitblerjes datë 14.6.2013 duhet të “interpretohet ... pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve”, por duke marrë në vlerësim objektiv “se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve ... para e pas përfundimit të kontratës”, duke interpretuar çdo sjellje të palëve para e pas përfundimit të kontratës.

Në këtë këndvështrim subjekti ka prapësuar se lidhja e kësaj kontrate shitblerjeje është përdorur si i vetmi mekanizëm ligjor për përmbushjen e detyrimeve që buronin nga i ndjeri babai i tij. Për rrjedhojë, subjekti pretendon se në këtë rast nuk mund të ketë vend për analizimin e ekzistencës së burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë në fjalë.

33.36 Në lidhje me analizën financiare subjekti pretendon se analiza financiare pas marrjes së detyrës nuk i rezulton me diferenca negative, ku pasuritë dhe shpenzimet justifikohen tërësisht me burime financiare të ligjshme dhe të deklaruara nga ana e tij. Ndërkohë, analiza financiare përpara fillimit të detyrës jep një diferencë negative në shumën 3.275.572 lekë, vlerë kjo që përbëhet nga vlera e pasurisë garazh referuar kontratës së shitblerjes datë 14.6.2013, në shumën 2.700.000 lekë dhe pjesa tjetër në vlerën 575.572 lekë.

33.37 Subjekti pretendon që vlera e pasurisë garazh nuk duhet të përfshihet në analizë financiare, pasi e vendos subjektin në kushte joreale dhe njëkohësisht shtrembëron analizën reale të pasurive të krijuara prej tij, pasi nuk ka shpenzuar asnjë shumë, shtrembëron realitetin dhe njëkohësisht çon në konkluzione të gabuara.

33.38 Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti përmes prapësimeve të tij ka depozituar si dokument provues:

- deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2023, të nënshkruar nga nëna N.H dhe motra e subjektit G.H;
- deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2023, të lëshuar nga shtetasi I.K;
- deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.12.2023, të lëshuar nga shtetasi A.Z.

Vlerësimi i Komisionit

33.39 Trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit, prapësimeve të tij, si dhe dokumentacionit të administruar në dosje, vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit.

33.40 Referuar referuar nenit 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti kishte detyrimin ligjor për të deklaruar burimin e krijimit për pasurinë garazh, në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2015, si dhe situatën mbi moskryerjen e veprimeve financiare, për blerjen e garazhit.

33.41 Lidhur me pretendimin e subjektit se kalimi i pronësisë së garazhit në bashkëpronësi të tij nuk është shoqëruar me veprim financiar dhe kontrata e shitblerjes duhet të interpretohet pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, Komisioni sjell në vëmendje se:

interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e këtij Kodi që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale”. “Në raste të tilla gjykatat duhet të kenë parasysh rregullin e njohur sipas të cilit, pjesët e pavlefshme nuk e bëjnë detyrimisht të pavlefshëm të gjithë veprimin juridik”

- referuar nenit 659 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë përcaktohet se: *“Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*;
- neni 660 i Kodit Civil parashikon se: *“Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”*;
- referuar nenit 663 të Kodit Civil përcaktohen kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, të cilat janë: *“Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin; shkak i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi; objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”*;
- referuar nenit 690 të Kodit Civil përcaktohet se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”*.

33.42 Në zbatim të dispozitave të sipërcituara dhe analizimit të tyre në harmoni me provat e administruara në dosjen e hetimit administrativ lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, trupi gjykues vlerëson se vetë subjekti ka deklaruar në deklarin para fillimit të detyrës viti 2015 dhe deklaratën *Vetting*, blerjen e kësaj pasurie në shumën 5.400.000 lekë, dhe këtë deklarin e ka shoqëruar me aktin ligjor kontratë shitblerjeje datë 14.6.2013 për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të tij. Nëse do të ndodhej në kushte të tjera, siç është pretenduar gjatë hetimit dhe në prapësime, këto rrethana mund të ishin deklaruar nga subjekti në rubrikën e ‘të dhënave konfidenciale’. Komisioni çmon se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të karakterit deklarativ dhe të pambështetura në ligj e prova, ndaj si të tilla nuk mund të pranohen.

33.43 Lidhur me analizën kumulative, kjo analizë u krye nga Komisioni për periudhën para marrjes së detyrës së prokurorit (qershor 2015), pra për periudhën 2005- qeshor 2015, nisur nga faktet vijuese:

- i. subjekti ka krijuar disa pasuri dhe likuiditete si automjet në vitin 2007 në shumën 220.000 lekë, garazh në vitin 2013 në shumën 2.700.000 lekë, kursime cash në vitin 2015 në shumën 900.000 lekë, kursime cash në shumën 7.000 euro, si dhe likuiditete në llogari bankare në shumën 1.143.702 lekë);
- ii. nuk ka qënë subjekt deklarues gjatë kësaj periudhe të analizuar;
- iii. në deklaratën e vitit 2004 si opgj, nuk janë deklaruar kursime nga puna në vite;
- iv. subjekti ka lidhur martesë ligjore në vitin 2002, dhe veçimi nga trangu familjar është kryer në vitin 2007.

33.44 Analiza kumulative financiare për periudhën para marrjes së detyrës ka rezultuar me një balancë negative në shumë 3.2 milion lekë, ku vlera prej 2.7 milion lekë i përket pasurisë garazh, ndërsa për diferencën në shumën rreth 500.000 lekë, Komisioni nuk mund të saktësojë se kjo mungesë e burimeve të ligjshme i përket blerjes së automjetit në shumën 220.000 lekë, likuiditeteve si depozitë bankare në shumën 1.1 milion lekë, kursimeve cash në shumën 900.000 lekë, apo mbulimit të ndonjë shpenzimi tjetër.

33.45 Analiza financiare për periudhën gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit, ka rezultuar me balanca pozitive.

33.46 Trupi gjykues përfundimisht ka konkluduar se, pasaktësitë në deklarin të konstatuara në deklaratën *vetting*, si dhe mungesa e burimeve të ligjshme për pasuritë e krijuara para marrjes së detyrës së prokurorit, (në total balanca negative në shumën 3.2 milion lekë), nuk

përbën shkak të mjaftueshëm për të aplikuar dispozitat e parashikuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por do të mbahen në konsideratë nga Komisioni, në vlerësimin tërësor të procesit të rivlerësimit.

34. Ndërtesë * kate⁶³ me sipërfaqe 409.5 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 182 m², trualli në pronësi shtet, i ndodhur në rrugën “K e P”, Tiranë, në bashkëpronësi të subjektit dhe familjarëve të tij

34.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është ndërtuar nga babai në vitin 2006 dhe vetëdeklaruar prej tij për legalizim pranë ALUIZNI-t Tiranë, pasuri në bashkëpronësi, trashëgimi nga babai. Subjekti nuk ka deklaruar vlerë për këtë ndërtim informal.

34.2 Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-në e vitit 2015 (para fillimit të detyrës).

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

34.3 Komisioni ka kërkuar informacion pranë institucioneve përkatëse si vijon:

- a) ASHK Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1⁶⁴ ka konfirmuar dhe dërguar dokumentacionin përkatës të regjistrimit të disa pasurive⁶⁵ të paluajtshme në bashkëpronësi të shtetasve Ilir Hoxha, N.H dhe G.H.
- b) ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁶⁶ ka dërguar kopje të praktikës së legalizimit me nr. ***, datë 27.3.2017, në emër të shtetasve Ilir Hoxha, N.H dhe G.H.

⁶³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentet vijuese: (1) shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.12.2016 nga Drejtoria e ALUIZNI-t Kamëz, Vorë, drejtuar Drejtorisë së ALUIZINI-t Tirana Veri, ku rezultoi se shtetasi G.H ka aplikuar për legalizim objekti informal me formularin nr. *** prot., datë 8.11.2006, pranë Njesisë Bashkiake Nr. *, Tiranë (e njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 23.1.2017); (2) tabelë me të dhënat e regjistrimit pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI Tiranë, të objektit informal të G.H, në Tiranë, Njësia Nr. *; (3) vetëdeklarim (Shtojca A) datë 8.11.2006, për legalizimin e objektit “ndërtesë për shtëpi banimi 4 kate + papafingo”, me funksion “shtëpi për banim”, viti i ndërtimit 2004, deklarues G.H, me sipërfaqe ndërtimi 182 m², numri i kateve mbi tokë *; (4) Mandat bankar pranë Credins Bank datë 3.9.2009, vlera 4.000 lekë, paguar nga G.H tarifë e shërbimit për legalizim. B/lidhur formulari i pagesës së tarifës së shërbimit, paguar nga G.H; (5) shkresë kthim përgjigje nr. *-G/* prot., datë 14.7.2010, lëshuar nga ZVRPP Tiranë për G.H, ku konfirmohet se pasuria nr. **, z. k. *** me sip. trualli 7.430 m² është pronë - shtet; (6) aktmarrëveshje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.6.2010 e shtetasve G.H, N.D, A.H, G.Ç, I.A, E.M, të cilët deklarojnë se shtetasi G.H, në vendin e njohur “K e P”, Njësia Administrative nr. *, Tiranë, bazuar në aktmarrëveshjen noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2006 dhe deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.2.1995 ka poseduar dhe disponon lirisht një sipërfaqe toke prej 409.5 m², të cilën e ka rrethuar me mure ndërtues. Mbi këtë pronë, në një sipërfaqe prej 171.6 m² është ndërtuar një objekt me funksion banesë e përbashkët, shumëkatëshe (4 kate + papafingo), ku në pjesët takuese të ndara më parë prej tyre, banon secila prej familjeve. Në fillim të procesit të legalizimit, ky ndërtim është vetëdeklaruar nga poseduesi i truallit G.H. Deklaruesit kanë rënë dakord për ndarjen fizike të objektit në të cilën shtetasi G.H do të përfitojë sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 237.9 m², e pa zënë me ndërtim, por e rrethuar me mur rrethues; sipërfaqen prej 38 m² e destinuar për garazh (1B); sipërfaqen prej 106.2 m² e destinuar për banim (1C); sipërfaqen prej 108.6 m² e destinuar për banim (2B); sipërfaqen prej 181.5 m² e destinuar për banim (5A). Bashkëlidhur ndodhen planimetritë e objektit të secilit kat; (7) Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.4.2015, ku shtetasi N.H, Ilir Hoxha, G.H, deklarojnë se në kuadër të procesit të legalizimit të ndërtimeve informale nga ana e shtetasit G.H janë realizuar vetëdeklarime nr. *** prot., datë 8.11.2006, kryer pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Tiranë, si dhe nr. *** prot., datë 18.9.2006, kryer pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Pogradec. Në kushtet kur deklaruesit, si trashëgimtarë të të ndjerit G.H, posedojnë më shumë se një ndërtim pa leje, ata deklarojnë se vetëdeklarimi nr. *** prot., përbën vetëdeklarim primar, ndërsa vetëdeklarimi nr. *** përbën vetëdeklarim të dytë, ndaj për këtë objekt të aplikohet çmimi i përcaktuar në bazë të hartës së vlerës së pronës sipas masës në fuqi (dokumentacioni i mësipërm është i njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 24.10.2016).

⁶⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2023 dhe shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2023.

⁶⁵ 1) Pasuria nr. *** e llojit truall me sip. 345.5 m²; (2) pasuria nr. ***-ND e llojit ndërtesë me sip. 171.4 m²; (3) pasuria nr. *** e llojit apartament me sipërfaqe 25.18 m²; (4) pasuria nr. *** e llojit apartament me sip. 36.14 m²; (5) pasuria nr. *** e llojit apartament me sip. 110.08 m²; (6) pasuria nr. *** e llojit apartament me sip. 92.97 m²; (7) pasuria nr. *** e llojit apartament me sip. 89.4 m²; (8) pasuria nr. *** e llojit apartament me sip. 86.5 m²; (9) pasuria nr. *** e llojit apartament me sip. 89.4 m²; (10) pasuria nr. *** e llojit apartament me sip. 86.5 m²; (11) pasuria nr. *** e llojit apartament me sip. 175.9 m².

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2022.

c) ASHK Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë⁶⁷ ka konfirmuar se shtetasi G.H.H rezulton vetëdeklarues me nr. *** prot., datë 8.11.2006, ndërtim pa leje, në Njësine Administrative Nr. *, Tiranë. Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin dixhital të vendimeve të legalizimit rezulton i pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 27.3.2017, për godinë banimi * kate, Njësia Administrative Nr. * Tiranë, shtetasit N.H, Ilir Hoxha dhe G.H.

34.4 Nga hetimi i kryer për këtë pasuri ka rezultuar se babai i subjektit, përmes formularit të vetëdeklarimit nr. *** prot., datë 8.11.2006, ka aplikuar për legalizim të një objekti informal “Ndërtesë për shtëpi banimi * kate + papafingo” tek Njësia Bashkiake Nr. *, Tiranë.

Sipas formularit të vetëdeklarimit sipërfaqja e zënë deklarohet 409.5 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit 182 m², me vit ndërtimi 2004.

34.5 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar aktmarrëveshjen nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.6.2010, të nënshkruar nga babai G.H dhe shtetasit N.D, A.H, G,Ç, IA dhe E.M, ku deklarohet se shtetasi G.H, në vendin e njohur “K e P”, Njësia Administrative Nr. *, Tiranë, ka poseduar dhe disponon lirisht një sipërfaqe toke prej 409.5 m², të rrethuar me mure ndërtuese. Mbi këtë tokë është ndërtuar një objekt shumëkatësh (4 kate + papafingo) me sip. 171.6 m², ku në pjesët takuese të ndara më parë prej tyre banon secila prej familjeve. Ky ndërtim është vetëdeklaruar për legalizim nga shtetasi G.H, si përfaqësuesi i tyre dhe posedues i truallit. Përmes kësaj aktmarrëveshjeje datë 14.6.2010, palët kanë rënë dakord për ndarjen fizike të objektit 5-katësh, duke përcaktuar secili sipërfaqet e tyre takuese nga ky ndërtim.

34.6 Nga verifikimi i dokumentacionit të pasurisë të ardhur nga ASHK-ja⁶⁸ ka rezultuar se objekti “Godinë banimi * kate” është legalizuar nga ALUIZNI Tiranë Veri me lejen e legalizimit nr. ***, datë 27.3.2017⁶⁹ (pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* nga subjekti në datën 25.1.2017) në emër të shtetasve Ilir Hoxha, N.H dhe G.H, si trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit G.H, për sipërfaqen e parcelës ndërtimore 345.3 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 171.4 m². Ndërsa pronësia e truallit mbi të cilin ndodhet ky objekt është fituar bazuar në VKM-në Nr. ***, datë 29.12.2017 “Për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive që preken prej tyre” dhe regjistruar në emër të subjektit, nënës dhe motrës së tij.

34.7 Nga aktet në dosje ka rezultuar se regjistrimi i këtij objekti pranë ASHK-së është kryer në vitin 2018, në emër të bashkëpronarëve H, të cilët janë pajisur me certifikatë pronësie, duke zotëruar secili 1/3 e pasurisë truall me sip. 345.5 m² dhe ndërtesë⁷⁰ me sip. 171.4 m². Në datën 14.7.2021 është kryer ndarja e objektit bazuar në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.6.2021, të lëshuar nga bashkëpronarët Ilir, N dhe G.H, të cilët kanë deklaruar ndarjen e objektit në apartamente⁷¹ dhe pajisjen me certifikatat respektive të pronësisë.

⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 13.10.2022.

⁶⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 21.10.2022, e Drejtorisë Vendore Tiranë Veri; shkresa e Drejtorisë Vendore Tiranë Rurale * nr. *** prot., datë 8.6.2023 dhe shkresa nr. *** prot., datë 26.7.2023.

⁶⁹ Leja e legalizimit për godinë banimi * kat: sip. kati përdhe 171.4 m²; sip. kati i parë 188.2 m²; sip. kati i dytë 188.2 m²; sip. kati i tretë 188.2 m² dhe sip. kati i katërt 188.2 m².

⁷⁰ Kjo pasuri fillimisht ka qenë e regjistruar me nr. pasurie ***-ND, vol. ***, f. ***, por është mbyllur më pas, duke kaluar tek pasuria nr. ***.

⁷¹ (1) Pasuria nr. ***, apartament me sip. 25.18 m²; (2) pasuria nr. ***, apartament me sip. 36.14 m²; (3) pasuria nr. ***, apartament me sip. 110.08 m²; (4) pasuria nr. ***, apartament me sip. 82.93 m²; (5) pasuria nr. ***, apartament me sip. 92.97

34.8 Komisioni i ka kërkuar⁷² subjektit të deklarojë nëse ka kaluar pronësia e apartamenteve tek shtetasit me të cilët babai i tij ka lidhur marrëveshje në vitin 2010, për të cilën subjekti ka shpjeguar⁷³ se nga ana e tyre si trashëgimtarë janë ndërmarrë hapat e nevojshëm me qëllim transferimin e pronësisë tek përfituesit realë, duke realizuar pjesën dërmuese të tyre.

Subjekti ka depozituar kopje të kontratave⁷⁴ përmes të cilave evidentohet kalimi i pronësisë së apartamenteve tek përfituesit realë, ndërsa ka shpjeguar se për dy pasuri të tjera nuk është kryer ende veprimi juridik i kalimit të pronësisë për shkaqe objektive.

Lidhur me koston e ndërtimit të objektit *-katësh

34.9 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është trashëguar nga i ndjeri babai i tij. Komisioni i ka kërkuar⁷⁵ subjektit të deklarojë nëse ka kontribuar në krijimin e kësaj pasurie dhe, nëse po, të deklarojë masën e këtij kontributi, për të cilën subjekti ka shpjeguar⁷⁶ se nuk ka kontribuar në ndërtimin e këtij objekti, por ka kontribuar vetëm në privatizimin e truallit mbi të cilin ishte ndërtuar ky objekt, në shumën 100.000 lekë në bono privatizimi, vlerë e deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës.

34.10 Nga verifikimi i pamjeve fotografike të printuara nga *Google Maps* (në *website*), evidentohet se deri në vitin 2004 nuk ka ndërtim dhe në qershor 2007 ndërtimi duket i përfunduar.

34.11 Konstatime të Komisionit

- Pasuria e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në DPV para fillimit të detyrës në vitin 2015 është ndërtim pa leje i kryer nga babai, i vetëdeklaruar për legalizim në vitin 2006 dhe, pas vdekjes së të ndjerit, leja e legalizimit nr. ***, datë 27.3.2017, për godinë banimi * kate, Njësia Administrative Nr. *, Tiranë, rezulton në emër të trashëgimtarëve ligjorë: nënës N.H, subjektit Ilir Hoxha dhe motrës G.H.
- Dokumentacion i paplotë mbi të ardhurat e babait për ndërtimin e kryer në vitin 2006.

Vlerësimi i Komisionit për ndërtesën *-katëshe

m²; (6) pasuria nr. ***, apartament me sip. 89.4 m²; (7) pasuria nr. ***, apartament me sip. 86.5 m²; (8) pasuria nr. ***, apartament me sip. 89.4 m²; (9) pasuria nr. ***, apartament me sip. 86.5 m²; (10) pasuria nr. ***, apartament me sip. 175.9 m².

⁷² Përmes pyetësorit me *email* datë 20.9.2023.

⁷³ Shpjegimet e subjektit depozituar në datën 2.10.2023.

⁷⁴ (1) Kontratë dhurimi pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.7.2022, e lidhur me shtetasit N.D dhe L.D të cilëve u është transferuar pronësia mbi pasuritë e paluajtshme nr. *** dhe nr. ***.

(2) Kontratë dhurimi pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.7.2023, e lidhur me shtetasit M.H; V.H dhe N.H, të cilave u është transferuar pronësia mbi pasurinë e paluajtshme nr. ***; Subjekti ka shpjeguar se nga të thëna verbale i rezulton se në muajin tetor ose nëntor 2006, i ndjeri babai i tij, ka marrë nga shtetasi A.H, i cili ka ndërruar jetë më 29.3.2022, dhe që njëkohësisht është bashkëshorti i tezes, shumën 1.400.000 lekë, veprim ky që, për shkak të kësaj lidhjeje nuk është dokumentuar asnjëherë me ndonjë akt shkresor apo noterial; (3) kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.7.2023, e lidhur me shtetasin I.N, të cilit i është transferuar pronësia mbi pasurinë e paluajtshme nr. ***.*, ku çmimi i apartamentit në shumën 50.000 euro, i shlyer sipas deklaratës noteriale të vitit 2007. Subjekti ka shpjeguar se babai i tij ka lidhur me të ndjerin G.Ç deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.2.2007, ndërkohë, i ndjeri G.Ç ka pas lidhur me shtetasin I.N akt noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.2.2007, nëpërmjet së cilës shtetasi G.Ç (i cili ka ndërruar jetë) merr përsipër që pronësinë mbi këtë pasuri t'ia kalojë shtetasit I.N; (4) Ndërkohë, subjekti deklaroi se si trashëgimtarë ligjorë kanë detyrimin për transferimin e pronësisë edhe të pasurive të paluajtshme me nr. *** dhe nr. ***, tek shtetasit I.A dhe E.M. Subjekti ka shpjeguar se dhurimi i pasurisë tek shtetasi I.A nuk është realizuar për shkak se ky shtetas gjendet në proces ndarje / divorci me bashkëshorten e tij, rrethanë kjo që ka pas sjellë largimin e tij nga banesa. Po ashtu edhe me shtetasin E.M, nuk është bërë i mundur kalimi i pasurisë përmes dhurimit, për shkak se nga ky shtetas janë paraqitur pretendime për mosevidentim të sipërfaqes së saktë në certifikatën e pronësisë.

⁷⁵ Përmes pyetësorit me *email* datë 12.10.2022.

⁷⁶ Shpjegimet e subjektit dërguar me *email* datë 21.10.2022.

34.12 Referuar akteve ligjore dhe fakteve të rezultuara gjatë hetimit, kjo pasuri është krijuar nga babai para vitit 2006 (para marrjes së detyrës së prokurorit në 2015) dhe subjektit i ka kaluar nëpërmjet trashëgimisë ligjore, 1/3 e kësaj pasurie. Pavarësisht faktit se subjekti gjatë hetimit nuk arriti të dokumentojë të ardhurat e ligjshme të babait, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk është në kushtet e 32/4 të ligjit nr.84/2016, dhe nuk ka detyrimin të provojë burimet e ligjshme për pasuritë e krijuara nga prindërit, dhe për këtë arsye trupi gjykues çmoi të mos i kalojë subjektit barrën e provës në rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor për pasuritë e krijuara nga babai.

34.13 Për këtë pasuri, në deklaratën *Vetting* subjekti duhet të kishte deklaruar të drejtat reale, në zbatim të nenit 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, sipas së cilës subjektet detyrohen të deklarojnë pasuritë e paluajtshme, të drejtat reale mbi to, si dhe burimin e krijimit të tyre.

35. Automjet tip “M-B”⁷⁷, blerë në datën 22.5.2007, në vlerën 220.000 lekë

35.1 Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-në e vitit 2015 (para fillimit të detyrës).

35.2 Nga informacioni i ardhur nga DPSHTRR-ja⁷⁸ konfirmohet automjeti në pronësi të subjektit Ilir Hoxha.

35.3 Nga aktet në dosje ka rezultuar se subjekti ka lidhur kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.5.2007, me shitësin Th.B, për blerjen e automjetit tip “M-B”, me vit prodhimi 1992, në vlerën 220.000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në datën 25.8.2007, subjekti është pajisur me certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor.

35.4 Komisioni verifikoi lidhur me çmimin e blerjes së automjetit, ku nga dosja e mjetit evidentohet se shitësi Th.B e ka blerë nga shtetasi N.S me kontratën e shitjes datë 17.4.2002, në çmimin 1.500 euro, si dhe ka kryer zhdoganimin e automjetit në datën 20.4.2002, në vlerën 194.071 lekë.

35.5 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt interesi të mundshëm të subjektit të rivlerësimit me shitësin Th.B, ku nga përgjigjja e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë⁷⁹ nuk ka rezultuar ndonjë procedim penal i regjistruar për këtë shtetas.

Lidhur me burimin e krijimit

⁷⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin e njëzuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 24.10.2016: (1) certifikata e pronësisë së mjetit rrugor M-B, vit prodhimi 1992 me targë PG *** B, në pronësi të Ilir Hoxha; (2) kontratë shitje (automjeti) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.5.2007, me palë shitëse Th.B dhe palë blerëse Ilir Hoxha, të automjetit në vlerën 220.000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale; dokumentacionin e njëzuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 23.1.2017: (1) shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.12.2016 nga DPSHTRR-ja, ku konfirmohet se shtetasi G.H, N.H dhe G.H nuk kanë automjete në pronësi të tyre, ndërsa Ilir Hoxha ka në pronësi automjetin me targë PG *** B; (2) shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.1.2017 nga DPSHTRR-ja për dërgimin e dokumentacionit të praktikës së automjetit; (3) shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2016 nga DPSHTRR Drejtoria Rajonale Korçë, drejtuar DPSHTRR Tiranë, për dërgimin e dokumentacionit të mjetit me targë PG *** B; (4) kërkesë datë 13.12.2016 nga Ilir Hoxha drejtuar DPSHTRR për pajisjen me dokumentacion për mjetet që figurojnë në pronësi (aktuale ose të mëparshme) të tij dhe familjarëve; (5) shkresë nr. ***prot., datë 14.12.2016 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, për kërkesën e parashtruar në shkresën datë 13.12.2016 nga Ilir Hoxha.

⁷⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 30.7.2021.

⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.9.2022.

35.6 Subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* dhe as në DPV-në e vitit 2015 (para fillimit të detyrës).

35.7 Komisioni i ka kërkuar⁸⁰ subjektit të deklarojë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, si dhe të shpjegojë arsyen e mosdeklarimit të saj në deklaratën *Vetting*, për të cilën subjekti ka shpjeguar⁸¹ se 220.000 lekë janë kursime nga puna e tij ndër vite si oficer i policisë gjyqësore.

35.8 Në mbështetje të shpjegimeve të tij subjekti ka depozituar⁸² si dokumentacion provues:

- vërtetimin nr. *** prot., datë 18.10.2016, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila konfirmon të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e realizuara nga subjekti, si oficer i policisë gjyqësore gjatë periudhës 1.4.1995 – 3.6.2015;
- shkresën nr. *** prot., datë 7.10.2016, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila konfirmon të ardhurat nga paga të subjektit për periudhën 16.1.2001 – 15.10.2001, të cilat janë në vlerën totale 297.293 lekë.

35.9 Në lidhje me arsyen e mosdeklarimit në deklaratën *Vetting* të burimit të krijimit të pasurisë, subjekti ka shpjeguar se në deklaratën *Vetting* ka deklaruar edhe pasuri të tjera të luajtshme apo të paluajtshme, për të cilat nuk ka deklaruar burimin e krijimit të tyre. Duke qenë se deklarata *Vetting* përbënte edhe deklaratën e tretë të tij të pasurisë (e para ka qenë ajo e datës 19.6.2015 “para fillimit të detyrës” dhe e dyta ka qenë ajo e datës 15.3.2016 “periodike vjetore”), në perceptimin e tij ka qenë vetëm detyrimi për ta deklaruar çdo pasuri. Për rrjedhojë, mosdeklarimi nga ana e tij e burimit të krijimit të pasurisë ka ndodhur vetëm për shkak të perceptimit të gabuar në deklarim.

Analiza financiare

35.10 Komisioni ka analizuar mundësitë financiare të subjektit për blerjen e automjetit dhe referuar tabelës nr. 1 ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mundësi për blerjen e këtij automjeti dhe përballuar shpenzimet e tjera të kryera gjatë periudhës 2005 – 2015.

35.11 Konstatime të Komisionit

- Nga analiza financiare për periudhën 2005 – 2015 ka rezultuar me balancë negative, çka tregon mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit dhe për të mbuluar investime të tjera gjatë periudhës së analizuar.
- ✓ Subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

35.12 Në lidhje me fondet e përdorura për blerjen e automjetit, subjekti përmes prapësimeve të depozituara në datën 27.12.2023 rikonfirmon faktin se vlera e blerjes së këtij automjeti kanë qenë kursimet ndër vite nga të ardhurat nga paga. Subjekti ka shpjeguar se ka filluar punë si hetues dhe, në vijim, oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor

⁸⁰ Përmes pyetësorit me *email* datë 12.10.2022.

⁸¹ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022, në përgjigje të pyetësorit datë 12.10.2022.

⁸² Dokumentacion i depozituar nga subjekti në datën 21.10.2022.

Pogradec që prej datës 1.4.1995 dhe, më pas, në datën 15.1.2001 është transferuar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë.

35.13 Subjekti ka referuar të ardhurat e përfituara prej tij, si dhe kursimet nga këto të ardhura ishin më se të mjaftueshme për blerjen e automjetit në datën 22.5.2007. Bazuar në këto fakte të provuara plotësisht, subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit lidhur me analizën financiare nuk qëndron, pasi nga tërësia e të gjitha provave të administruara provohet se kursimet e siguruara nga të ardhurat nga paga janë në vlerë pozitive për blerjen e automjetit prej 220.000 lekësh.

Vlerësimi i Komisionit

35.14 Komisioni, referuar balancës negative për periudhën e analizuar 2005 – 2015, dhe në vlerësim të të gjitha provave dhe fakteve të rezultuara nga hetimi ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për periudhën e analizuar.

36. Llogari bankare⁸³ me gjendje 4.703 lekë në datën 31.12.2016, në Raiffeisen Bank

36.1 Nga verifikimi i të dhënave bankare evidentohet se gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është në shumën 4.703 lekë, e cila përputhet me deklarin e subjektit.

✓ Nga hetimi i kryer nuk evidentohen problematika.

37. Depozitë kursimi⁸⁴ me gjendje 7.514 euro, në datën 31.12.2016, në BKT

37.1 BKT-ja⁸⁵ ka konfirmuar llogarinë e kursimit në monedhën euro, në emër të shtetasit Ilir Hoxha.

37.2 Nga verifikimi i të dhënave bankare evidentohet se kjo llogari kursimi është hapur nga subjekti në datën 2.6.2015, ku është depozituar shuma 6.000 euro dhe gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 paraqitet në vlerën 7.514 euro, e cila përputhet me deklarin e subjektit.

37.3 Në DPV-në e vitit 2015 (para fillimit të detyrës) subjekti ka deklaruar depozitën e kursimit në euro me gjendje 6.000 euro në datën 4.6.2015.

Burimi i krijimit

37.4 Në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj depozite bankare. Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar⁸⁶, ndër të tjera, se arsyeja e mosdeklarimit të burimit ka qenë për shkak të perceptimit të gabuar të ligjit.

37.5 Komisioni i ka kërkuar⁸⁷ subjektit të deklarojë burimin e krijimit të kësaj shume, për të cilin subjekti ka shpjeguar⁸⁸ se si burim kanë shërbyer kursimet familjare nga të ardhurat nga pagat e tij si ish-oficer i policisë gjyqësore, paga e bashkëshortes si infermiere pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pogradec, si dhe interesat bankarë.

⁸³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje të llogarisë në emër të shtetasit Ilir Hoxha pranë Raiffeisen Bank, me gjendjen në datën 31.12.2016, në shumën 4.703,87 lekë (e njëzuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 23.1.2017).

⁸⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje e llogarisë në emër të shtetasit Ilir Hoxha pranë Bankës Kombëtare Tregtare, me gjendjen në llogari datë 31.12.2016, në shumën 7.514 euro (njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 23.1.2017).

⁸⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 11.8.2021.

⁸⁶ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022.

⁸⁷ Përmes pyetësorit me *email* datë 20.9.2023.

⁸⁸ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 2.10.2023.

37.6 Subjekti ka deklaruar se pas emërimit të tij në datën 1.6.2015 është kujdesuar që, për shkak të detyrës së prokurorit si subjekt deklarues, të rregullonte gjendjen *cash* në banesë, ndaj edhe në datën 2.6.2015 ka çelur pranë BKT-së depozitën e kursimit, duke derdhur vlerën 6.000 euro. Ditë më pas, në datën 8.6.2015 ka tërhequr vlerën 1.500 euro, e cila i duhej për disa nevoja personale dhe duke qenë se nuk e ka përdorur të gjithën në datën 9.6.2015 ka depozituar vlerën 1.000 euro. Në vijim, gjendja në këtë depozitë ka qëndruar pothuajse e njëjtë, duke u shtuar vetëm nga interesat bankarë.

37.7 Subjekti ka sqaruar se në kuadër të shlyerjes së detyrimeve që shtetasi A.H kishte karshi tij (e cila do të trajtohet në vijim të këtij vendimi), në datën 13.5.2016 ky shtetas ka depozituar në depozitën e kursimit vlerën 2.000 euro, duke e kredituar në këtë llogari, kështu gjendja e depozitës në datën 31.12.2016 ka qenë në vlerën 7.514 euro.

Analiza financiare

37.8 Referuar analizës kumulative të kryer për periudhën 2005 – qershor 2015, duket se subjekti paraqitet me balancë negative, pra nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për krijimin e shumës dhe përballimin e shpenzimeve të tjera.

37.9 Konstatime të Komisionit

- Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga banka.
- Referuar analizës kumulative për periudhën 2005 – qershor 2015, tabela nr. 1, duket se subjekti ka pamjaftueshmëri për krijimin e depozitës bankare në vitin 2015 apo mbulimin e shpenzimeve të tjera.
- ✓ Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

37.10 Subjekti përmes prapësimeve të tij të depozituara në datën 27.12.2023 ka shpjeguar, ndër të tjera, se pas emërimit të tij në detyrën e prokurorit në datën 1.6.2015 është kujdesuar që, si subjekt deklarues, të rregullonte gjendjen *cash* në banesë. Kështu, nëpërmjet veprimit bankar “depozitim *cash* në valutë”, datë 2.6.2015, ka depozituar pranë BKT-së vlerën 6.000 euro dhe, në vijim, ka çelur pranë kësaj banke një depozitë kursimi në euro. Sipas subjektit, të gjitha fondet e depozituara në depozitën e kursimit në vlerën 6.000 euro kanë pasur prejardhjen nga kursimet familjare nga të ardhurat nga paga e tij si ish – oficer i policisë gjyqësore dhe njëkohësisht edhe nga paga e bashkëshortes si punonjëse (infermiere) pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pogradec.

37.11 Gjatë hetimit administrativ subjekti ka vendosur në dispozicion vërtetimet përkatëse, ku konfirmohen të ardhurat e tij nga paga dhe të bashkëshortes. Sipas subjektit, nga këto të dhëna rezulton e qartë se të ardhurat e tij nga paga si oficer i policisë gjyqësore, si dhe kursimet nga këto të ardhura ishin më se të mjaftueshme për krijimin e kursimeve në vlerën 6.000 euro. Subjekti thekson faktin se kursimet familjare kanë qenë të shtrira në kohë, për të cilat, në kushtet e mospasjes së ndonjë detyrimi ligjor për të evidentuar një gjë të tillë në përfundim të periudhave të caktuara kohore, nuk mund ta përcaktojë ekzaktësisht.

Subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit lidhur me analizën financiare nuk qëndron, pasi nga tërësia e të gjitha provave të administruara provohet se kursimet e siguruar nga të

ardhurat nga paga janë në vlerë pozitive, të tilla që i siguronin vlerën 6.000 euro të çelur në datën 2.6.2015 pranë BKT-së.

Vlerësimi i Komisionit

37.12 Pas prapësimeve, Komisioni, referuar balancës negative për periudhën e analizuar 2005 – 2015 dhe në vlerësim të të gjitha provave dhe fakteve të rezultuara nga hetimi, ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për periudhën e analizuar.

38. Llogari⁸⁹ me gjendje 8.256 lekë në datën 31.12.2016, në BKT

38.1 BKT-ja⁹⁰ ka konfirmuar llogarinë rrjedhëse në emër të shtetasit Ilir Hoxha. Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 paraqitet në shumën 8.256 lekë, e cila përputhet me deklarinimin e subjektit.

✓ Nga hetimi i kryer nuk evidentohen problematika.

39. Llogari⁹¹ në emër të djalit K.H, me gjendje 1.501 lekë, në BKT

39.1 BKT-ja⁹² ka konfirmuar llogarinë bankare në emër të djalit K.H, ku verifikimi i të dhënave bankare rezulton se kjo llogari është hapur në datën 28.12.2016, me gjendje në shumën 1.501 lekë.

✓ Nga hetimi i kryer nuk evidentohen problematika.

40. Depozitë kursimi⁹³ në emër të djalit K.H, me gjendje 278.500 lekë, në BKT

40.1 BKT-ja⁹⁴ ka konfirmuar llogarinë e depozitës në emër të djalit K.H. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar evidentohet çelja e llogarisë bankare në datën 28.12.2016, për shumën e depozituar në vlerën 278.500 lekë, me afat 3 vjet.

40.2 Referuar lëvizjeve të llogarisë në emër të djalit K.H gjatë periudhës 27.12.2016 – 28.12.2016 evidentohet depozitim *cash* nga nëna e subjektit N.H në datën 27.12.2016, në shumën 50.000 lekë, si dhe transferimi i shumës 230.000 lekë nga shtetasi Ilir Hoxha. Në datën 28.12.2016 transferohet shuma 278.500 lekë në depozitë.

Burimi i krijimit

40.3 Në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të depozitës bankare me shumë 278.500 lekë. Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar⁹⁵ se mosdeklarimi i burimit ka qenë për shkak të perceptimit të gabuar të ligjit.

⁸⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje të llogarisë në emër të shtetasit Ilir Hoxha pranë Bankës Kombëtare Tregtare, me gjendje në llogari datë 31.12.2016, në shumën 8.256,16 lekë (njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 23.1.2017).

⁹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 11.8.2021.

⁹¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje e llogarisë në emër të K.H pranë Bankës Kombëtare Tregtare, me gjendje në llogari datë 31.12.2016, në shumën 1.501,65 lekë (njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 23.1.2017).

⁹² Shkresë nr. *** prot., datë 11.8.2021.

⁹³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (1) kontratë depozitë bankare datë 28.12.2016 për K.H pranë Bankës Kombëtare Tregtare. Shuma e depozituar 278.500 lekë, afat 3 vjet; (2) kontratë llogari bankare datë 27.12.2016 për K.H pranë Bankës Kombëtare Tregtare; (3) lëvizjet e llogarisë në emër të K.H pranë Bankës Kombëtare Tregtare, gjatë periudhës 27.12.2016 – 28.12.2016. Evidentohet depozitim *cash* nga N.H në datën 27.12.2016 shuma 50.000 lekë, si dhe transferim i shumës 230.000 lekë në llogari nga Ilir Hoxha. Në datën 28.12.2016 transferohet shuma 278.500 lekë në depozitë.

⁹⁴ Shkresë nr. prot. ***, datë 11.8.2021.

⁹⁵ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 21.10.2022.

Subjekti ka shpjeguar⁹⁶ se si burim për krijimin e depozitës kanë shërbyer kursimet familjare nga të ardhurat nga pagat, kreditimi në vlerën 40.000 lekë me prejardhje nga trashëgimia nga babai, kreditimi në vlerën 150.000 lekë nga nëna N.H, si dhe interesat bankarë.

40.4 Subjekti ka shpjeguar⁹⁷ në mënyrë të detajuar historikun e depozitës së kursimit në emër të djalit, si dhe të gjitha lëvizjet e kësaj depozite, nga ku evidentohet se kjo llogari e ka zanafillën që prej datës 2.2.2015, e çelur pranë Societe Generale Albania.

40.5 Subjekti ka depozituar⁹⁸ librezën e kursimit dhe mandatet bankare ku evidentohen depozitimet⁹⁹ e kryera prej tij, si dhe dy shuma prej 50.000 lekësh, të depozituara nga nëna N.H në datat 25.8.2015 dhe 27.4.2016, ndërsa për një shumë prej 40.000 lekësh të depozituar në datën 11.3.2016 subjekti ka shpjeguar se ka si burim fondet e siguruara nga tërheqja e shumave, si trashëgimtar, nga llogaria e të ndjerit babait të tij pranë Raiffeisen Bank.

Subjekti ka shpjeguar se duke qenë se gjatë vitit 2016 banka ka ndryshuar kushtet e depozitës së kursimit, kanë vlerësuar ta mbyllin këtë llogari në datë 13.05.2016 ku gjendja e llogarisë ka qenë 232.647 lekë dhe nga fondet e tërhequra kanë depozituar shumën 230.000 lekë në BKT në emër të djalit K.H, me afat 3-vjeçar.

40.6 Subjekti ka shpjeguar se në këtë llogari, nëna e tij N.H ka kredituar në datë 27.12.2016 edhe shumën 50.000 lekë dhe në datë 28.12.2016 kontrata e depozitës është ripërtërirë për një afat 3 vjeçar, në vlerën 278.500 lekë. Subjekti ka sqaruar se të gjitha kreditimet e kryera nga nëna e tij në depozitën e kursimit të djalit K.H, e kanë prejardhjen nga kursimet e saj, nga të ardhura e pensionit.

Analiza mbi mundësitë e krijimit të depozitës në vitin 2016

40.7 Komisioni, pas verifikimit të deklarimeve dhe llogarive bankare të djalit të subjektit, kreu analizën financiare për mundësinë e krijimit të kësaj depozite në vitin 2016, sipas tabelës së përgjithshme, nga ku duket se subjekti dhe familja e tij kanë pasur mundësi me burime të ligjshme për krijimin e depozitës dhe përballimin e shpenzimeve.

40.8 Konstatime të Komisionit

- Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.
- Nga analiza financiare duket se subjekti dhe familja e tij kanë disponuar burime të ligjshme për krijimin e depozitës dhe përballimit të shpenzimeve në vitin 2016.

⁹⁶ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 2.10.2023.

⁹⁷ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 2.10.2023.

⁹⁸ Dokumentacion i depozituar nga subjekti me nr. *** prot., datë 2.10.2023: librezë kursimi depozitë Eurokid, në lekë, në emër të K.H datë 2.2.2015 (1 faqe); mandate bankare datë 2.2.2015, datë 12.5.2015, datë 3.4.2015, datë 9.3.2015, datë 13.11.2015, datë 25.8.2015 të lëshuara nga banka Societe Generale Albania; formular për mbyllje llogarie rrjedhëse në emër të G.H e lëshuar në datën 11.3.2016; vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.5.2015; prokurë e posaçme nr. ***rep., nr. ***kol., datë 11.3.2016 nga porositësja N.H; prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.3.2016 nga porositësja G.H; tri mandate bankare për tërheqje nga llogaria, si dhe këmbim valutor *cash* të lëshuara nga Raiffeisen Bank në datën 11.3.2016; mandate bankare të lëshuara nga Societe Generale Albania Bank në datën 11.3.2016, datë 27.4.2016, datë 13.5.2016; kontratë depozitë bankare e lidhur me BKT-në në datat 26.5.2016 dhe 28.12.2016; mandat bankar i BKT datë 28.12.2016; *statement account* i llogarisë së K.H, e lëshuar nga BKT-ja.

⁹⁹ Në datën 2.2.2015 subjekti ka depozituar 20.000 lekë; në datën 12.2.2015, kredituar nga subjekti shuma 5.000 lekë; në datën 3.4.2015, kredituar nga subjekti shuma 55.000 lekë; në datën 9.3.2015, kredituar nga subjekti shuma 5.000 lekë; në datën 13.11.2015, kredituar nga subjekti shuma 5.000 lekë; në datën 25.8.2015, kredituar nga nëna e subjektit shuma 50.000 lekë; në datën 11.3.2016, depozituar shuma 40.000 nga subjekti; në datën 27.4.2016, depozituar shuma 50.000 lekë nga nëna e subjektit.

41. Depozitë kursimi¹⁰⁰ në Societe Generale Albania, në emër të djalit D.H, me gjendje 76.299 lekë

41.1 Nga verifikimi i llogarisë bankare të djalit D.H, gjatë periudhës 2.2.2015 – 30.12.2016 evidentohem depozitime *cash* të shumave nga shtetasit Ilir Hoxha dhe G.H (bashkëshortja e subjektit), ku gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 paraqitet në vlerën 76.299 lekë.

✓ Nga hetimi i kryer nuk evidentohen problematika.

42. Gjendje *cash* në banesë në shumën 1.000.000 lekë

42.1 Nga verifikimi i deklarimeve periodike, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë nga kursimet familjare të krijuara nga paga, në vitet 2015 dhe 2016, si reflektuar në tabelën vijuese:

Tabela nr. 2

Viti	Gjendja <i>cash</i> sipas DPV	Shuma e deklaruar
2015 (para fillimit të detyrës) ¹⁰¹	Gjendje <i>cash</i> në banesë	900.000 lekë
2015 ¹⁰²	Gjendje <i>cash</i> në banesë	1.000.000 lekë
2016	Gjendje <i>cash</i> në banesë	1.000.000 lekë

42.2 Si burim krijimi subjekti ka deklaruar kursimet familjare të krijuara nga të ardhurat nga pagat.

42.3 Komisioni i ka kërkuar¹⁰³ subjektit të deklarojë periudhën e krijimit të kursimeve të deklaruara në DPV-në e vitit 2015 para fillimit të detyrës, për të cilën subjekti ka shpjeguar¹⁰⁴ se kjo gjendje *cash* ka si burim të ardhurat e familjes nga pagat, duke theksuar se këto kursime familjare kanë qenë të shtrira në kohë, për të cilat, në kushtet e mospasjes së ndonjë detyrimi ligjor për të deklaruar, nuk mund të përcaktojnë saktësisht.

Analiza financiare

42.4 Referuar tabelës nr. 1 në analizën kumulative të kryer për periudhën 2005 – qershor 2015, duket se subjekti paraqitet me balancë negative, pra nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për krijimin e shumës 900.000 lekë deri në qershor 2015 dhe përballimit të shpenzimeve të tjera. Subjekti ka pasur mundësi të shtojë shumën *cash* me 100.000 lekë sipas deklarimeve gjatë gjysmës së dytë të vitit 2015.

42.5 Konstatime të Komisionit

- Analiza financiare e kryer për gjendjen *cash* e deklaruar para fillimit të detyrës në shumën 900.000 lekë ka rezultuar me balanca negative referuar periudhës së analizuar 2005 – 2015 (shih tabelën nr. 1).
- ✓ Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁰⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën konfirmimin bankar nr. * prot., datë 4.1.2017, nga banka Societe Generale Albania për D.H, i cili ka një depozitë Eurokid, me gjendje në datën 31.12.2016, në shumën 76.299,99 lekë.

¹⁰¹ Dorëzuar në ILDKPKI në datën 19.6.2015.

¹⁰² Dorëzuar në ILDKPKI në datën 15.3.2016.

¹⁰³ Përmes pyetësorit me *email* datë 20.9.2023.

¹⁰⁴ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 2.10.2023.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

42.6 Subjekti, përmes prapësimeve të tij, ka shpjeguar se pas emërimit në detyrën e prokurorit, si subjekt deklarues, ka vlerësuar të rregulloje gjendjen *cash* në banesë. Për shkak të rrethanave familjare ka vlerësuar se do të ishte më e përshtatshme që në banesë të mbante një sasi *cash*, të cilën të mund ta përdorte lirshëm dhe në çdo moment, duke mbajtur në banesë vlerën 900.000 lekë, ndërsa pjesën tjetër, në vlerën 6.000 euro, të depozitonte në depozitë kursimi, duke çelur në datën 2.6.2015 një depozitë kursimi në euro pranë BKT-së. Subjekti ka shpjeguar se të gjitha fondet *cash* në banesë, në vlerën 900.000 lekë, e kanë pasur prejardhjen nga kursimet familjare nga të ardhurat nga paga si ish-oficer i policisë gjyqësore dhe njëkohësisht edhe nga paga e bashkëshortes si punonjëse (infermiere) pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pogradec.

42.7 Subjekti ka prapësuar se deri në momentin e fillimit të detyrës së prokurorit kanë qenë të tilla që, familjarisht, i lejonin të kishin deri në muajin qershor 2015 edhe kursime në shumën 900.000 lekë. Subjekti thekson se kursimet familjare kanë qenë të shtrira në kohë, për të cilat, në kushtet e mospasjes së ndonjë detyrimi ligjor për të evidentuar një gjë të tillë, në përfundim të periudhave të caktuara kohore nuk mund të përcaktojë ekzaktësisht.

42.8 Subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit lidhur me analizën financiare nuk qëndron, pasi nga tërësia e të gjitha provave të administruara provohet se kursimet e siguruara nga të ardhurat nga kursimet familjare nga pagat janë në vlerë pozitive.

Vlerësimi i Komisionit

42.9 Pas prapësimeve, Komisioni, referuar balancës negative për periudhën e analizuar 2005 – 2015, dhe në vlerësim të të gjitha provave dhe fakteve të rezultuara nga hetimi ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për periudhën e analizuar.

43. Hua¹⁰⁵ dhënë shtetasit A.H, në kohë të ndryshme, në shumën 7.000 euro

43.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se kjo hua është e dokumentuar me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.6.2015, shumë e prejardhur nga kursime familjare.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

43.2 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.6.2015, të lëshuar nga shtetasi A.H, i cili deklaron se ka marrë hua nga z. Ilir Hoxha, konkretisht: (i) shumën 3.000 euro në datën 1.2.2014; (ii) shumën 2.000 euro në datën 1.10.2014; (iii) shumën 2.000 euro në datën 30.12.2014.

Në këtë akt noterial përcaktohet se shuma e marrë hua prej 7.000 euro do t'i kthehej subjektit Ilir Hoxha brenda datës 31.12.2015 dhe në rast mospagimi në afat të shumës, kjo deklaratë konsiderohet titull ekzekutiv për ekzekutimin e detyrimit.

¹⁰⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin e njëzuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 24.10.2016: (1) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.6.2015, e shtetasit A.H, i cili deklaron se ka marrë hua nga shtetasi Ilir Hoxha gjithsej 7.000 euro, të cilat do t'i kthehen brenda datë 31.12.2015; (2) mandat depozitimi bankar pranë Bankës Kombëtare Tregtare nga A.H në favor të Ilir Hoxhës, shuma 2.000 euro, datë 13.5.2016, me përshkrimin "Derdhje në llogari për shlyerje detyrimi".

43.3 Në DPV-në e vitit 2015 para fillimit të detyrës, si dhe deklaratimet periodike vijuese, subjekti ka deklaruar këtë shumë të dhënë hua shtetasit A.H.

43.4 Lidhur me periudhën e kthimit të huas, gjatë hetimit subjekti ka shpjeguar¹⁰⁶ se shlyerja e detyrimit nga shtetasi A.H është realizuar në vijim, me 3 këste përgjatë viteve 2016 dhe 2017, e cila është pasqyruar në DPV-të e viteve 2016 dhe 2017, si dhe është dokumentuar nëpërmjet deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.12.2017, ku deklarohet shlyerja e plotë e detyrimit midis tyre. Subjekti ka depozituar kopje të kësaj deklaratë noteriale, si dhe mandatet bankare të lëshuara nga BKT-ja për shlyerjen e huas.

43.5 Nga të dhënat bankare të subjektit pranë BKT-së¹⁰⁷ provohet kthimi i shumave nga shtetasi A.H me përshkrimin “Derdhur shlyerje detyrimi”, respektivisht shumat 2.000 euro në datën 13.5.2016, shuma 2.000 euro në datën 19.6.2017 dhe shuma 3.000 euro në datën 23.11.2017.

43.6 Gjatë hetimit, Komisioni i ka kërkuar¹⁰⁸ subjektit të deklarojë marrëdhënien që ka me shtetasin A.H, për të cilin subjekti ka shpjeguar¹⁰⁹ se me këtë shtetas ka marrëdhënie të hershme shoqërore, të cilat kanë filluar rreth vitit 1998 dhe ka vijuar e njëjtë ndër vite.

Burimi i krijimit për huan e dhënë nga subjekti

43.7 Në deklaratën *Vetting* dhe deklaratimet periodike vjetore subjekti ka deklaruar se shuma e dhënë hua ka si burim kursimet familjare.

43.8 Komisioni i ka kërkuar¹¹⁰ subjektit të dokumentojë burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua, për të cilën subjekti ka shpjeguar¹¹¹ se të ardhurat e familjes së tij deri në datë 3.6.2015 kanë pasur si burim pagën e tij si ish oficer i policisë gjyqësore, si dhe pagën e bashkëshortes si infermiere pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pogradec.

Komisioni ka analizuar mundësitë financiare të subjektit për dhënien e huas

43.9 Referuar tabelës nr. 1 në analizën kumulative të kryer për periudhën 2007 – qershor 2015, duket se subjekti paraqitet me balancë negative, pra nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për krijimin e shumës 7.000 euro dhe përbalimit të shpenzimeve të tjera.

43.10 Konstatime të Komisionit

- Subjekti ka dokumentuar huan përmes aktit noterial datë 9.6.2015.
- Nga analiza kumulative e kryer mbi mundësitë e subjektit për dhënien e huas ka rezultuar balancë negative për periudhën e analizuar 2005 – 2015, çka tregon mungesë burimesh për dhënien e huas.
- Subjekti nuk ka provuar që huamarrësi të kishte mjaftueshëm të ardhura për të kthyer huan dhe përballuar shpenzimet e jetesës.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁰⁶ Shpjegimet e subjektit datë 19.6.2023.

¹⁰⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 11.8.2021.

¹⁰⁸ Përmes pyetësorit me *email* datë 12.6.2023.

¹⁰⁹ Shpjegimet e subjektit me *email* datë 19.6.2023.

¹¹⁰ Përmes pyetësorit me *email* datë 12.6.2023.

¹¹¹ Shpjegimet e subjektit datë 19.6.2023.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

43.11 Në lidhje me mundësinë e dhënies së huas në shumën 7.000 euro, subjekti ka shpjeguar se shtetasi A.H është njohje e tij e hershme shoqërore, e cila ka vijuar ndër vite. Bazuar në këtë marrëdhënie shoqërore me këtë shtetas, për nevojat e tij personale i ka dhënë shuma të ndryshme në vlerën totale prej 7.000 euro. Subjekti ka shpjeguar se dhënia hua në kohë reale nuk është dokumentuar me ndonjë akt shkresor, për shkak të marrëdhënies shoqërore.

43.12 Me marrjen e detyrës së prokurorit, për shkak të detyrimit që mbartte për të deklaruar pasurinë dhe interesat e tij para fillimit të detyrës, subjekti e ka dokumentuar dhënien e kësaj huaje përmes deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.6.2015. Subjekti ka shpjeguar se deri në datën 3.6.2015 të ardhurat e familjes se tij kanë pasur si burim pagën e tij dhe të bashkëshortes. Subjekti pretendon se të ardhurat e tyre nga paga dhe kursimet e realizuara nga këto të ardhura ishin më se të mjaftueshme për të kursyer vlerën 7.000 euro, të cilën ia ka dhënë më pas hua shtetasit A.H.

43.13 Subjekti vlerëson se konkluzioni i Komisionit nuk qëndron, pasi nga tërësia e të gjitha provave të administruar provohet se kursimet familjare të realizuara nga të ardhurat nga paga janë në vlerë pozitive për të siguruar kursimin e shumës 7.000 euro, dhënë hua shtetasit A. H. Subjekti ka sqaruar se edhe pse vlera prej 7.000 euro që i është dhënë hua shtetasit A.H i është dhënë këtij shtetasi përgjatë vitit 2014, kursimet e tyre familjare nuk janë siguruar vetëm përgjatë vitit 2014, por ato kanë qenë të shtrira në kohë, të cilat nuk mund t'i përcaktojnë ekzaktësisht.

43.14 Në lidhje me mundësinë e shlyerjes së huas në shumën 7.000 euro nga shtetasi A.H, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se referuar të dhënave të regjistruara pranë sistemit informatik të ISSH-së rezulton se përgjatë viteve 2012 – 2017, madje edhe në vijim, shtetasi A.H ka qenë i punësuar pranë subjekteve tregtare, duke përfituar pagën përkatëse, ku niveli i të ardhurave nga paga përgjatë viteve 2014 – 2016, periudhë kohore kjo që përkon me kohën e dhënies së huas, si dhe me kohën e kryerjes së veprimit bankar derdhje *cash* datë 13.6.2016, në vlerën 2.000 euro, ka qenë 586.939 lekë, shumë kjo e evidentuar edhe nga Komisioni. Bazuar në këto të dhëna, subjekti pretendon se shtetasi A.H ka poseduar burime të ligjshme për të kryer likuidimin në datën 13.6.2016 të shumës 2.000 euro, të marrë më parë hua.

43.15 Në lidhje me konsiderimin e shtetasit A.H si person i lidhur, në referim të parashikimeve në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive e kanë vetëm subjekti i rivlerësimit, personat e lidhur me të dhe personat e tjerë të lidhur të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit. Sipas subjektit, shtetasi A.H është në cilësinë e palës huamarrëse, pozitë e cila nuk e ngarkon atë me detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, pasi shuma përkatëse as nuk është e dhuruar dhe as nuk i është dhënë hua subjektit, i cili prapëson se ky konkluzion gjen pasqyrim edhe në praktikën e unifikuar të Kolegjit të Apelit, ku është qartësisht e dukshme se ngarkimi me barrë prove lidhur me mundësitë e huamarrësit për kthimin e shumës së marrë prej tij vjen në kundërshtim me praktikën tashmë të konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹¹².

Vlerësimi i Komisionit

¹¹² Në vendimin nr. 21, datë 10.9.2020 dhe vendimin nr. 20/2022 të Kolegjit.

43.16 Pas prapësimeve, Komisioni, referuar balancës negative për periudhën e analizuar 2005 – 2015 dhe në vlerësim të të gjitha provave dhe fakteve të rezultuara nga hetimi, ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për periudhën e analizuar.

Në lidhje me kthimin e huas, Komisioni e gjen të drejtë pretendimin e subjektit se shtetasi A. H. nuk duhet të konsiderohet person tjetër i lidhur në përputhje me parashikimin e pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

DEKLARIMI I PASURIVE NGA BASHKËSHORTJA G.H

44. Llogari page¹¹³ në Societe Generale Albania, me gjendje 39.240 lekë

✓ Nga verifikimi i kryer nuk evidentohen problematika.

45. Depozitë 12-mujore¹¹⁴ në Societe Generale Albania, çelur në datën 29.12.2016, me gjendje 2.500 euro në datën 31.12.2016

45.1 Si burim për krijimin e kësaj depozite bankare, bashkëshortja ka deklaruar të ardhurat nga paga.

✓ Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e krijimit të shumës së depozitës në vitin 2016 sipas tabelës së përgjithshme, nga ku duket se subjekti dhe familja e tij kanë pasur mundësi me burime të ligjshme për krijimin e depozitës dhe përballimin e shpenzimeve.

VERIFIKIME TË TJERA

46. Lidhur me automjetet në përdorim nga subjekti

46.1 Gjatë hetimit, në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se në disa raste, i kushtëzuar nga mospasja në gjendje pune të dy automjeteve¹¹⁵ në pronësi të tij, ka përdorur automjete që u përkasin shtetasve të tjerë, duke i marrë me qira dhe/apo në huapërdorim.

46.2 Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues dy kontrata huapërdorjeje si vijon:

- Kontratë huapërdorjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.7.2016, e lidhur midis subjektit Ilir Hoxha dhe shtetasit F.Q për marrjen në huapërdorje të automjetit të këtij shtetasi për një periudhë kohore 1 vit, duke filluar nga data 22.7.2016 deri më 21.7.2017. Sipas subjektit, qëllimi i marrjes së këtij automjeti ka qenë realizimi i udhëtimit familjar në Greqi, duke realizuar dy udhëtime të tilla vajtje - ardhje brenda ditës. Subjekti ka shpjeguar se efektet e kësaj kontrate janë ndërprerë në datën 14.8.2016, pasi automjeti në fjalë i është rikthyer pronarit të tij.
- Kontratë huapërdorjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.7.2017, e lidhur midis subjektit Ilir Hoxha dhe shtetasit E.D, për marrjen në huapërdorje të automjetit tip “D.C”, në pronësi të shtetasit E.D, me afat të pakufizuar.

¹¹³ Bashkëlidhur deklaratës: Konfirmim bankar nr. * prot., datë 4.1.2017, nga Societe Generale Albania për shtetasen G.H, e cila ka një llogari rrjedhëse dhe gjendja në datën 31.12.2016 është në shumën 39.240,97 lekë (njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 23.1.2017).

¹¹⁴ Bashkëlidhur deklaratës dokumentacioni i njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 23.1.2017: (1) konfirmim bankar nr. * prot., datë 4.1.2017, nga Societe Generale Albania për shtetasen G.H, e cila ka një depozitë 12-mujore, hapur në datën 29.12.2016 dhe gjendja në datën 31.12.2016 është në shumën 2.500 euro; (2) kontratë për çelje depozite me afat, nënshkruar në datën 29.12.2016 nga G.H pranë Societe Generale Albania. Shuma e depozituar 2.500 euro, me afat 12-mujor; (3) mandatet e depozitimit bankar të shumës 2.500 euro.

¹¹⁵ Mjetet me targa PG *** B dhe AA *** TR.

46.3 Komisioni hetoi mbi ndonjë konflikt të interesit të mundshëm të subjektit me pronarët e automjeteve të dhëna në përdorim, që i përkasin shtetasve F.Q dhe E.D, ku nga përgjigjja e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë¹¹⁶ nuk kanë rezultuar procedime penale në emër të këtyre shtetasve.

46.4 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* automjetin e marrë në përdorim me kontratën e huapërdorjes datë 22.7.2016.

✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

46.5 Subjekti, përmes prapësimeve të tij, ka shpjeguar se nëpërmjet kontratës së huapërdorjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.7.2016, ka marrë në përdorim të përkohshëm automjetin tip "M-B", në pronësi të shtetasit F.Q, me qëllim realizimin e udhëtimit familjar për në Republikën e Greqisë, duke realizuar dy udhëtime të tilla, vajtje - ardhje brenda ditës, nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar Qafë Botë, përkatësisht në datat 23.7.2016 dhe 13.8.2016.

46.6 Subjekti ka shpjeguar se pasi ky automjet është përdorur prej tij në datën 23.7.2016, ditën e nesërmen, në datën 23.7.2016, i është rikthyer të zotit, i cili e ka përdorur atë për qarkullim brenda territorit shqiptar. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në datën 13.8.2016 dhe, kështu, ditën e nesërme, pra në datën 14.8.2016 automjeti i është rikthyer të zotit, i cili e ka përdorur atë për qarkullim brenda territorit shqiptar.

46.7 Subjekti pranon faktin se marrja në huapërdorje e këtij automjeti nuk është deklaruar nga ana e tij në deklaratën *Vetting*, por kjo ka ndodhur vetëm për shkak të perceptimit të gabuar të kërkesave të formularit të deklaratës *Vetting*, ku nuk ka hasur asnjë rubrikë konkrete që të kërkonte deklarimin e huapërdorjes së mjeteve motorike të të tretëve dhe të gjendjes faktike në momentin e përpilimit të saj, pasur parasysh këtu faktin se përdorimi është një nga tagrat e pronarit sipas nenit 149 të Kodit Civil dhe, si e tillë, ajo nuk ekziston si një e drejtë më vete nga pronësia e transferueshme juridikisht të të tretët, cilësi që e gëzojnë të drejtat reale.

46.8 Subjekti ka argumentuar se në kushtet kur e drejta e përdorimit i kalon personave të tretë nga pronari nëpërmjet kontratës së qirasë ose huapërdorjes, por ndërkohë përdoruesi nuk ka një të drejtë reale mbi sendin, por është thjesht përdorues i saj sipas marrëveshjes kontraktore të palëve, si dhe duke pasur parasysh që kontratat e qirave ose të huapërdorjes nuk janë kontrata formale, pra ato mund të realizohen me shkrim ose në mënyrë verbale, sqaron se në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* nuk ka pasur të drejtë përdorimi për këtë mjet motorik, pasi automjeti i është kthyer shumë më herët pronarit të tij në të dyja rastet e përdorimit të tij dhe nuk është përdorur nga ana e tij. Pra, përdorimi i automjetit është kryer vetëm për dy ditë të veçanta dhe të shkëputura nga njëra - tjetra dhe vetëm për një qëllim, nëpërmjet një kontrate të veçantë të nënshkruar, ndaj dhe nuk ka pasur arsye të mosdeklarimit në deklaratën *Vetting*.

Vlerësimi i Komisionit

46.9 Komisioni, nisur nga fakti se subjekti përdorimin e këtij automjeti gjatë vitit 2016 e ka deklaruar vetë në pyetësonin standard si pasuri në përdorim, vlerëson se mosdeklarimi në deklaratën *Vetting* i automjetit në përdorim është një pasaktësi në plotësimin e deklaratës, e

¹¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 29.9.2022.

cila nuk ngre peshë, pasi nuk ka pasur për qëllim fshehjen, duke marrë në konsideratë aktin noterial të huapërdorjes.

Tabela e përgjithshme e analizës financiare për periudhën 2003 – 2016

<i>PERSHKRIMI</i>	2003	2004	2005-qershor 2015	korrik - dhjetor 2015	2016
PASURI	-	-	4 963 702	65 065	653 230
<i>Gjendje kumulative</i>					
Automjet blere ne 2007			220 000,00	-	
Garazh 108,72 m2 ne dt. 14.06.2013			2 700 000,00	-	
<i>Shtesa/Pakesime likuiditete</i>			2 043 702	65 065	653 230
Likuiditete Gjendje			2 043 702	2 108 767	2 761 998
Gjendje cash sipas DPV			900 000	1 000 000	1 000 000
DETYRIME	-	-			-
PASURI NETO = Pasuri - Detyrime	-	-	4 963 702	65 065	653 230
TE ARDHURA	663 099	811 268	11 202 690	743 305	1 929 055
Te ardhura nga paga e subjektit	563455	620605	7 384 873	527 624	1 224 711
Te ardhura nga paga e b/sh	99644	190663	3 117 818	215 681	433 804
Kredi RZB per mobilim			700 000		
Kthim borxhi nga A. H					270 540
SHPENZIME	281 892	281 892	9 514 561	502 552	1 236 358
Shpenzime jetese	281 892	281 892	6 227 224	448 552	940 368
Shpenzime udhetimi TIMS			630 688	29 000	46 000
Shpenzime mobilimi			654 504	25 000	23 990
Shpenzime shkollimi			114 000		226 000
Dhenie huaje shtesatit A. H			980 770		
Shpenzime kest dhe principal kredia			907 374		
REZULTATI	381 207	529 376	-3 275 572	175 687	39 467

Konkluzioni përfundimtar për vlerësimin e pasurisë

46.10 Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludoi se pasaktësitë e konstatuara në deklaratën *Vetting*, si dhe mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive që i përket periudhës para emërimit të subjektit në detyrën e prokurorit, janë rrethana që nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për të aplikuar dispozitat e parashikuara nga pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por do të mbahen në konsideratë nga Komisioni, në vlerësimin tërësor të procesit të rivlerësimit.

B. KONTROLLI I FIGURËS

- 47.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
- 48.** Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) për subjektin e rivlerësimit administrohen informacione *** të deklasifikuara pjesërisht, për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht atë të korrupsionit aktiv apo

pasiv, për shkak të funksionit gjatë ushtrimit të detyrës në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

49. Referuar informacioneve të deklasifikuara pjesërisht, të vëna në dispozicion nga AKSIK-ja, evidentohen rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston një kontakt i papërshtatshëm sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në formën e një takimi të qëllimshëm në papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.
50. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, AKSIK-ja ka dërguar një raport¹¹⁷, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar *papërshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës të z. Ilir G Hoxha*.
- ✓ Në lidhje me konstatimin nga AKSIK-ja për papërshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

51. Në prapësime subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se AKSIK-ja në raportin e saj të parë, materializuar në shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, ka konkluduar papërshtatshmërinë e tij në detyrë, duke i vënë në dispozicion një informacion të padeklasifikuar, i tillë që e vë në pozitë pamundësie objektive që të mbajë një qëndrim ligjor lidhur me konstatimet e kryera prej saj. Subjekti ka shpjeguar se ka kryer të gjitha përpjekjet e mundshme për të administruar informacionet dhe provat e mundshme, mbi bazën e të cilave të mund të paraqiste shpjegimet dhe kundërshtimet e tij.
52. Subjekti ka prapësuar se i është drejtuar AKSIK-së për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar, përmes kërkesës së datave 20.12.2023 dhe 26.12.2023, ku kjo e fundit, me shkresën nr. *** prot., datë 28.12.2023 (të cilën e ka depozituar pranë Komisionit), e ka informuar ndër të tjera se për rastin e tij ka ftuar të marrë pjesë në Komisionin e Deklasifikimit të Informacionit të Klasifikuar (KDZH) përfaqësuesin e institucionit, i cili është origjinator i informacionit të klasifikuar dhe Grupi i Punës për kontrollin e figurës përmban të dhëna dhe informacione të përfutuara nga autoritetet verifikuese, të cilat janë të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi dhe nuk mund t'i vihen në dispozicion. Për shkak të mosvënies në dispozicion të informacioneve të plota të përfutuara nga autoritetet verifikuese, si dhe/apo nga ana e Komisionit, subjekti deklaron se gjendet në pamundësi objektive për të provuar dhe/apo kundërshtuar të kundërtën e konkluzioneve të autoriteteve verifikuese.
53. Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka argumentuar se të dhënat që duhet të përdoren për të provuar kontaktet e papërshtatshme parashikohen shprehimisht në Kushtetutë, të cilat duhet të jenë prova konkrete, si dhe vendimet e gjykatave shqiptare dhe të huaja. Pra, vetë Kushtetuta e ka përcaktuar që konkluzionet e institucioneve të rivlerësimit duhet të bazohen në prova dhe vendime gjyqësore dhe jo në të dhëna të tjera që nuk përbëjnë provë. Më tej, subjekti ka prapësuar se vetë Kushtetuta përcakton se kontrolli i figurës bazohet tek deklarata, e cila përmban pohimet e vetë subjektit dhe në provat e tjera që mund të përdoren, siç mund të jenë përgjimet e komunikimeve telefonike të autorizuara nga gjykata dhe vendimet e gjykatave shqiptare apo të huaja, mbi bazën e të cilave provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme. Sipas subjektit, bazuar në këtë linjë logjike, duhet të provohet paraprakisht me prova të plota se ekziston një takim i qëllimshëm, një përgjim telefonik, një përmbajtje konkrete që lidh marrëdhënien e tij me

¹¹⁷ Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. *** , datë 10.10.2022, të KDZH-së.

këtë kontakt, si dhe një vendim i formës së prerë të kohës kur pretendohet ky kontakt, që e ka deklaruar fajtor personin e përfshirë në krimin e organizuar, për një nga veprat që parashikohet nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale apo një vendim pushimi që provon faktin se një person është përfshirë në krimin e organizuar, por që nuk mund të dënohet për shkak të vdekjes së tij, papërgjegjshmërisë dhe moshës.

Hetimi i Komisionit mbi kontrollin e figurës

54. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, nisur nga raporti i dërguar nga AKSIK-ja ka aksesuar informacionin pranë institucionit verifikues, si dhe ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo të dhënë dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur lidhur me dyshimet për kontakte të papërshtatshme dhe përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv.

Vlerësimi i Komisionit për kontrollin e figurës

- ✓ Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit ka rezultuar se subjekti ka plotësuar me vërtetësi dhe korrektësi këtë formular në përputhje me dispozitat urdhëruese të ligjit.
 - ✓ Nga hetimi i kryer nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.
55. Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni ka rritur në konkluzionin se nuk u provua konstatimi në raportin e AKSIK-së për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim, në vlerësim të provave të administruara, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka cenuar parashikimet e dispozitave të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës apo të pikave 2 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

56. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit¹¹⁸ të hartuar nga KLP-ja për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

57. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme, etj.

58. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit konstatohet:

58.1 Formulari i vetëdeklarimit rezultoi i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹¹⁸ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale me nr. *** prot., datë 7.9.2018.

- ✓ Nga analizimi i dokumenteve ligjore, si dhe vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

ANALIZA E GJETJEVE¹¹⁹

- 59.** Analiza e gjetjeve në këtë raport bazohet në tri burime informacioni: (i) formulari i vetëvlerësimit dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjet e përzgjedhura me short; (iii) dokumentacioni arkivor pranë sektorit të protokoll-arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore të Republikës së Shqipërisë.

60. Aftësitë profesionale

60.1 Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi në kuptimin dhe interpretimin e legjislacionit. Subjekti ka aftësi në arsyetimin ligjor, duke shfaqur njohuri të mira në drejtim të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej tij janë të arsyetuara.

61. Aftësitë organizative

61.1 Prokurori Ilir Hoxha, në periudhën e rivlerësimit 2015 – 2016, ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara pa dëmtuar cilësinë e vendimmarrjes. Nga dosjet e vëzhguara subjekti ka administruar në mënyrë të shpejtë dhe efikase ngarkesën e punës.

62. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

62.1 Nga dosjet e vëzhguara evidentohet se gjuha e përdorur nga subjekti është në përputhje me rregullat e etikës profesionale të prokurorit, nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për cenim të integritetit të tij. Gjithashtu, për periudhën e rivlerësimit, nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërie.

63. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

63.1 Nga dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

TË DHËNAT NGA BURIME ARKIVORE

- 64.** Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit Ilir Hoxha të ketë pasur masa disiplinore.
- 65.** Nga informacioni i ardhur nga prokuroritë e rretheve gjyqësore ka rezultuar materiali kallëzues nr. **, datë 25.1.2016, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, bazuar në kallëzimin e shtetasit H.M ndaj prokurorit Ilir Hoxha, akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Për këtë çështje, në datën 26.2.2016 është vendosur mosfillimi i procedimit penal, vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga gjykatat më të larta.
- 66.** Komisioni ka kërkuar informacion në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila ka informuar¹²⁰ mbi një procedim penal nr. ***, të regjistruar në datën 11.6.2018 pranë ish-Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ndaj prokurorit Ilir Hoxha, për veprat penale të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç

¹¹⁹ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

¹²⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2023.

të Kodit Penal. Pas shpalljes së moskompetencës, në datën 18.12.2019 aktet i janë dërguar Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e cila ka regjistruar procedimin nr. **, datë 20.12.2019, procedim i cili është ende në fazën e hetimit dhe çështja është pa autor të regjistruar.

67. Lidhur me ankesa apo shkelje disiplinore ndaj prokurorit Ilir Hoxha, nga informacioni i ardhur nga ILD-ja¹²¹ kanë rezultuar 15 ankesa të regjistruara gjatë periudhës 2019 – 2023 (disa prej tyre të përsëritura), ku 5 prej tyre janë depozituar edhe pranë Komisionit (të trajtuara tek denoncimet) dhe për 2 ankesa subjektit iu kërkuan shpjegime, konkretisht:

67.1 *Ankesa e shtetas A.L.*, e viteve 2021 dhe 2022 (4 ankime të përsëritura), e cila pretendon se ish-bashkëshorti i vajzës së saj ka ushtruar dhunë/abuzim fizik ndaj saj në dyqanin ku ajo punon. Ajo ka kryer kallëzim penal, për të cilën është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 4.2.2021, për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”¹²².

Ankuesja pretendon se prokurori Ilir Hoxha nuk ka kryer veprime hetimore, pasi nuk e ka marrë në pyetje si viktimë, si dhe nuk ka pranuar aktin e ekspertimit mjekoligjor, ku provohej se ankuesja ka mbetur e dëmtuar për shkak të dhunës së ushtruar nga ish-bashkëshorti i vajzës së saj. Sipas ankueses, eksperti mjekoligjor i caktuar nga organi i akuzës ka qenë në konflikt interesi me të pandehurin. Ajo ka bërë ankim kundër vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin datë 12.5.2021, e ka kthyer çështjen në Prokurori për hetime shtesë.

- ✓ Në lidhje me pretendimet e ankueses, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me hapat proceduralë të ndërmarrë prej tij për hetimin e çështjes, të mbështetur në dokumentacionin provues, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

67.1.1 Subjekti përmes prapësimeve ka shpjeguar se kjo çështje penale aktualisht gjendet në fazën e hetimit paraprak dhe për këtë shkak nuk mund të paraqesë dokumentacion provues. Gjithashtu, në prapësimet e tij subjekti ka pretenduar se kjo çështje penale, por edhe disa prej çështjeve penale¹²³ të hetuara nga Komisioni, për të cilat i është ngarkuar barra e provës, i përkasin një periudhe kohore pas datës 8.10.2016 dhe nuk i përkasin periudhës së rivlerësimit kalimtar dhe/apo që janë çështje në shqyrtim. Subjekti pretendon se gjetjet dhe konstatimet e Komisionit për një procedim penal ende në shqyrtim janë në kundërshtim të plotë me parashikimet kushtetuese, e konkretisht nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, duke pasur parasysh që këto çështje penale janë ende në fazën e hetimit paraprak apo dhe fazë shqyrtimi pranë gjykatës dhe sipas subjektit në mënyrë kategorike nuk mund t'i nënshtrohen hetimit administrativ në këtë proces rivlerësimi.

¹²¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.7.2023.

¹²² Parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

¹²³ (1) Procedimi penal nr. ** i vitit 2021 (A.L – ankuese); (2) procedimi penal nr. *** i vitit 2019 (F.H – ankuese); (3) procedimi penal nr. *** i vitit 2017; (4) procedimi penal nr. *** i vitit 2015 (Xh.I – denoncues); (5) procedimi penal nr. ** i vitit 2017 (V.Q – denoncues); (6) kallëzimi penal nr. ***, datë 20.11.2018 (S.D – denoncues); (7) procedimi penal nr. *** i vitit 2018 (V.P – denoncues); (8) procedimi penal nr. *** i vitit 2018 (V.P – denoncues); (9) procedimi penal nr. *** i vitit 2017 (A.B – denoncues); (10) procedimi penal nr. *** i vitit 2020 (M.A – denoncues); (11) materiali kallëzues nr. ***, datë 4.8.2021 (A.M – denoncues); (12) procedimi penal nr. *** i vitit 2021 (A.K – denoncues); (13) procedimi penal nr. *** i vitit 2017 (A.H – denoncues); (14) materiali kallëzues nr. ***, datë 17.5.2017 (D.B – denoncuese); (15) materialit kallëzues nr. ***, datë 4.2.2022 (D.B – denoncuese); (16) procedimi penal nr. *** i vitit 2020 (J.D – denoncues); (17) procedimi penal nr. *** i vitit 2019 (“R” sh.p.k. – denoncues); (18) procedimi penal nr. * i vitit 2023 (G.A – denoncues); (19) procedimi penal nr. *** i vitit 2020 (K.R – denoncues); (20) materiali kallëzues nr. ***, datë 13.6.2022 (K.R – denoncues).

67.1.2 Lidhur me ankimin e shtetasës A.L, subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar faktet dhe rrethanat e çështjes për kundërvajtjen penale “Plagosje e lehtë me dashje”, vepër e cila nuk i është atribuar ndonjë shtetasi konkret.

Sa i përket aktit të ekspertimit mjekoligjor, subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se vendimi për caktimin e ekspertit A.T i është komunikuar të dëmtuarës A.L, e cila, edhe pse është pajisur me kopjen e aktit procedural, nuk është paraqitur para ekspertit, rrethanë kjo e konfirmuar edhe nga eksperti me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2021.

67.1.3 Sipas subjektit, ndërsa materiali kallëzues gjendej në fazën e verifikimit paraprak, ende pa u regjistruar procedimi penal, Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë nëpërmjet shkresës nr. ** prot., datë 2.2.2021, ka vendosur në dispozicion të organit procedues aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. **, datë 31.1.2021, të kryer nga eksperti mjekoligjor E.S.

Sipas subjektit, nga korrespondenca e kryer me Komisarjatin e Policisë Sarandë, por edhe me Institutin e Mjekësisë Ligjore, nuk rezultoi që ky ekspert të ishte caktuar nga organi procedues për kryerjen e këtij ekspertimi, duke qenë në kundërshtim jo vetëm me parashikimet në Kodin e Procedurës Penale, por edhe me nenet 4, 24 dhe 29 të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, ku, ndër të tjera, në nenin 4/1 parashikohet se: *“Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) kryen veprime ekspertimi me kërkesë të prokurorisë, të policisë gjyqësore”*.

67.1.4 Subjekti ka argumentuar se nëse e dëmtuara A.L do të konstatonte ekzistencën e njërit prej kriterëve përjashtues të ekspertit mjekoligjor A.T, në referim të nenit 181 të Kodit të Procedurës Penale, kishte të drejtën të kërkonte përjashtimin e ekspertit, duke ia bërë me dije këto rrethana organit procedues, në këtë rast oficerit të policisë gjyqësore dhe/ose prokurorit, i cili, si i vetmi organ kompetent, vendos për zëvendësimin e ekspertit.

67.1.5 Për sa më sipër, bazuar në nenin 130, paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Penale, në datën 8.3.2021 subjekti ka vendosur të shpallë të pavlefshëm aktin e ekspertimit mjekoligjor të kryer nga eksperti i Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë dhe paralelisht ka urdhëruar regjistrimin e një procedimi penal të veçantë në datën 31.3.2021 ndaj ekspertit E.S, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

67.1.6 Më tej, subjekti ka shpjeguar se në kushtet kur kishte kaluar një kohë e gjatë nga data kur ankuesja kishte pësuar dëmtime fizike, duke humbur gjurmët e dëmtimeve, në datën 9.3.2021 i ka kërkuar ekspertit mjekoligjor A.T që të kryejë ekspertimin bazuar në materialet e çështjes, të cilat i janë vënë në dispozicion. Në përmbushje të detyrës së ngarkuar, eksperti, përmes aktit të datës 12.3.2021, ka konkluduar ndër të tjera se dëmtimet e konstatuara tek shtetasja A.L hyjnë në kategorinë e rrahjeve, për rrjedhojë subjekti ka vlerësuar se fakti penal përmban elementet e figurës së kundërvajtjes penale “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal.

Subjekti ka argumentuar se, në referim të nenit 59, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale, e dëmtuara A.L duhej t’i drejtohet gjykatës për vërtetimin e akuzës për kundërvajtjen penale “Dëmtime të tjera me dashje” dhe ka vlerësuar se ndjekja penale jo vetëm që nuk duhej të fillohej, por nuk duhet të vijonte më tej, për rrjedhojë, me vendimin e datës 31.3.2021, bazuar në nenin 328/1/d të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur të pushojë çështjen.

67.1.7 Ndaj këtij vendimi, kallëzuesja A.L ka ushtruar ankim në gjykatë, duke kërkuar ndryshimin e kualifikimit të veprës penale, regjistrimin e procedimit për veprën penale “Dhuna në familje”, si dhe ka kundërshtuar pavlefshmërinë e shpallur nga prokurori të aktit

të ekspertimit mjekoligjor nr. **, datë 31.1.2021, të kryer nga eksperti i Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, si dhe pavlefshmërinë e aktit të ekspertimit të datës 12.3.2021, të kryer nga eksperti mjekoligjor A.T, duke pretenduar se ky i fundit është në varësi të të kallëzuarit E. Dh, i cili në atë kohë ishte në detyrën e drejtorit të Spitalit Sarandë, rrethana të cilat përbëjnë konflikt interesi.

67.1.8 Subjekti ka shpjeguar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin e datës 12.5.2021, ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër në datën 25.11.2021. Sipas subjektit, gjykata e rrethit ka gabuar në perceptimin e objektit të çështjes dhe nuk është dakord me arsyetimin e kryer prej saj. Subjekti ka shpjeguar se pas vendimit të Gjykatës së Apelit, ankuesja në datën 16.3.2022 ka kryer kallëzim penal ndaj subjektit, i cili është përcjellë për kompetencë lëndore trajtimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, për të cilën nuk ka dijeni për ecurinë e këtij materiali kallëzues. Për të shmangur çdo situatë konflikti në këtë moment procedural, ka vlerësuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes në datën 24.3.2022. Në kushtet kur kjo çështje vijon të jetë ende në fazën e hetimit paraprak, e ka objektivisht të pamundur të paraqesë dokumentacion argumentues. Subjekti, me prapësimet e datës 10.1.2024, ka paraqitur *email*-in datë 5.1.2024, të dërguar nga zëvendës drejtuesja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, e cila konfirmon se ky procedim penal është në hetim.

Vlerësimi i Komisionit

67.1.9 Komisioni, në analizë të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerëson se subjekti ka shpjeguar arsyen e mospranimit të aktit të ekspertimit të kryer nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, duke e konsideruar të drejtë shpjegimin tij, të mbështetur në përcaktimet e nenit 182 të Kodit të Procedurës Penale.

67.1.10 Lidhur me pretendimet e ankueses për moskryerje të veprimeve hetimore, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara mbi veprimet hetimore, por nuk ka depozituar dokumentacion provues, me argumentin se kjo çështje ndodhet ende nën hetim. Fakti që kjo çështje aktualisht është nën hetim nga një prokuror tjetër, nuk e bën atë një çështje në shqyrtim sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë është ezauruar roli dhe puna e subjektit të rivlerësimit dhe gjykatat janë shprehur lidhur me vendimmarrjen e subjektit dhe veprimet hetimore të ndërmarra prej tij.

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegonte bindshëm të kundërtën e barrës së provës në lidhje me këtë procedim penal, duke shfaqur mangësi profesionale në hetimin e kësaj çështje sipas kërkesës në pikën 2, të nenit 73 të ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

67.1.11 Lidhur me këtë çështje penale, por edhe gjithë çështjet e tjera të analizuara nga Komisioni, për të cilat subjekti pretendon se janë ende nën hetim apo shqyrtim gjyqësor, trupi gjykues vlerëson të shprehet një herë e mirë mbi faktin se parashikimi i pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve që janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

67.1.12 Komisioni, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit¹²⁴ gjen me vend të shprehet edhe për pretendimin e subjektit se çështjet e tjera penale, për të cilat i është ngarkuar barrë prove, nuk duhet të ishin hetuar, pasi nuk i përkasin periudhës së rivlerësimit. Komisioni vlerëson se pavarësisht se këto çështje penale i përkasin periudhës pas vitit 2016, referuar dispozitave kushtetuese dhe ligjore, periudha 3-vjeçare e parashikuar në nenin 41 të ligjit nr. 84/2016 lidhet me vlerësimin e aftësive profesionale sa u përket dosjeve të shortuara për këtë qëllim apo të përzgjedhura nga vetë subjekti, por vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet edhe përtej kësaj periudhe, siç është parashikuar në pikën 4 të këtij neni, nga viti 2006 e në vazhdim, pa u kufizuar në kohë. Për pasojë, Komisioni nuk është në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar nga kjo dispozitë dhe është e legjitimuar të analizojë e vlerësojë këtë çështje, si dhe çështjet e tjera, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

67.2 Ankesa e shtetas F.H, viti 2020, e cila pretendon se ka kaluar një vit e gjysmë nga momenti që ka kryer kallëzim penal ndaj shtetasit F.M, për veprën penale të falsifikimit dhe prokurori Ilir Hoxha nuk ka kryer asnjë hetim. Sipas ankueses, i kallëzuarit F.M përmes falsifikimit i ka hequr dhe fshirë nga hipoteka truallin prej 500 m² në bashkëpronësi me të. Lidhur me këtë çështje, subjekti në datën 8.11.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili është shfuqizuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe ajo e Apelit Gjirokastër, të cilat kanë urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe vazhdimin e hetimeve. Pas regjistrimit të procedimit, mbi bazën e vendimit të gjykatës, subjekti, me kërkesën e datës 28.1.2020, ka kërkuar pushimin e çështjes, me argumentin se është parashkruar ndjekja penale, pasi falsifikimi i pretenduar është kryer deri në vitin 2004, kërkesë e pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin datë 11.3.2021.

- ✓ Në lidhje me pretendimet e ankueses, subjektit iu kërkuan shpjegime mbi arsyen e mosfillimit të procedimit penal dhe kthimin e çështjes nga gjykata, si dhe çfarë hapash proceduralë janë ndërmarrë prej tij pas regjistrimit të procedimit në shtator të vitit 2019 deri në janar të vitit 2020, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

67.2.1 Subjekti ka shpjeguar se kjo çështje aktualisht gjendet në fazën e hetimit paraprak dhe, për këtë shkak, nuk mund të paraqesë dokumentacion provues.

67.2.2 Lidhur me arsyet e vendosjes se mosfillimit të procedimit penal, subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se nga studimi në tërësi i materialit kallëzues nr. ***, datë 16.10.2018, ku kishte pretendime për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe nisur nga parashtrimet e ankueses se dokumentacioni i supozuar i falsifikuar ishte depozituar në proceset gjyqësore civile deri në datën e vendimmarrjes nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pra deri në datën 5.3.2004, subjekti, duke marrë për bazë masën e dënimit të parashikuar nga kjo vepër penale, ku parashikohet “*Burgim deri në tre vjet*”, ka vlerësuar se në referim të nenit 66, pika 1, shkronja “ç” e Kodit Penal¹²⁵, ndjekja penale nuk mund të ushtrohet pasi ishte e parashkruar, sepse nga koha e kryerjes së veprës penale dhe deri në atë moment kishin kaluar mbi 5 vjet.

¹²⁴ Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 16/2021, paragrafi 9.

¹²⁵ Neni 66, pika 1, shkronja “ç” parashikon se: “*Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar ... ç) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë*”.

Ndaj, me vendimin e datës 8.11.2018, ka vendosur mosfillimin e procedimit për këtë material kallëzues.

67.2.3 Subjekti ka shpjeguar se ndaj vendimit të tij kallëzuesja ka ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila me vendimin datë 17.1.2019 ka shfuqizuar vendimin e tij, pasi arsyetimi për parashkrimin e ushtrimit të ndjekjes penale nuk është i bazuar dhe, rrjedhimisht, ai duhet të regjistrojë procedimin dhe të kryejë veprimet hetimore për të verifikuar me siguri të plotë kohën përfundimtare të përdorimit të dokumenteve apo kryerjes se veprimeve që pretendohet se janë të paligjshme. Subjekti ka shpjeguar se ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës, por prokurori i Prokurorisë së Apelit Gjirokastër, për shkaqe tërësisht të panjohura, është tërhequr nga ky ankim dhe, në këto kushte, Gjykata e Apelit Gjirokastër në datën 19.3.2019 ka vendosur mospranimin e ankimit.

67.2.4 Subjekti ka shpjeguar se pas administrimit të vendimeve gjyqësore, në datën 13.9.2019 ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2019, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, si dhe ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, duke administruar në datën 8.10.2019 dokumentacionin e pasurisë nga ASHK Drejtoria Vendore Sarandë, nga e cila ka evidentuar se kjo pasuri është regjistruar në datën 31.12.2001, çka provon se dokumentacioni që ka shërbyer për regjistrimin fillestar të pronës është përdorur në datën 31.12.2001. Për rrjedhojë, subjekti ka vlerësuar se në këtë rast vepronte instituti i parashkrimit të ndjekjes penale dhe, për këtë shkak, në datën 28.1.2020 i është drejtuar gjykatës me kërkesën për pushimin e çështjes penale, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin datë 11.3.2021, me të njëjtin arsyetim.

Vlerësimi i Komisionit

67.2.5 Komisioni vlerëson se subjekti në prapësimet e tij, ndonëse ka analizuar dhe arsyetuar shkaqet për të cilat ka vendosur mosfillimin e procedimit penal bazuar në normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, vëren se subjekti nuk ka shpjeguar dhe as dokumentuar veprimet konkrete hetimore të kryera prej tij, pas regjistrimit të procedimit penal (pas shtatorit të vitit 2019), përveçse administrimit të praktikës së pasurisë nga ASHK-ja Sarandë në datën 8.10.2019. Nisur nga shpjegimet e subjektit, Komisioni evidenton se nga muaji tetor 2019, kur është administruar praktika nga ASHK-ja, deri në janar 2020, kur është kërkuar pushimi i çështjes penale, subjektit i është dashur më shumë se 3 muaj për të konkluduar se vepra penale është parashkruar.

67.2.6 Në prapësimet subjekti ka pohuar se kjo çështje penale është ende nën hetim, çka nënkupton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë i datës 11.3.2021 e cila ka pranuar kërkesën e subjektit, është apeluar dhe çështja ka qënë sërish nën hetim nga subjekti, të paktën deri në shtator 2023, periudhë kur subjekti është transferuar me detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

67.2.7 Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegonte bindshëm të kundërtën e barrës së provës në lidhje me këtë procedim penal, duke shkaktuar zvarritje të pajustificuar në hetimin e kësaj çështje penale të cilat përbëjnë mangësi profesionale referuar parashikimeve të pikës 2, të nenit 73, të ligjit 96/2016, i ndryshuar.

Gjetje të tjera lidhur me kriterin profesional

68. Në lidhje me informacionet e marra nga autoritetet verifikuese, Komisioni vlerësoi të administrojë 6 dosje penale, si dhe disa akte procedurale të subjektit Ilir Hoxha nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë¹²⁶, ku për 5 çështje penale subjektit iu kërkuan shpjegime, si vijon:

69. **Çështja penale nr. ***, viti 2015**, në ngarkim të të pandehurve L.H, Y.R dhe A.Z, akuzuar për veprën penale “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, lidhur me një ngjarje të ndodhur në datën 10.7.2015 në qytetin e Sarandës, ku ka mbetur i vrarë me armë zjarri brenda automjetit të tij shtetasi E.Th.

Për këtë çështje janë proceduar 6 shtetas, konkretisht shtetasit G.H, E.H, K.H, L.H, A.Z dhe Y.R, të dyshuar për veprat penale “Vrasje me paramendim” kryer në bashkëpunim dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 78/2 e 25 dhe 278/5 të Kodit Penal. Në vijim, subjekti në datën 17.12.2015 ka disponuar me vendim për ndarjen e procedimit penal, duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale për 3 prej të pandehurve L.H, Y.R dhe A.Z.

Konstatime të Komisionit

69.1 Nga analizimi i dosjes, nisur nga rrethanat e ngjarjes, subjekti, duke vendosur ndarjen e procedimit penal për tre prej të pandehurit dhe ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “Vrasje me paramendim” kryer në bashkëpunim, në veprën penale “Moskallëzimi i krimi”, duket se ka lehtësuar pozitën e të pandehurve.

- ✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

69.2 Subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e çështjes dhe dinamikën e ngjarjes, ku ndër të tjera ka shpjeguar arsyen e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale për 3 të pandehurit L.H, Y.R dhe A.Z. Sipas subjektit, pas kryerjes së të gjitha veprimeve të mundshme hetimore dhe nga analizimi në mënyrë të hollësishme i të gjitha provave të administruara, ka krijuar bindjen se vepra penale “Vrasje me paramendim” është kryer nga shtetasit E.H, G.H dhe K.H, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, dhe në mungesë të bashkëpunimit me shtetasit e tjerë L.H, Y.R dhe A.Z, pavarësisht prezencës fizike të këtyre të fundit në ngjarje.

Sipas subjektit, në pamje të parë veprimet e kryera nga këta shtetasi nën hetim L.H, Y.R dhe A.Z kane qenë të njëjta me veprimin e kryer në vendngjarje nga shtetasi K.H. Por, ajo që krijon diferencën midis tyre është dijenia e këtyre tre shtetasve mbi qëllimin final, që synonin të realizonin tre të tjerët.

69.3 Nisur nga rrethanat dhe provat e administruara, subjekti ka krijuar bindjen se shtetasit L.H, Y.R dhe A.Z, në asnjë çast para ndodhjes së ngjarjes nuk kanë qenë në dijeni të mendimit kriminal që ishte krijuar tek shtetasit e tjerë. Sipas subjektit, e gjithë dijenia e tyre përmbledhet në atë që ata do të kontaktonin me agresorët e një nate më parë “për t’i futur një grusht”, kjo një ndjenjë hakmarrjeje e kufizuar, kufiri i së cilës shtrihej deri tek ushtrimi i një dhune të thjeshtë fizike ndaj agresorëve të një nate më parë. Subjekti ka prapësuar se nga asnjë provë e grumbulluar nuk provohet ekzistenca e dijenisë së këtyre tre shtetasve për qëllimin e E.H, K.H dhe G.H, për vrasjen e shtetasit që do të hipte në automjetin tip

¹²⁶ Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2023.

“Peugeot”. Subjekti ka prapësuar se arritja e qëllimit final, pra vrasja e shtetasit E.Th, nuk provohet se është paramenduar apo dëshiruar nga këta tre të pandehur, për këtë arsye ka vlerësuar të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale.

69.4 Sa i përket elementit objektiv të bashkëpunimit, të parashikuar nga neni 25 i Kodit Penal, subjekti ka shpjeguar se shtetasit nën hetim L.H, Y.R dhe A.Z me veprimet e tyre nuk kanë ndikuar drejtpërdrejt në ardhjen e pasojës kriminale. Sipas subjektit, vetëm prezenca e tyre në ngjarjen e ndodhur nuk provon faktin se ka ekzistuar marrëveshje e mëparshme për realizimin e qëllimit final kriminal. Në vijim, subjekti ka sqaruar se në datën 22.12.2015 i është drejtuar gjykatës për gjykimin e të pandehurve për këtë veprë penale, e cila me vendimin datë 16.3.2023 ka deklaruar çdonjërin prej tyre fajtor, duke i dënua përfundimisht me nga 13 muaj burgim. Kundër këtij vendimi çdonjëri prej të pandehurve ka parashtruar ankim pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, e cila ka vendosur mospranimin e ankimit, dhe kështu vendimi ka marrë formë të prerë.

69.5 Sa i përket vendimit për ndarjen e procedimit penal, subjekti ka shpjeguar se ndaj secilit prej të pandehurve ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin datë 17.7.2015, ku për shtetasit G.H, E.H dhe K.H këto masa janë vendosur në mungesë të tyre.

Sipas subjektit, nisur nga fakti se ekzekutimi i masës ndaj të pandehurit G.H nuk ishte e mundur të kryhej, pasi ishte larguar jashtë vendit dhe autoritetet italiane e kanë kapur, futur në paraburgim dhe më pas ekstraduar për në Shqipëri, dhe në kushtet kur hetimi për akuzën në ngarkim të të pandehurve L.H, Y.R dhe A.Z, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit” ishte i plotë, ndërsa hetimet për shtetasit e tjerë të akuzuar për “Vrasje me paramendim” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” nuk ishin të plota, subjekti, bazuar në nenin 93/1/ç të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur që çështjet respektive duhet të ndahen nga njëra-tjetra.

69.6 Subjekti ka shpjeguar se në datën 1.12.2016 ka hequr dorë nga hetimi i mëtejshëm i kësaj çështjeje, pasi nga ana e babait të viktimës H.M, në mënyrë konstante, janë paraqitur kundërshtime ndaj tij si prokuror i çështjes. Subjekti ka shpjeguar se ky shtetas ka kryer kallëzim penal ndaj tij për shpërdorim detyre, për të cilin organi i Prokurorisë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Gjithashtu, babai i viktimës ka paraqitur edhe kërkesë për heqjen dorë të subjektit nga çështja, si dhe kërkesë për zëvendësimin e tij, të cilat nuk janë pranuar nga Drejtuesi i Prokurorisë apo Prokurori i Përgjithshëm.

69.7 Subjekti ka prapësuar se në çdo përgjigje që shtetasi H.M kishte marrë nga këto institucione, vërtetohet qartazi se e gjithë veprimtaria e tij si prokuror ishte kryer në përputhje të plotë me bindjen e krijuar nga tërësia e provave të administruara gjatë fazës së hetimit, me dispozitat procedurale, si dhe me dispozitat ligjore që normojnë veprimtarinë e prokurorit. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues:

- kallëzimin penal datë 18.1.2016, të shtetasit H.M;
- vendimin datë 26.2.2016, të prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, i cili ka vendosur mosfillimin e procedimit penal;
- vendimin nr. ***, datë 14.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, e cila ka rrezuar ankimin e shtetasit H.M. Në dispozitivin e këtij vendimi citohet se Gjykata e Apelit Gjirokastër ka lënë në fuqi këtë vendim.

Vlerësimi i Komisionit

69.8 Trupi gjykues, në analizë të prapësimeve të subjektit dhe dosjes penale të administruar, vlerëson se referuar Kodit të Procedurës Penale cilësimi juridik i akuzës është në diskrecionin e prokurorit, i cili mund të kundërshtohet në rrugë hierarkike në gjykatë. Nisur nga përcaktimet e nenit 375/1 të Kodit të Procedurës Penale, cilësimi juridik i bërë nga prokurori mund të ndryshohet nga gjykata, e cila përmes vendimit përfundimtar mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj. Rezultoni se për çështjen konkrete gjykata e rrethit gjyqësor ka vendosur të dënojë tre të pandehurit sipas kualifikimit të veprës penale të propozuar nga prokurori, "Moskallëzimi i krimit".

69.9 Po ashtu, lidhur me vendimin e prokurorit për ndarjen e procedimit penal, trupi gjykues çmon se ky vendim është i lidhur drejtpërdrejt me bindjen e brendshme dhe logjikën e subjektit të rivlerësimit, i cili, bazuar në vlerësimin e provave dhe ecurinë e hetimit, ka vendosur kur është momenti i duhur procedural për të kryer ndarjen e çështjes dhe vijimin e hetimeve. Pra, në këtë aspekt të aftësive të magjistratit, Komisioni çmon se nuk mund të vlerësohet si matës i aftësive profesionale të subjektit, në kuadër të këtij procesi. Arsyetimi i mësipërm gjen mbështetje në nenin 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, e cila ndalon vlerësuesin të çmojë aftësitë duke gjykuar korrektësinë dhe themelin e çështjes e duke zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet. Për rrjedhojë, Komisioni çmon se kualifikimi ligjor i faktit, për të cilin është regjistruar procedimi penal, si dhe ndarja e procedimit penal, kryhet bazuar në analizën e provave dhe vlerën provuese të tyre, të cilat përbëjnë vlerësim mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes.

69.10 Përfundimisht, duke i vlerësuar bindëse shpjegimet e subjektit, në vlerësimin final të kësaj çështjeje, trupit gjykues nuk i rezultuan *indicie* apo rrethana për fakte konkrete, të cilat të krijojnë bindjen se subjekti ka kryer shkelje ligjore në veprimtarinë e tij, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

70. Çështja penale nr. *, viti 2015**, në ngarkim të shtetasit S.P, akuzuar për veprën penale "Vrasje nga pakujdesia" dhe shtetasit A.P, akuzuar për veprën penale "Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit", lidhur me një ngjarje të ndodhur në datën 7.11.2015, ku shtetasi P. Ll ka gjetur vdekjen e menjëhershme si pasojë e veprimit të rrymës elektrike, duke punuar në një shtyllë elektrike, pronë e shoqërisë "P" (më herët emërtuar "P"), me administrator A. P.

Nga analizimi i dosjes penale ka rezultuar se administratori i shoqërisë, z. A.P, është proceduar fillimisht për veprën penale "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë" dhe më pas këtij procedimi i është bashkuar edhe procedimi penal nr. ***, viti 2016, për veprat penale "Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive" dhe "Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit".

Konstatimi i Komisionit

70.1 Nga analizimi i dosjes penale, duke se subjekti përmes pushimit të dy prej akuzave, "Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë" dhe "Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive", duket se ka lehtësuar pozitën e të pandehurit A.P.

✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

70.2 Subjekti përmes prapësimeve të tij ka shpjeguar dinamikën dhe rrethanat e ngjarjes, si dhe akuzën e ngritur ndaj shtetasit nën hetim A.P, në kuadër të procedimit penal nr. **** të vitit 2015. Sipas subjektit, nga analiza e fakteve dhe provave të grumbulluara, fillimisht kanë rezultuar dyshime se shtetasi A.P, administrator i shoqërisë “P” sh.p.k., ka kryer veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal. Bazuar në kërkesën e organit të akuzës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin datë 10.11.2015, ka vendosur ndaj këtij shtetasi caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”. Teksa shtetasi A.P gjendej nën këtë masë sigurimi, në datën 26.3.2016 ai është gjetur në guroren në pronësi të shoqërisë së tij, për realizimin e një shpërthimi me lëndë plasëse. Duke qenë se ai ishte larguar nga banesa, ndërkohë ishte me masë sigurimi, ndaj tij janë ngritur edhe akuzat e veprave penale “Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive”, parashikuar nga neni 282/1 i Kodit Penal, si dhe “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, parashikuar nga neni 323/1 i Kodit Penal.

70.3 Lidhur me pushimin e akuzave ndaj shtetasit A.P, subjekti ka shpjeguar se pasi ka analizuar të gjitha provat e administruara, si dhe nga interpretimi i dispozitës të nenit 289/1 të Kodit Penal, që i përket veprës penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, i rezultoi se subjekti aktiv i kësaj veprë penale përbën subjekt të posaçëm, i ngarkuar me respektimin e rregullave dhe marrjen e masave në zbatim të tyre.

Sipas subjektit, nga studimi i aktit të ekspertimit teknik të kryer në funksion të hetimeve, ekspertët kanë konkluduar ndër të tjera se nga ana e shoqërisë “P” sh.p.k. (“P” sh.p.k.) nuk është marrë përsipër për të kryer punime në linjën elektrike, por është pranuar vetëm puna e saldimit të ndarësit. Jo vetëm nga sa kanë konstatuar ekspertët, por edhe nga sa prova janë administruar gjatë hetimit, subjekti ka vlerësuar se i pandehuri A.P nuk përmbush kriterin e të qenit subjekt aktiv i veprës penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” dhe në referim të nenit 328/1/dh të Kodit të Procedurës Penale, në datën 25.6.2016 ka vendosur pushimin e akuzës në ngarkim të tij.

70.4 Lidhur me ngritjen e akuzës ndaj shtetasit S.P, subjekti ka shpjeguar se, referuar ngjarjes së ndodhur, si dhe nga sa është konkluduar nga ekspertët e fushës, i ka rezultuar se ky shtetas nuk ishte personi i autorizuar për të kryer punime në fushën e elektricitetit dhe për, më tepër, të kryente punime në një shtyllë me tension elektrik. Po ashtu, ky shtetas nuk gëzonte asnjë të drejtë që të pajtonte për punë të kësaj natyre persona të tretë, sikurse rezultoi të ishte viktima P.Ll. Duke marrë në analizë veprimet e kryera nga shtetasi S.P, i cili ka siguruar veglat e punës, si dhe fuqinë punëtore të paspecializuar për këto punime, kërkimi nga shtetasi P.Ll që të realizonte punimet e montimit, ka vlerësuar se këto veprime përmbajnë elemente të veprimeve të kundërligjshme, që kanë sjellë si pajojë vdekjen e shtetasit P.Ll, duke vërtetuar njëkohësisht ekzistencën e elementeve të veprës penale “Vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal. Bazuar në këtë analizë, subjekti, nëpërmjet vendimit përkatës të datës 2.7.2016, ka ngritur akuzë ndaj shtetasit S.P, duke dërguar çështjen për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

70.5 Lidhur me këtë çështje, subjekti ka prapësuar se ngritja e akuzave dhe pushimi i hetimeve ndaj shtetasit A.P është kryer vetëm në analizë të fakteve dhe provave të administruara. Gjithashtu, pushimi i akuzës ndaj të pandehurit A.P për veprën penale

“Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” është realizuar vetëm në reflektim objektiv ndaj të gjitha provave të administruara.

Vlerësim i Komisionit

70.6 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna dhe dosjes penale të administruar, i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit, i cili bazuar në faktet dhe provat e rezultuara gjatë hetimit ka vlerësuar që për këtë ngjarje të ngrejë akuzë ndaj shtetasit S.P dhe jo ndaj shtetasit A.P. Nisur nga fakti se për këtë çështje penale evidentohet ngritja e një akuze dhe pikërisht ndaj babait të të pandehurit, përjashtohet dyshimi mbi lehtësimin e pozitës së të pandehurit nga subjekti, i cili ka vendosur bazuar në analizën e fakteve dhe çmuarjen e provave të administruara gjatë hetimit të lidhur me themelin e çështjes penale. Përfundimisht, trupi gjykues çmon se subjekti në prapësime ka analizuar elementet e secilës prej veprave penale, duke shpjeguar bindshëm arsyen për të cilën ka vendosur pushimin e dy prej akuza ndaj të pandehurit.

71. Çështja penale e vitit 2016, në ngarkim të shtetasit A.L, akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, ku në datën 7.8.2016 në banesën e të pandehurit është gjetur lëndë narkotike *cannabis sativa*, të cilat rezultuan me peshë 71.15 kg.

Gjykata e Rrethit Gjirokastrë Sarandë, me vendimin datë 9.8.2016, ka caktuar ndaj të pandehurit masën e sigurimit “Arrest në burg”, masë e cila, bazuar në kërkesën e prokurorit Ilir Hoxha, është zëvendësuar nga gjykata në “Arrest në shtëpi”. Në përfundim të hetimit, subjekti ka kërkuar deklarinimin fajtor të shtetasit A.L, në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3 dhe përfundimisht në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

Konstatimi i Komisionit

71.1 Nga verifikimi i dosjes penale duket se subjekti përmes kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit dhe kërkesës për pezullimin e vuajtjes së dënimit, e cila nuk është pranuar nga gjykata, duket se ka lehtësuar pozitën e të pandehurit.

✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

71.2 Subjekti përmes prapësimeve të tij, ndër të tjera, ka shpjeguar se ndërsa i pandehuri A.L gjendej në paraburgim, nëpërmjet mbrojtësit të tij, bazuar në nenin 110 të Kodit të Procedurës Penale, kishte paraqitur një kërkesë në datën 17.10.2016, duke parashtruar se është invalid i shkallës së plotë dhe vuante nga sëmundje të rënda e të pashërueshme (sëmundja e diabetit, zemrës dhe sëmundje të tjera), të cilat janë të rrezikshme për jetën, përmes së cilës kërkonte kryerjen e një ekspertimi mjekoligjor pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore. Subjekti ka shpjeguar se bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej tij e ka vlerësuar të drejtë kërkesën e të pandehurit dhe në datën 24.10.2016 ka urdhëruar kryerjen e një ekspertimi mjekoligjor mbi gjendjen e tij shëndetësore. Sipas subjektit, referuar aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. **, viti 2017, ekspertët kanë konkluduar se sëmundjet nga të cilat ai vuan nuk e lejonin vijimin e zbatimit ndaj tij të masës së sigurimit “Arrest në burg”. Për rrjedhojë, bazuar në nenet 230/2 dhe 230/3 të Kodit të Procedurës Penale ka vlerësuar se nevojat e sigurimit tashmë ishin zbutur dhe se masa e sigurimit “Arrest në burg” nuk ishte masa e duhur ndaj shtetasit A.L. Ndaj, me kërkesën e datës 18.1.2017 subjekti ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Sarandë zëvendësimin e masës së sigurimit, kërkesë e cila është pranuar

nga gjykata me vendimin nr. ***, datë 21.1.2017, duke e zëvendësuar me masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale.

71.3 Sa i përket kërkesës për aplikimin e dënimit alternativ, subjekti ka shpjeguar se në përfundim të hetimit ka kërkuar në gjykatë deklarin e fajtor të të pandehurit A.L, si dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, duke e vënë të pandehurin në provë, por Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin datë 19.4.2017, ndër të tjera, ka vendosur deklarin fajtor, duke mos urdhëruar aplikimin e dënimit alternativ.

71.4 Subjekti ka shpjeguar se, duke qenë i bindur në objektivitetin e kërkesës së tij për aplikimin e dënimit alternativ, për të cilin, në këndvështrim të nenit 59 të Kodit Penal ka vlerësuar ekzistencën e një sërë rrethanash, dhe konkretisht moshën e të pandehurit (i datëlindjes 1950), si dhe gjendjen shëndetësore të të pandehurit, i cili ishte ekzaminuar nëpërmjet aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. **, viti 2017, me probleme shëndetësore, subjekti ka vlerësuar se arsyetimi i gjykatës nuk përfaqësonte një arsyetim objektiv të rrethanave të provuara në gjykim, të cilat i ka parashtruar edhe në ankimin e kryer prej tij ndaj këtij vendimi gjyqësor.

71.5 Subjekti ka shpjeguar se bazuar në ankimin e kryer prej tij, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, nëpërmjet vendimit datë 19.4.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për sa i përket mënyrës së vuajtjes së dënimit me burgim, ku në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, me kusht që i pandehuri A.L të mos kryejë veprë tjetër penale brenda një afati prove prej 3 vjetësh, duke realizuar një vlerësim të drejtë të të gjitha rrethanave, arsyetim ky që ishte në përputhje me konstatimet dhe kërkimet e subjektit. Sipas subjektit, nga vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë konstatohet lehtësisht se qëndrimi i kësaj gjykate vjen në përputhshmëri me bindjen e subjektit.

71.6 Në përfundim, subjekti ka prapësuar se qëndrimi i mbajtur prej tij në lidhje me zëvendësimin e masës së sigurimit përfaqëson një qëndrim korrekt mbi provat e administruara dhe vetëm për shkak të gjendjes shëndetësore të të pandehurit, e cila nuk lejonte vijueshmërinë e masës së sigurimit “Arrest në burg”. Gjithashtu, kërkimi mbi aplikimin e dënimit alternativ përfaqëson një qëndrim të mbajtur vetëm duke u bazuar në vlerësimin objektiv të të gjitha rrethanave të provuara që, në tërësinë e tyre, ishin të tilla dhe që duheshin marrë në vlerësim objektiv nga gjykata dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, i datës 19.4.2017, provon më së miri objektivitetin e kërkimeve të tij. Subjekti ka paraqitur si dokumentacion provues:

- vendimin nr. *** (***) , datë 19.4.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë;
- vendimin nr. ***, datë 19.4.2017, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, e cila ka vendosur ndër të tjera pezullimin e ekzekutimit të dënimit të të pandehurit.

Vlerësimi i Komisionit

71.7 Pas shpjegimeve të subjektit, si dhe në referim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, të cilat përcaktojnë kushtet e kriteret e caktimit të masave të sigurimit dhe të ndryshimit të këtyre masave, si dhe referuar vendimit gjyqësor, i cili ka pranuar kërkesën e subjektit për ndryshimin e masës së sigurimit personal nga “Arrest në burg” në një masë më

të butë “Arrest në shtëpi” për shtetasin nën hetim, trupi gjykues e çmon të drejtë këtë qëndrim të subjektit, për sa kohë nuk bie ndesh me ndonjë nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

71.8 Sa i përket aplikimit të dënimit alternativ, në prapësime subjekti arriti të provojë se qëndrimi i tij për pezullimin e ekzekutimit të dënimit ndaj të pandehurit vjen në përputhje me vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, e cila e ka konsideruar të drejtë aplikimin e këtij dënimi alternativ, sipas kërkesës së subjektit.

71.9 Përfundimisht, trupit gjykues nuk i rezultuan *indicie* apo rrethana për fakte konkrete, të cilat të krijojnë bindjen se subjekti ka kryer shkelje ligjore në veprimtarinë e tij, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

72. Çështja penale nr. *, viti 2017**, për veprën penale “Kontrabanda me mallra të tjerë”, kryer në bashkëpunim, pa autor të regjistruar, e cila konsiston në një aksident të ndodhur në datën 29.4.2017 në aksin nacional Muzinë-Sarandë, ku një kamion trailer, i drejtuar nga shtetasi kosovar M.S, teksa ka qëndruar në krah të rrugës, është goditur nga automjeti i drejtuar nga shtetasi kroat L.T. Si pasojë e goditjes ka rënë zjarr dhe dy këto automjete dhe ngarkesa e ndodhur në trailer (me vlerë mallrash 263.109 euro) janë djegur plotësisht. Nga rrethanat e çështjes ekzistonin dyshime mbi kryerjen me qëllim të këtij aksidenti për mostransportimin e mallrave në destinacion dhe shmangien e detyrimeve doganore, bazuar edhe në deklaratimet e drejtuesit të automjetit, shtetasit kroat L.T, në kundërshtim me deklaratimet e drejtuesit të trailerit, shtetasit M.S.

Konstatime të Komisionit

72.1 Nga verifikimi i dosjes penale ka rezultuar se:

- Subjekti përmes procesverbaleve përkatëse u ka kthyer dhe dorëzuar këtyre shtetasve (drejtues të mjeteve) dokumentet e identifikimit, duke mundësuar largimin e tyre nga territori i Shqipërisë, ndërkohë që hetimet nuk kishin përfunduar.
- Nisur nga deklaratimet kontradiktore të drejtuesve të mjeteve, nga aktet nuk evidentohet akti i kryerjes së ballafaqimit të tyre, bazuar në nenet 169 dhe 170 të Kodit të Procedurës Penale.
- Subjekti në vitin 2017 ka kërkuar ndihmë juridike nga autoritetet gjyqësore në Kosovë, ndërsa autoriteteve gjyqësore në Kroaci u ka dërguar kërkesë për ndihmë juridike vetëm në vitin 2020, duke qenë në moskoherencë me veprimet e tij drejtuar këtyre autoriteteve.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kërkuar shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

72.2 Subjekti ka shpjeguar se ky procedim penal gjendet për shqyrtim pranë gjyqtarit të seancës paraprake. Subjekti ka shpjeguar në mënyrë të detajuar faktet dhe rrethanat e ngjarjes, në drejtim të verifikimit të kryerjes së veprës penale “Kontrabanda me mallra të tjerë”, kryer në bashkëpunim, me qëllim shmangien nga detyrimet doganore. Duke vlerësuar se në rastin konkret nuk mund të provohet fakti që ngjarja e ndodhur në datën 29.4.2017 të përmbajë elementet e kësaj figure të veprës penale, në datën 21.6.2023 i është drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake me kërkesën për pushimin e këtij procedimi penal.

72.3 Në lidhje me kthimin e dokumenteve të identifikimit drejtuesve të mjeteve, ndërkohë që hetimet nuk kishin përfunduar, subjekti ka shpjeguar se në kuadër të veprimeve të para procedurale dhe hetimore, me cilësinë e provës materiale është sekuestruar edhe pasaporta e shtetasit kroat L.T, dhe pasi ka vlerësuar sekuestrimin, ka urdhëruar kthimin e saj, pasi nuk kishte rëndësinë e provës materiale në hetimet që po zhvilloheshin. Subjekti thekson se ky urdhërim ka ndodhur para momentit që ky shtetas ka dhënë deklaratimet e tij se aksidenti i ndodhur ishte i planifikuar, si dhe ende pa u vënë në dijeni subjekti për ato deklarime. Sipas subjektit, në fillësë ky procedim penal nuk i është atribuuar ndonjë shtetasi konkret dhe në asnjë moment procedural nuk ka parashtruar ndonjë kërkesë për caktimin e masës së sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, parashikuar nga neni 233 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj ndonjë shtetasi konkret. Subjekti ka prapësuar se vetëm nëse do të ekzistonte një masë e tillë, atëherë, në funksion të ekzekutimit të saj, do të legjitimohej vendosja dhe mbajtja nën sekuestro e një dokumenti të vlefshëm identifikimi ndaj shtetasit që, jo vetëm i atribuohet vepra penale, por edhe që ishte caktuar masa e sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, parashikuar nga neni 233 i Kodit të Procedurës Penale. Në të tilla rrethana, subjekti ka vlerësuar se heqja e sekuestrimit mbi pasaportën në emër të shtetasit kroat L.T, është kryer në aplikim korrekt të të gjitha normave procedurale dhe, njëkohësisht, në përputhje me gjendjen e procedimit.

72.4 Në lidhje me mosrealizimin e ballafaqimit midis dy drejtuesve të mjeteve, subjekti ka shpjeguar se ndonëse janë konstatuar kontradikta midis deklaratimeve të disa shtetasve, është vlerësuar se primare dhe më kryesore do të ishte marrja në përputhje me të gjitha normat procedurale të deklaratimeve të shtetasit kroat L.T, të cilat, për shkaqe objektive dhe të pavarura nga vullneti i organit procedues, nuk është bërë e mundur të merren. Subjekti ka vlerësuar se vetëm pas administrimit të deklaratimeve të këtij shtetasi do të krijohet mundësia e zgjerimit të veprimeve hetimore, si dhe kryerjes së veprimit hetimor të ballafaqimit.

72.5 Në lidhje me moskoherencën e veprimeve drejtuar autoriteteve të huaja, subjekti ka shpjeguar se pasi ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, në datën 17.10.2017 ka vendosur pezullimin e hetimeve për këtë procedim penal, pasi nuk kishte mbërritur ende përgjigjja e letër kërkesës për ndihmë juridike në fushën penale të autoriteteve gjyqësore të Republikës së Kosovës, kërkuar me shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2017, dhe rrjedhimisht nuk ishte bërë i mundur administrimi i provave konkrete që do të mundësonin vijimin e mëtejshme të hetimeve. Subjekti ka shpjeguar se në datën 4.5.2020, pasi ka marrë në shqyrtim aktet e procedimit penal nr. ***, viti 2017, me qëllim administrimin e provave të reja, të domosdoshme për ecurinë e mëtejshme të hetimit, në këtë moment procedural ka vlerësuar të domosdoshme që hetimet për këtë procedim penal të rifillojnë, duke vendosur rifillimin e hetimeve. Në vijim, bazuar në studimin e hollësishëm të të gjitha provave, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 16.6.2020, u ka parashtruar letër kërkesë për ndihmë juridike në fushën penale autoriteteve gjyqësore të Republikës së Kroacisë, e cila është ekzekutuar nga këto të fundit, ku nga tërësia e akteve të vëna në dispozicion nuk është përfutur asnjë provë që të konfirmojë dyshimet se në ngjarjen objekt hetimi gjendemi para një inskenimi të ngjarjes në fjalë. Subjekti ka prapësuar se të gjitha veprimet hetimore dhe procedurale të kryera prej tij janë realizuar në dinamikë dhe në përputhje me ecurinë e hetimit.

Vlerësimi i Komisionit

72.6 Komisioni, në analizë të prapësimeve të subjektit, i konsideron bindëse shpjegimet e tij, me arsyetimin se vendosja dhe mbajtja nën sekuestro e dokumentit të identifikimit ndaj drejtuesve të mjeteve do të legjitimohej në rast se këtyre shtetasve do t'u ishte atribuuar vepra penale apo ndaj tyre do të ishte caktuar ndonjë masë sigurimi për ndalimin e daljes jashtë shtetit.

72.7 Sa i përket vonesës dhe moskoherencës së veprimeve hetimore në dërgimin e letërporosive drejtuar autoriteteve të huaja, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë dhe të shpjegojë bindshëm arsyen e zvarritjes së veprimeve hetimore, si dhe moskryerjen e ballafaqimit midis drejtuesve të mjeteve, bazuar në nenet 169 dhe 170 të Kodit të Procedurës Penale, nisur nga deklaratimet kontradiktore të dhëna prej tyre, të cilat mund të çonin në zbardhjen e rrethanave të çështjes penale dhe zgjidhjen e saj.

72.8 Trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka kryer veprimet e duhura hetimore në një kohë të arsyeshme në trajtimin e kësaj çështjeje penale, pasi kërkesat për ndihmë juridike, drejtuar autoriteteve gjyqësore në Kroaci dhe Kosovë mund t'i kishte dërguar në të njëjtën kohë, pra në vitin 2017, ndërsa njëren prej këtyre kërkesave e ka dërguar pas 3 vitesh. Gjithashtu, Komisioni konstaton zvarritje të hetimit të kësaj çështjeje, e cila është regjistruar si procedim penal në maj të vitit 2017 dhe akti i fundit i prokurorit ka qënë kërkesa e datës 21.06.2023, për pushimin e procedimit penal nr.***/2017.

72.9 Përfundimisht, Komisioni çmon se subjekti ka krijuar vonesa të qëllimshme duke zvarritur hetimin e kësaj çështjeje penale, çka përbën cenim të veprimtarisë së organit të akuzës dhe moskryerje të detyrës në nivelin e duhur nga ana e subjektit.

73. Çështja penale e vitit 2015, bazuar në kallëzimin e shtetasit Xh.I ndaj punonjësve të ish-ZVRPP-së Sarandë, si dhe shtetasit S. I. për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, pasi përmes falsifikimit i kanë ndryshuar vendndodhjen e pasurisë/banesës së tij të blerë që prej vitit 1995, duke ia dhënë një shtetasi tjetër, i cili me dokumente false ka ndërtuar një hotel. Ankuesi pretendon se prokurori Ilir Hoxha nuk ka hetuar çështjen, por ka lëshuar vendime për pushim, të cilat janë kthyer 5 herë nga Gjykata e Apelit për rihetim dhe që nga viti 2015 kjo çështje nuk ka përfunduar.

Konstatime të Komisionit

- Subjekti nuk ka zbatuar urdhërimet e gjykatës, e cila ka kthyer aktet për hetim të paplotë, duke u zvarritur hetimi i çështjes për një periudhë nga viti 2015 deri në vitin 2022.

Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime mbi të gjitha hapat proceduralë të ndërmarrë në hetimin e çështjes, mbështetur në dokumentacion justifikues, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

73.1 Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se procedimi penal nr. ***, viti 2015, gjendet ende në fazën e hetimit paraprak. Subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e çështjes, ku shtetasi Xh.I kishte pretendime për falsifikimin e dokumenteve nga personeli i ZVRPP-së Sarandë, lidhur me hartën treguese të pasurisë së tij.

Subjekti ka analizuar elementet e figurës së veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, duke shpjeguar se zhvillimi i hetimit konsistente në

vërtetimin e faktit nëse hartat treguese të pasurisë së kallëzuesit, të prodhuara në kohë të ndryshme nga ZVRPP-ja Sarandë, kanë të njëjtin konfigurim, përmasa dhe sipërfaqe me hartën treguese të regjistrimit fillestar të pasurisë së blerë nga kallëzuesi me kontratën e shitblerjes datë 6.6.1995. Subjekti ka argumentuar se nga tërësia e veprimeve të mundshme hetimore ka rezultuar se dokumentacioni i pasurisë, pra harta treguese pranë ZVRPP-së Sarandë, ishte identik me dokumentacionin e pasurisë së fituar nga shtetasi Xh.I.

73.2 Subjekti ka shpjeguar se në datën 22.1.2016 ka vendosur pushimin e hetimeve, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, por është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Gjjirokastër me vendimin datë 11.11.2016, e cila, ndër të tjera, ka vendosur prishjen e vendimit të prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, duke çmuar si të domosdoshme kryerjen e disa veprimeve hetimore, si: tërheqja e gjithë praktikës së regjistrimit të pronës nga ZVRPP-ja; marrja e informacioni të detajuar nga ZVRPP-ja Sarandë për mënyrën e pasqyrimit të të dhënave të pronës në hartat treguese në vite; marrja në pyetje e regjistruarit të ZVRPP-së Sarandë apo punonjësve të tjerë; kryerja e një akti të ri ekspertimi topografik, i cili do t'u jepte zgjidhje pretendimeve të ngritura nga kallëzuesi.

73.3 Subjekti ka shpjeguar se në zbatim të vendimit gjyqësor janë kryer veprimet përkatëse hetimore, duke kërkuar informacion në institucione të ndryshme, duke marrë deklaratimet e zëvendësregjistruarit të ZVRPP-së Sarandë, si dhe është kryer akti i ekspertimit në datën 21.6.2017, ku është konkluduar se planvendosjet e pasurisë nuk kanë asnjë ndryshim nga njëra-tjetra.

Nisur nga konkluzionet e aktit të ekspertimit, në datën 20.7.2017 subjekti ka vendosur sërish pushimin e çështjes, e cila është ndryshuar pjesërisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin datë 31.10.2017, duke orientuar ankuesin t'i drejtohet ZQRPP-së Tiranë në rrugë administrative, për ndreqjen e hartës treguese të regjistrimit të pasurisë. Ndërsa Gjykata e Apelit Gjjirokastër, me vendimin datë 28.12.2017, ka vendosur ndër të tjera prishjen e vendimit të pushimit të prokurorit dhe dërgimin e akteve për vazhdimin e hetimeve, ku prokurori në hetimet në vijim duhet të kryente administrimin e praktikës së regjistrimit të pasurisë, pjesë e së cilës janë planvendosjet dhe hartat treguese, të dala në vite, pyetja e punonjësve të ZVRPP-së Sarandë që kanë përpiluar hartën e vitit 2014, si dhe ekspertimi topografik në lidhje me pozicionimin e pasurisë së kallëzuesit Xh.I në raport me gjurmën e murit të vjetër rrethues.

73.4 Subjekti ka shpjeguar se edhe pse ishte administruar më parë praktika pranë ZVRPP-së, në zbatim të vendimit gjyqësor ka kryer veprimet përkatëse. Sipas subjektit, nga akti i ekspertimit të datës 5.11.2018 ka rezultuar i njëjti konkluzion, për rrjedhojë, në datën 26.12.2018 i është drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake me kërkesën për pushimin e çështjes, kërkesë e cila sërish nuk është pranuar nga gjykata me vendimin datë 24.1.2019, duke kthyer aktet dhe urdhëruar vazhdimin e hetimeve, nëse ka ndërhyrje në konfigurimin e pronës pas azhurnimit dhe futjes në sistem në vitin 2014, nga kush është bërë ndërhyrja dhe çfarë ndërhyrje është bërë. Subjekti ka shpjeguar se në zbatim të urdhërimeve të gjykatës i është drejtuar ZVPPP-së Sarandë nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 11.3.2019, e cila ndër të tjera e ka informuar se në secilën prej hartave manuale dhe elektronike nuk rezulton të ketë ndërhyrje/modifikime/ndryshime në lidhje me pasurinë e shtetasit Xh.I. Nisur nga ky fakt, subjekti sërish ka kërkuar pushimin e çështjes, por gjykata me vendimin e datës 2.5.2019 ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve brenda 60 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar, duke caktuar si detyrë kryerjen e një

ekspertimi teknik hartografik krahasues, ku t'i jepen zgjidhje detyrave nëse genplani i administruar pranë ZVRPP-së Sarandë dhe ai i dërguar prej ATP-së (në original) paraqesin të njëjtën sipërfaqe konfiguruese dhe shtrirje të pronës së shtetasit Xh.I, si dhe nëse hartat e prodhuara në vitin 2002 dhe më pas, në raport me hartën origjinale, paraqesin të njëjtën konfigurim, sipërfaqe dhe shtrirje.

73.5 Subjekti ka shpjeguar se nëpërmjet vendimit përkatës të datës 6.12.2019 ka urdhëruar sërish kryerjen e ekspertimit teknik hartografik, ku nga konkluzionet e ekspertëve ka krijuar bindjen se ato janë në përputhje me realitetin dhe me konkluzionet e ekspertimeve të kryera më parë, pasi në të gjitha rastet përputhet plotësisht konfigurimi i pronës sipas vërtetimeve hipotekore dhe hartave treguese në vite. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se në diskutimin përfundimtar i ka kërkuar gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e çështjes penale, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata me vendimin nr. ***, datë 15.1.2021.

73.6 Lidhur me këtë çështje, subjekti ka prapësuar se të gjitha veprimet hetimore dhe procedurale të kryera prej tij kanë qenë veprime të kryera në dinamikë konstante dhe në përputhje me vendimet e gjykatës apo me dinamikën e rezultateve të arritura. Sipas subjektit, tejzgjatja e kësaj çështjeje nuk është produkt i mosveprimit nga ana e prokurorit, por është produkt vetëm i kundërshtimeve dhe ankimeve të herëpashershme nga shtetasi Xh.I, interesat e të cilit nuk janë kënaqur nga evidentimi i realitetit nga ana e veprimeve hetimore dhe ekspertimeve të kryera apo edhe nga ankimet e prokurorit ndaj vendimeve jo të drejta të gjykatës. Subjekti ka sqaruar se ky shtetas ka paraqitur ankesat e tij, 4 të tilla, edhe para Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili, pasi ka marrë në shqyrtim të gjitha aktet e çështjes, nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 31.1.2022, ka vendosur arkivimin e ankesave, çka sipas subjektit provon se të gjitha veprimet e kryera prej tij në hetimin e kësaj çështjeje janë në zbatim korrekt të të gjitha normave penale dhe proceduralo-penale. Subjekti ka paraqitur si dokument provues:

- vendimin nr. ***, datë 31.1.2022, të ILD-së, për arkivimin e ankesës së shtetasit Xh.I;
- *email*-in e datës 5.1.2024, ku konfirmohet se procedimi penal nr. ***, viti 2015, rezulton nën hetim, pas shfuqizimit nga Gjykata e Apelit.

Vlerësimi i Komisionit

73.7 Komisioni, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe rrethanave të çështjes penale, vlerëson se kthimi i akteve nga gjykata, në mënyrë të përsëritur, duke caktuar çdo herë detyra të reja për organin e akuzës dhe jo plotësim të hetimeve, nuk provon se nga ana e subjektit ka mangësi në hapat hetimorë. Me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale (ligji nr. 35/2017, datë 30.3.2017) është gjyqtari i seancës paraprake ai që merr në shqyrtim kërkesat e prokurorit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të tij, vendimmarrjet e të cilit realizohen në bazë të vlerësimeve të tij ndaj faktit dhe provave të administruara gjatë hetimit, ku në përfundim gjykata e rrethit gjyqësor në datën 15.1.2021 ka vendosur pushimin e çështjes, sipas kërkesës së subjektit.

73.8 Trupi gjykues vlerëson se jo gjithmonë kthimet e akteve nga gjykata për hetime të mëtejshme shërbejnë si indikatorë për moskryerje të detyrës nga ana e prokurorit, siç është në rastin konkret, pasi nga ana e subjektit duket se janë zbatuar urdhërimet e gjykatës, pavarësisht se kjo e fundit në mënyrë të herëpashershme ka gjykuar se duhen kryer hetime shtesë dhe jo hetime plotësuese. Në vlerësimin final lidhur me këtë çështje, trupit gjykues

nuk i rezultuan *indicie* apo rrethana për fakte konkrete, të cilat të krijonin bindjen se subjekti ka kryer shkelje ligjore në veprimtarinë e tij, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

Gjetje të tjera/sjellja e magistratit jashtë ushtrimit të funksionit

74. Referuar të dhënave të gjeneruara nga sistemi TIMS, Komisioni ka hetuar lidhur me automjetet, si dhe shtetasit me të cilët ka udhëtuar subjekti, ku ka rezultuar se subjekti ka udhëtuar jashtë vendit me automjete të ndryshme në pronësi ose posedim të shtetasve A.B, B.B, A.H, E.D, L.S, E.H dhe Rr.B, për të cilët ka deklaruar¹²⁷ se me secilin prej tyre ka marrëdhënie shoqërore prej vitesh.

74.1 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se disa prej këtyre shtetasve janë proceduar për vepra të ndryshme penale, të cilat nuk përfshihen në veprat penale për krim të organizuar, trafikim dhe korrupsion, të parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, konkretisht:

- a. Shtetasi B.B në datën 3.9.2012 është proceduar në gjendje të lirë për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal. Gjithashtu, në ngarkim të shtetasve B.B dhe A.B, në datën 11.7.2018 është regjistruar¹²⁸ procedimi penal nr. ***, për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 89 e 25 të Kodit Penal, për të cilën Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në datën 2.8.2018 ka vendosur pushimin e çështjes, pasi i dëmtuari nga vepra penale kishte hequr dorë nga ankimi.
- b. Shtetasi A.H(M) në datën 6.7.2012 është proceduar për veprën penale “Organizimi i lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal dhe në datën 16.1.2014 është proceduar në gjendje të lirë për *aktivitetin e lotarive të palejuara, baste sportive*. Gjithashtu, në datën 30.7.2019 ka rezultuar¹²⁹ një material kallëzues i regjistruar më 30.7.2019 ndaj këtij shtetasi për veprën penale “Tregtim të mallrave të dyshuara si kontrabandë”, parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal, ku në përfundim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur mosfillimin e kallëzimit penal.
- c. Shtetasi B.T në datën 23.2.2021 është proceduar për veprën penale “Dëmtime të tjera me dashje” (rrahja), parashikuar nga neni 90/1 i Kodit Penal, ku në përfundim të veprimeve hetimore organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në datën 13.3.2021 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.
- d. Shtetasi E.D është deklaruar¹³⁰ fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë, datë 2.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për veprën penale “Organizimi i lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, duke u dënuar përfundimisht me gjobë në shumën 400.000 lekë. Gjithashtu, ky shtetas rezulton i dënuar edhe për një tjetër vepër penale, “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, ku me vendimin nr. ***, datë 6.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor, duke u dënuar përfundimisht me gjobë.

¹²⁷ Referuar shpjegimeve të subjektit me *email*-in datë 19.6.2023.

¹²⁸ Referuar shkresës nr. ***prot., datë 3.7.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

¹²⁹ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 3.7.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

¹³⁰ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 3.7.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, si dhe shkresës nr. *** prot., datë 30.6.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

- e. Ndërsa për shtetasit L.S, R.B dhe E.H nga hetimi i kryer nuk kanë rezultuar të dhëna që të jenë proceduar për ndonjë vepër penale.

74.2 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar:

- Shoqërimi i subjektit me persona të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme dhe të proceduar/dënuar për vepra penale, të cilat ndikojnë negativisht dhe cenojnë standardet e sjelljes së magjistratit, etikën e tij në punë dhe angazhimin ndaj vlerave, referuar ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

74.3 Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjekti ka deklaruar se është plotësisht dakord për sa i përket vërtetësisë së fakteve të ekzistencës së lidhjeve shoqërore me këta persona, si dhe realizimit të disa udhëtimeve jashtë Shqipërisë (në shumicën dërmuese hyrje/dalje dhe qëndrime disaorëshe në Maqedoninë e Veriut), së bashku me këta persona, ndërsa ka paraqitur kundërshtimet e tij në lidhje me procedimin e disa prej këtyre personave, duke deklaruar se në asnjë moment më parë nuk ka pasur dijeni në lidhje me këto fakte.

74.4 Lidhur me informacionin për shtetasin B.T, subjekti sqaron se me të kanë qenë kolegë si oficerë të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe aktualisht ai punon në të njëjtin funksion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

74.5 Subjekti deklaron se në asnjë moment nuk është vënë në dijeni të fakteve se në kohë të ndryshme, për një pjesë të tyre janë referuar materiale kallëzuese apo që ndonjëri prej tyre të jetë dënuar penalisht. Përjashtim mbi padijeninë e tij bën vetëm fakti i konstatuar se ndaj shtetasve B.B dhe A.B është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 11.7.2018, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, fakt për të cilin deklaron se e ka marrë vesh ditë pasi ngjarja kishte ndodhur. Sipas subjektit, dijenia e tij ka qenë rastësore, teksa një fundjavë ka shkuar pranë familjes në Pogradec, pasi në atë periudhë gjendej në qytetin e Sarandës, ku ushtronte detyrën e tij. Subjekti ka shpjeguar se, edhe pse kjo ngjarje në vlerësimin e tij përfaqëson një ngjarje të momentit që ka për bazë sjelljen e një prindi në reagim ndaj dhunimit që i bëhet të birit vetëm 12 vjeç, ecuria e mëtejshme e kësaj çështjeje, pavarësisht faktit se ndjekja penale është pushuar në një kohë të shkurtër, ka passjellë distancimin e tij në marrëdhëniet me këta shtetas, distancim ky i reflektuar në përditshmërinë e marrëdhënieve me këta persona, dhe jo vetëm, fakt ky i dokumentuar edhe në të dhënat e sistemit TIMS.

74.6 Subjekti ka prapësuar se në ekzistencën e marrëdhënieve të tij me këta shtetas kërkon të mbahet parasysh fakti që njohja me ta është krijuar herët dhe në moshë të re dhe, duke qenë në marrëdhënie pune që nga viti 1995 dhe përgjatë saj nuk është vënë në dijeni për ndonjë sjellje apo veprim të tyre që mund të cenonin etikën e figurës së oficerit të policisë gjyqësore, apo edhe atë të prokurorit në vijim, ka vijuar të ruajë të njëjtin nivel marrëdhëniesh, me një trend largësie në vitet e fundit. Subjekti thekson se për asnjë moment një sjellje e tillë, pra shoqërimi me persona të tjerë, nuk është evidentuar të ndodhë në territorin e rrethit gjyqësor ku ka ushtruar detyrën e prokurorit dhe në përmbushjen e detyrës

së tij ka ruajtur gjithmonë etikën profesionale dhe njerëzore, në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor në fuqi.

Vlerësimi i Komisionit mbi sjelljen e magjistratit jashtë funksionit

74.7 Komisioni nga hetimi i kryer evidentoi shoqërimin e subjektit me shtetas të proceduar për vepra të ndryshme penale dhe njëri prej tyre i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, trajtuar sa më sipër. Kjo sjellje e subjektit ndikon negativisht në figurën e magjistratit dhe cenon standardet e sjelljes së tij, etikën në punë dhe angazhimin ndaj vlerave. Komisioni vlerëson se subjekti duhet të kishte treguar kujdesin e duhur për të ruajtur të pastër në sytë e publikut figurën e magjistratit.

74.8 Komisioni vlerëson se sjellja e subjektit, mungesa e kujdesit të treguar prej tij, dhe shoqërimi me persona të proceduar për vepra të ndryshme penale, është shqetësues dhe nuk duhet të mbetet pa u trajtuar. Ligji nr. 84/2016 nuk ka të parashikuar dispozita ligjore në lidhje me shkelje të tilla të kryera nga subjekti, pasi me ligj janë kompetencë e një institucioni tjetër. Komisioni referuar ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku në shkronjën “ç” të nenit 103, me titull “Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit”, parashikohet se: *“Sipas parashikimeve të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 101 të këtij ligji, shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë në veçanti aktet dhe sjelljet e magjistratit, si vijon: ç) shoqërimi me persona që janë në ndjekje penale ose janë subjekte të një procedimi penal ose me persona të dënuar, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar ose persona të cilët janë të afërm me magjistratin në lidhje gjaku ose me ligj dhe pasja e marrëdhënieve të biznesit të papërshtatshme me këta persona”*; jurisprudence së KPA-së¹³¹; Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (Karta e Romës 2014)¹³²; Udhëzimeve të Budapestit për Etikën dhe Sjelljen për Prokurorët Publikë¹³³; si dhe parimeve të gjithëpranuara të Bangalores¹³⁴

¹³¹ Referuar Vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr.26/2021 (B.H) paragrafi 28.7 dhe Vendimi i Kolegjit nr.28/2019 (E.M) paragrafët 43-45.

¹³² Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë “Karta e Romës”, 2014, (<https://rm.coe.int/168074738b>):

Pika 3.4.2 “Papajtueshmëritë dhe konflikti i interesit”, e cila parashikon: “80. Prokurorët duhet, në çdo moment, të sillen në mënyrë profesionale dhe të përpiqen të jenë dhe të shihen si të pavarur dhe të paanshëm”;

Pika 4.1.3 “Detyra për të ruajtur dinjitetin e profesionit” e cila parashikon: “97. Prokurorët duhet të fitojnë besimin e publikut duke demonstruar në të gjitha rrethanat një sjellje shembullore. Ata duhet t’i trajtojnë njerëzit në mënyrë të drejtë, të barabartë, me respekt dhe edukatë, si dhe duhet të respektojnë në çdo kohë standardet më të larta profesionale dhe të ruajnë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre, duke u sjellë gjithmonë me integritet dhe me kujdes”.

Pika 4.2 “Liritë themelore të prokurorëve”, e cila parashikon: “101. Duhet të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm për të garantuar respektimin e privatësisë së prokurorëve. Megjithatë, ata duhet të sillen me maturi dhe kujdes për të mos vënë në pikëpyetje dinjitetin e profesionit të tyre ose aftësinë e tyre për të ushtruar funksionet e tyre”.

¹³³ Këshilli i Evropës 'Udhëzimet e Budapestit për Etikën dhe Sjelljen për Prokurorët Publik', tek seksioni II “Sjellja profesionale në përgjithësi” parashikon se: “Prokurorët duhet t’u përmbahen gjithmonë standardeve më të larta profesionale dhe të mos lejojnë që interesat personale apo financiare, apo marrëdhëniet familjare, sociale apo të tjera të ndikojnë në mënyrë jo të duhur në sjelljen e prokurorit si prokuror publik”.

¹³⁴ Komentari mbi Parimet e Bangalore të Sjelljes Gjyqësore 2007, “Rëndësia / relevanca e standardeve të komunitetit” Paragrafi 102 parashikon: “Ndërsa parimi i integritetit është i lehtë për t’u deklaruar në terma të përgjithshëm, është shumë më e vështirë dhe ndoshta edhe e pamundur ndonjëherë ta vësh në zbatim në terma më specifikë. Efekti i sjelljes në perceptimin e komunitetit varet në mënyrë të konsiderueshme nga standardet e komunitetit që mund të ndryshojnë sipas vendit dhe kohës. Kjo duhet mbajtur parasysh në shqyrtimin se si një sjellje e caktuar mund të perceptohet nga anëtarët e arsyeshem, me mendje të drejtë (logjike) dhe të informuar të atij komuniteti përkatës, dhe nëse një perceptim i tillë ka të ngjarë të zvogëlojë respektin e komunitetit për gjyqtarin ose gjyqësorin në tërësi, çdo sjellje që ka të ngjarë të ulë respektin në mendjet e këtyre personave duhet të shmanget” dhe pika 3.1 parashikon se “Gjyqtari duhet të sigurojë që sjellja e tij ose e saj të jetë korrekte dhe e paqortueshme nga pikëpamja e një vëzhguesi të arsyeshem”;

“Kërkohen standarde të larta si në jetën private ashtu edhe në atë publike”, Paragrafi 103 “Një gjyqtar duhet të mbajë standarde të larta si në jetën private ashtu edhe në atë publike. Arsyeja për këtë qëndron në gamën e gjerë të përvojës dhe sjelljes njerëzore mbi të cilën një gjyqtar mund të thirret për të shpallur gjykimin e vendimin e tij. Nëse gjyqtari do të dalë e të dënojë publikisht atë që ai ose ajo vet praktikon privatisht, gjyqtari do të shihet si hipokrit. Kjo çon në mënyrë të pashmangshme në një humbje të besimit të publikut tek gjyqtari, gjë që mund të shkatërojë gjyqësorin në përgjithësi.”

(2007); në analizim të të gjitha rrethanave të konstatuara në rezultatet e hetimit, si dhe shpjegimeve të parashtruara nga subjekti, Komisioni çmon se në rastin konkret këto rrethana tregojnë për një qëndrim neglizhent dhe jo të kujdesshëm të subjektit të rivlerësimit për ambientin dhe personat që e rrethojnë.

74.9 Referuar fakteve të hetimit se këta shtetas janë shkelës të ligjit, fakt i cili në sytë e publikut ngre pikëpyetje mbi integritetin dhe besimin e subjektit të rivlerësimit, apo nevojës dhe interesave të përbashkët që bashkojnë subjektin e rivlerësimit me këta individë. Për vetë statusin dhe funksionin që përfaqëson magjistrati, shmangia e kontakteve me persona me probleme me ligjin është një domosdoshmëri dhe nevojë, që shoqëria e gjerë duhet ta perceptojë dhe besojë si të tillë, qëllim kryesor i së cilës është pasja e besimit te sistemi i drejtësisë, në tërësinë e tij.

74.10 Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm të kundërtën e barrës së provës lidhur me shoqërimin e tij, me persona të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme, dhe si e tillë, mbeten të provuara situata që ndikojnë negativisht dhe cenojnë standardet e sjelljes së magjistratit, etikën e tij në punë dhe angazhimin ndaj vlerave, referuar ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

DENONCIME

75. Në Komision janë depozituar në total 20 denoncime për subjektin e rivlerësimit Ilir Hoxha. Pas analizimit të denoncimeve, subjektit iu kërkuan shpjegime për 14 prej tyre, si vijon:

76. Denoncim i shtetasit V.Q¹³⁵

76.1 Ky shtetas ankohet për zvarritje të hetimit përreth 2 vjet, lidhur me çështjen penale nr. **, viti 2017, në ngarkim të shtetasve Ll.Zh dhe Th.K, të akuzuar për veprat penale “Mashtrimi” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 143 dhe 186/1 të Kodit Penal, si dhe për zgjatjen e afatit të hetimit për arsye të papranueshme për shkak të kërkesës së të pandehurve që të njihen me materialet e çështjes në ngarkim të tyre dhe për të paraqitur prova të reja.

76.2 Çështja penale konsiston në një kallëzim penal të kryer nga shtetasi V.Q në datën 31.1.2017, ndaj shtetasit Ll.Zh, me të cilin ka realizuar disa marrëveshje për ndërtimin e një banese shumëkatëshe në Sarandë. Kallëzuesi, njëkohësisht edhe viktimi e veprës penale, ka pretenduar se përmes falsifikimit të akteve noteriale (kontrata porosie për shitje apartamentesh), të redaktuara nga noteri Th.K, kanë përvetësuar shuma të konsiderueshme nga vlerat e shitjes së këtyre pasurive.

76.3 Nga verifikimi i dosjes penale ka rezultuar se:

- Subjekti ka disponuar disa herë me vendime për zgjatjen e afateve, duke mos dhënë argument specifik mbi arsyet e zgjatjes së afatit.
- Subjekti u ka dhënë të drejtën të pandehurve për të paraqitur memorie apo dokumente shtesë etj., bazuar në nenin 327/4 të Kodit të Procedurës Penale, pa kryer më parë njoftimin e palëve për përfundimin e hetimeve paraprake, bazuar në nenin 327/2 të Kodit të Procedurës Penale.

¹³⁵ Denoncim nr. *** prot., datë 17.9.2018.

- ✓ Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

76.4 Subjekti në prapësime ka shpjeguar se kjo çështje penale është ende në fazën e gjykimit pranë Gjykatës së Apelit. Në lidhje me vendimet për zgjatjen e afatit të hetimit, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se në kuadër të hetimeve janë kryer veprime të shumta hetimore, janë sekuestruar një numër i konsiderueshëm këqyrjesh dhe sekuestrimesh dokumentacioni, marrja e deklarimeve nga shumë shtetas, një pjesë e të cilëve gjendeshin jashtë territorit shqiptar. Këto veprime hetimore kanë qenë të shtrira në kohë dhe janë zhvilluar në përputhje me dinamikën e hetimit, por që nuk kanë mundur të përfundimin e hetimeve brenda afatit.

76.5 Subjekti ka shpjeguar se në dinamikë të veprimeve hetimore është urdhëruar kryerja e ekspertimit grafik krahasues të nënshkrimeve të kallëzuesit V.Q tek aktet noteriale dhe është pikërisht vonesa e administrimit të këtyre konkluzioneve një nga faktorët që ka passjellë zgjatjen e afatit të hetimit. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se në kushtet kur çështja penale lidhet me veprën penale “Mashtrimi” me pasoja të rënda, vlerësohet si domosdoshmëri identifikimi i vlerave reale që kishte përfituar shtetasi Ll.Zh përmes falsifikimit të akteve noteriale dhe, duke qenë se kjo përllogaritje nuk ishte bërë e mundur të kryhej, pasi një pjesë e shtetasve përfitues të ambienteve të banimit nuk gjendeshin në Shqipëri, ka passjellë zgjatjen e afatit të hetimit përmes vendimit të datës 31.1.2018.

76.6 Subjekti ka shpjeguar se përmes vendimeve të datës 26.6.2018 ka ngritur ndaj shtetasve Ll.Zh dhe Th.K akuzat konkrete¹³⁶, të cilët, pasi ata janë njohur me to, paralelisht kanë paraqitur kërkesa për t’u njohur me të gjitha provat tek të cilat janë bazuar akuzat e ngritura ndaj tyre. Madje kërkesat e tyre janë shoqëruar edhe me kërkesa për marrjen e provave¹³⁷, rrethanë kjo që ka passjellë zgjatjen e afatit të hetimit nëpërmjet vendimit përkatës të datës 2.8.2018. Subjekti prapëson se të gjitha arsyet objektive të cilat nuk mundësonin përfundimin e hetimeve për këtë procedim penal, janë evidentuar tek secili akt procedural, nëpërmjet të cilit është vendosur zgjatja e afatit të hetimit.

76.7 Në lidhje me njoftimin e palëve për përfundimin e hetimeve, subjekti ka shpjeguar se duke i konsideruar veprimet hetimore të plota, në datën 24.9.2018 ka vendosur njoftimin e të pandehurve Ll.Zh dhe Th.K për përfundimin e hetimeve, të cilët, përmes mbrojtësve të zgjedhur prej tyre, kanë depozituar kërkesa pranë organit procedues, të cilat janë pranuar pjesërisht nga organi i akuzës. Subjekti shpjegon se për përfundimin e hetimeve ka njoftuar edhe viktimën e veprës penale V.Q, i cili, nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur prej tij, në datën 2.10.2018 ka depozituar pranë organit procedues kërkesën për marrjen e dokumentacionit të fashikullit hetimor, kërkesë e cila nëpërmjet vendimit të datës 4.10.2018 është pranuar plotësisht, fakt për të cilin viktimën e veprës penale është njoftuar me shkresën nr. **prot., datë 9.10.2018. Në vijim, nëpërmjet kërkesës përkatëse të datës 16.10.2018, subjekti i është drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë për gjykimin e çështjes penale.

Vlerësimi i Komisionit

76.8 Komisioni, në analizë të prapësimeve të subjektit, çmon se shpjegimet e tij lidhur me zgjatjen e afateve hetimore për disa raste kanë qenë për arsye objektive, ndërsa konstaton se

¹³⁶ “Vendim për zgjatjen e afatit të hetimit” datë 2.8.2018, administruar në fashikullin e procedimit penal nr. ** të vitit 2017.

¹³⁷ “Vendim për zgjatjen e afatit të hetimit” datë 2.8.2018, administruar në fashikullin e procedimit penal nr. ** të vitit 2017.

vendimet e disponuara prej tij për zgjatje të afateve hetimore janë të paarsyetuara dhe të pashoqëruara me veprime hetimore shtesë për të përligjur këto vendimmarrje, fakt ky i konfirmuar edhe nga kontrolli gjyqësor, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin e datës 20.9.2018, ndër të tjera, ka urdhëruar organin e akuzës të përfundojë hetimet dhe të njoftojë personat e interesuar për përfundimin e tyre.

76.9 Sa i përket njoftimit të palëve për përfundimin e hetimeve, subjekti ka shpjeguar se e ka kryer këtë veprim procedural në datën 24.9.2018, në respektim të nenit 327/2 të Kodit të Procedurës Penale. Komisioni evidenton se ky akt duhej të ndërmerrej nga subjekti para se gjykata ta konstatonte këtë mangësi procedurale përmes vendimit të datës 20.9.2018, ku nga ana e subjektit janë përfunduar veprimet e mundshme dhe të nevojshme hetimore për të provuar akuzat, por pa njoftuar përfundimin e hetimeve, ka vendosur të vërë në dispozicion aktet e hetimeve paraprake të të pandehurit Th.K. Kjo e drejtë, sipas nenit 327/2, lind vetëm pasi më parë njoftohet përfundimi i hetimeve. Përfundimisht, trupi gjykues çmon se subjekti ka zvarritur pa arsye hetimin e çështjes.

77. Denoncim i shtetasit K.N¹³⁸

77.1 Ky shtetas ankohet për dy prokurorë, midis të cilëve edhe subjekti Ilir Hoxha, duke i akuzuar se përmes vendimit të mosfillimit të çështjes penale i kanë vrarë për të dytën herë djalin e tij. Sipas denoncuesit, djali i tij E.N është vrarë në datën 6.9.2015 nga disa kriminelë, me të cilët ishte lidhur për kultivimin dhe rritjen e lëndës narkotike. Denoncuesi ankohet se prokurori Ilir Hoxha e ka trajtuar çështjen ndryshe nga çfarë ai ka deklaruar, sikur djali i tij E.N ka plagosur veten. Nga verifikimi i kryer evidentohet se kjo çështje është publikuar edhe në median *online*¹³⁹.

- ✓ Në lidhje me këtë çështje penale, subjektit iu kërkuan shpjegime mbi veprimet hetimore të ndërmarra për hetimin e kësaj çështjeje, të mbështetura në dokumentacion provues, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

77.2 Subjekti përmes prapësimeve të tij ka shpjeguar në mënyrë të detajuar rrethanat e çështjes penale, ku shtetasi E.N në mbrëmjen e datës 6.9.2015 ka realizuar një qitje luftarake të pavullnetshme nga arma e zjarrit, që e mbante në dorë, duke goditur këmbën e djathtë dhe, në pamundësi lëvizjeje, ka realizuar edhe disa të shtëna të tjera, për të kërkuar ndihmë nga persona që mund të ndodheshin përreth vendit. Sipas shpjegimeve të subjektit, personi i parë që ka dëgjuar krismat ka qenë shtetasi D.D, i cili ka kontaktuar me të plagosurin dhe, pasi i ka ofruar ndihmë me mjete rrethanore, ka thirrur për ndihmë edhe persona të tjerë që mund të ndodheshin afër. Thirtjet për ndihmë janë dëgjuar edhe nga babai i të plagosurit K.N, i cili ka shkuar tek vendi ku gjendej i biri dhe e ka pyetur se çfarë kishte ndodhur. Në përgjigje, djali i tij i ka thënë se është plagosur vetë me automatik, sepse e kapi nga rripi automatikun dhe u shkreh pa dashje. Më pas e ka shkrehur vetë automatikun me breshëri që ta dëgjonin dhe ta ndihmonin. Pavarësisht ndihmës së dhënë nga të pranishmit, si pasojë e gjakderdhjes nga plaga e marrë, shtetasi E.N ka ndërruar jetë. Subjekti ka shpjeguar se këto deklarime të

¹³⁸ Denoncim nr. *** prot., datë 14.2.2019.

¹³⁹ <https://www.balkanweb.com/tentoi-te-vrase-me-automatik-bashkefshatarin-denohe-me-12-vite-burg-mesuesi-nedelvine/>

dhëna nga shtetasi K.N para oficerit të policisë gjyqësore, menjëherë pas ngjarjes së ndodhur, janë të vetmet deklarime të dhëna prej tij.

77.3 Subjekti ka shpjeguar se, pavarësisht faktit se ngjarja në fjalë ka ndodhur në një territor tepër të thellë, është bërë e mundur këqyrja e vendit të ngjarjes, fiksimi dhe sekuestrimi me cilësinë e provës materiale të armës së zjarrit. Nga analiza e të gjitha provave të grumbulluara ka rezultuar tërësisht e provuar se realizimi i të shtënës luftarake ka ndodhur në kushtet e një pakujdesie të treguar nga vetë shtetasi E.N, çka ka sjellë plagosjen e tij në këmbë, dhe mungesa e ndihmës së parë mjekësore për shkak të vendndodhjes së të dëmtuarit ka sjellë në mënyrë të pashmangshme ndërrimin e jetës të këtij shtetasi.

77.4 Subjekti ka prapësuar se rrethanat e evidentuara sa më sipër, provat e grumbulluara, konkluzioni i ekspertimit mjekoligjor të viktimës, si dhe tërësia e deklarimeve të shtetasve që kanë dijeni për ngjarjen, e provojnë këtë përfundim. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 290/1/ç të Kodit të Procedurës Penale, në datën 4.11.2015 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Subjekti ka prapësuar se ky vendim i është njoftuar shtetasit K.N, i cili në asnjë moment nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit në fjalë.

Vlerësimi i Komisionit

77.5 Subjekti në prapësimet e tij ka shpjeguar bindshëm arsyet për të cilat ka disponuar me vendim për mosfillimin e procedimit penal, bazuar mbi faktet dhe rrethanat e çështjes penale, si dhe provat e administruara gjatë hetimit. Komisioni vlerëson se pretendimet e parashtruara nga ankuesi lidhen kryesisht me çmuarjen e provave nga prokurori, e cila i përket themelit të çështjes dhe është objekt shqyrtimi nga gjykatat më të larta.

77.6 Për rrjedhojë, në vlerësimin final lidhur me këtë çështje, trupit gjykues nuk i rezultuan *indicie* apo rrethana për fakte konkrete, të cilat të krijonin bindjen se subjekti ka kryer shkelje ligjore në veprimtarinë e tij, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

78. Denoncime nga shtetasi S.D¹⁴⁰

78.1 Denoncuesi referon dy çështje penale të hetuara nga prokurori Ilir Hoxha, ku ankohet për shkelje të procedurës penale, pasi prokurori ka pushuar çështjen pa kryer një ekspertim lidhur me ndotjen e ujit të pijshëm nga Ujësjellës-Kanalizime Sarandë. Sipas ankuesit, ky vendim është ankimuar prej tij në gjykatë, e cila e ka pranuar të drejtë ankimin e tij. Ndërsa çështja tjetër penale konsiston në një kallëzim penal të kryer nga denoncuesi ndaj Bashkisë Sarandë, sipërmarrësit A.C, ISSH-së dhe Ujësjellës-Kanalizime Sarandë për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, lidhur me konsumimin e ujit të papijshëm në banesën e tij. Për këtë çështje denoncuesi ankohet se prokurori Ilir Hoxha nuk e ka marrë në pyetje dhe nuk i ka dhënë informacion për ecurinë e çështjes.

78.2 Nga verifikimi i dosjeve përkatëse penale¹⁴¹ ka rezultuar se:

- Lidhur me materialin kallëzues nr. ***, datë 19.12.2018, subjekti ka konkluduar me vendim për mosfillimin e procedimit, duke mos kryer veprime hetimore në drejtim të verifikimit nëse nga ana e punonjësve të inspektoratit sanitar janë kryer kontrole në depozitat e ujit apo nëse janë marrë masa për ndalimin e konsumit të ujit. Gjithashtu, nga

¹⁴⁰ Denoncim nr. *** prot., datë 5.6.2019; denoncim nr. ***prot., datë 25.3.2019.

¹⁴¹ Dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me shkresën nr. ** prot., datë 2.11.2023.

dosja penale nuk evidentohen akte lidhur me regjistrimin e procedimit penal, ecurinë e hetimit, si dhe veprimet hetimore të kryera në zbatim të vendimeve gjyqësore.

- Lidhur me materialin kallëzues nr. ***, datë 20.11.2018, nga aktet në dosjen penale nuk evidentohet akti i njoftimit të vendimit të mosfillimit kallëzuesit, bazuar në nenin 291/2 të Kodit të Procedurës Penale.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

78.3 Lidhur me *materialin kallëzues nr. ***, datë 19.12.2018* dhe konstatimin e Komisionit për moskryerje të veprimeve hetimore, subjekti në prapësime ka parashtruar në mënyrë të detajuar faktet dhe rrethanat e çështjes ku, ndër të tjera, ka shpjeguar se nisur nga fakti se inspektimi i cilësisë së ujit është objekt i veprimtarisë së inspektimit sanitar, është kompetencë e këtij inspektorati që të marrë masa konkrete për të ndaluar konsumin e ujit të pijshëm për shkak të ndotjes, pra mbetet brenda kufijve të një mase administrative. Për sa i përket problematikës së parashtruar nga ankuesi S.D për gjendjen e cisternës së përbashkët të pallatit, subjekti ka argumentuar se në referim të ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, teksa cisterna e depozitës së ujit të pallatit është pronësi e përbashkët e të gjithë banorëve të pallatit, mirëmbajtja e saj është detyrë e administratorit dhe/apo asamblesë së bashkëpronarëve.

78.4 Subjekti ka shpjeguar se, bazuar në këtë analizë dhe vlerësim, ka krijuar bindjen se fakti i ndodhur nuk përmban elementet e figurës së ndonjë vepre penale, për rrjedhojë, në bazë të nenit 290/1/ç të Kodit të Procedurës Penale, në datën 27.12.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Shfuqizimin e këtij vendimi nga gjykata subjekti e konsideron një arsyetim të gabuar të kryer nga ana e gjykatës, që e ka çuar në një vendimmarrje të gabuar dhe në kundërshtim të plotë me provat e administruara jo vetëm në fazën e verifikimit të materialit kallëzues, por edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të ankimit ndaj vendimmarrjes së prokurorit. Sipas subjektit, gjykata e rrethit gjyqësor ka gabuar teksa arsyeton se “*nëse kjo shkelje është me pasoja të rënda për shëndetin e njerëzve, prokurori nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, por ka arritur në një konkluzion të tillë me deduksion, duke arsyetuar se përderisa nuk ka një kallëzim nga inspektorët sanitarë...*”, duke anashkaluar faktin se kompetenca për të përcaktuar ekzistencën e një shkeljeje administrative (sikurse ka ndodhur në rastin konkret), dhe, në vijim, marrjen e një mase ndëshkuese administrative e ka vetëm organi kompetent, që në këtë rast përfaqësohet nga inspektorati sanitar.

78.5 Sipas subjektit, është detyrë e gjykatës që kur merr një vendim për prishjen e një vendimi mosfillimi të procedimit penal, në të cilin prokurori ka arsyetuar se *bazuar në këtë analizë dhe vlerësim krijohet bindja se fakti i ndodhur nuk përmban elementet e figurës së ndonjë vepre penale*, të përcaktojë se cilat elemente të figurës së veprës penale ka konstatuar ajo dhe se për cilën vepër penale duhet të regjistrohet në vijim procedimi penal. Sipas subjektit, ky mospërcaktim i gjykatës dëshmon konfuzionin e saj në vendimmarrje, duke nënkuptuar që ky vendim është marrë nën trysinë e ankuesit dhe jo mbi bazën e analizës në mënyrë objektive të faktit, provave dhe kuadrit ligjor. Përmes prapësimeve të datës 10.1.2024 subjekti ka depozituar kopjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, datë 1.10.2019, e cila ka lënë në fuqi vendimin datë 28.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

78.6 Në lidhje me moskryerjen e veprimeve hetimore, subjekti referon një vendim unifikues penal nr. 2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke shpjeguar se është bazuar në përcaktimet¹⁴² e këtij vendimi, por edhe në të gjithë praktikën e deritanishme mbi verifikimin e rrethanave të parashikuara në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale, ka vlerësuar në mënyrë objektive të gjitha provat që kallëzuesi ka vënë në dispozicion se bashku me kallëzimin të cilat, pasi i ka ballafaquar me kuadrin ligjor në fuqi, e kanë çuar në përfundimin se fakti i ndodhur nuk përmban elemente përbërëse të ndonjë vepre penale, duke marrë kështu vendimin për mosfillimin e procedimit penal.

78.7 Sa i përket *materialit kallëzues nr. ***, datë 20.11.2018*, lidhur me mungesën e aktit të njoftimit të vendimit të mosfillimit kallëzuesit S.D, subjekti ka shpjeguar se ashtu si në çdo akt procedural, vendimi i tij i datës 3.12.2018 për mosfillimin e procedimit penal, në pikat 2 dhe 3 citon njoftimin menjëherë të kallëzuesit, viktimës së veprës penale ose trashëgimtarëve të tij, bazuar në nenin 291/2 të Kodit të Procedurës Penale, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit, si dhe për ekzekutimin e urdhërimit ngarkohet zyra e sekretarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Ndaj, subjekti vlerëson se realizimi i njoftimit të palëve për këtë vendim është detyrë vetëm e administratës së organit të Prokurorisë, së cilës i është ngarkuar kjo detyrë jo vetëm nga kjo vendimmarrje, por edhe nga rregullorja e brendshme e institucionit të Prokurorisë.

Vlerësimi i Komisionit

78.8 Komisioni, pas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe referuar vendimeve gjyqësore në të dyja shkallët e gjyqësorit, vëren se ka rezultuar një veprimtari e pamjaftueshme hetimore nga ana e subjektit në materialin kallëzues nr. ***, datë 19.12.2018, për të verifikuar pretendimet e kallëzuesit. Kjo pamjaftueshmëri konfirmohet edhe nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër, e cila përmes vendimit datë 1.10.2019 ka evidentuar se nga ana e organit të akuzës nuk janë zhvilluar veprimet e duhura për hetimin e vërtetësisë ose jo të faktit të kallëzuar nga shtetasi S.D. Këto veprime hetimore dukshëm janë veprimet hetimore bazë që kryhen nga prokurori në trajtimin dhe verifikimin e një kallëzimi penal. Gjithashtu, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka dhënë shpjegime mbi ecurinë e këtij procedimi penal pas vendimit të Gjykatës së Apelit dhe se cilat janë veprimet procedurale të ndërmarra prej tij në funksion të zbardhjes së çështjes.

78.9 Lidhur me prapësimin e subjektit se ka vepruar në zbatim të vendimit unifikues nr. 2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Komisioni çmon se pavarësisht se në përmbajtje të këtij vendimi unifikues është arritur në konkluzionin se rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thelluar, një konkluzion i tillë nuk përjashton organin e akuzës nga detyrimi për kryerjen e veprimeve hetimore me qëllim verifikimin e pretendimeve të ngritura nga kallëzuesi për kryerjen e një vepre penale, atëherë kur nga përmbajtja e fakteve objekt kallëzimi nuk rezulton në mënyrë të qartë dhe pa ekuivoqe ekzistenca e rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal sipas përmbajtjes së nenit

¹⁴² “Procedimi penal merr shkas nga njoftimi që merr prokurori kryesisht apo nga policia gjyqësore, por edhe nga kallëzimi i shtetasve apo personave juridikë për ngjarjen e një vepre penale. Prokurori regjistron procedimin penal fillimisht për veprën që ai ka marrë njoftim se është kryer e, sipas rastit, edhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale. Është pikërisht ky momenti që prokurori ka mundësi të verifikojë nëse ndodhemi para rasteve të parashikuara prej nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, pra nëse ndodhemi përpara rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal dhe që legjitimojnë marrjen e vendimit mbi mosfillimin e procedimit penal... Rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë, mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi”.

290 të Kodit të Procedurës Penale. Arsyetimi i subjektit se inspektimi i cilësisë së ujit është objekt i veprimtarisë së inspektoratit sanitar, konfirmon më tej mungesën e angazhimit të subjektit në drejtim të vlerësimit të çështjes dhe të kryerjes së detyrave të tij si prokuror. Lidhur me këtë çështje penale, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e çështjes penale, që ka nisur mbi bazën e kallëzimit të paraqitur prej këtij denoncuesi, të cilat janë konfirmuar edhe nga kontrolli gjyqësor.

78.10 Sa i përket materialit kallëzues nr. ***, datë 20.11.2018, trupi gjykues, pas verifikimit të vendimit të mosfillimit të hetimeve të datës 3.12.2018, konstaton se në pjesën urdhëruese të këtij akti prokurori është shprehur: “2. Bazuar në nenin 291/2 të Kodit të Procedurës Penale, të njoftojë menjëherë me këtë vendim personat që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimën e veprës penale ose trashëgimtarin/ët e saj të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit. 3. Për ekzekutimin e urdhërimit në pikën nr. 2 të këtij vendimi ngarkohet zyra e sekretarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë”.

78.11 Komisioni konstaton se subjekti nuk provoi që ky vendim t’u jetë njoftuar personave të interesuar, në këtë rast kallëzuesit. Trupi gjykues sjell në vëmendje se në dispozitat procedurale penale, neni 134 i Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se njoftimi i akteve të prokurorit kryhet nga policia gjyqësore dhe sekretaria, por është detyrë e prokurorit të ndjekë zbatimin e urdhërimit për njoftimin e palëve, si dhe të orientojë për kryerjen e veprimeve të nevojshme. Në rastin konkret, shpjegimi i subjektit se sekretaria gjyqësore kishte detyrimin të njoftonte vendimin dhe jo prokurori, vlerësohet prej trupit gjykues pa relevancë. Për pasojë, pretendimi se kjo detyrë i takonte sekretarisë gjyqësore dhe jo subjektit të rivlerësimit, u konsiderua i pambështetur në ligj. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se për këtë procedim penal subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e shkeljes së nenit 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, pasi njoftimi i vendimmarrjes së prokurorit, si veprimtari e rëndësishme e procedurave hetimore, duket se është cenuar.

79. Denoncime nga shtetasi V.P¹⁴³

79.1 Ky shtetas ka referuar dy çështje penale të hetuara nga prokurori Ilir Hoxha të shtetasve A.M dhe R.M, për veprat penale “Shkatërrimi i pronës” dhe “Pushtimi i tokës shtetërore”, ku denoncuesi pretendon për mosveprim të qëllimshëm nga ana e subjektit, duke konstatuar zvarritjen e procesit hetimor, ndërkohë që këta shtetas vazhdojnë të kryejnë ndërtim pa leje mbi pronën shtetërore të banorëve të fshatit Nivicë. Ndërsa çështja e dytë konsiston në një kallëzim tjetër penal të kryer nga denoncuesi në datën 17.9.2019 kundër shtetasit A.S, me detyrë përmbarues gjyqësor, me akuzën “Shpërdorimi i detyrës”. Denoncuesi pretendon për zvarritje të këtij procesi hetimor.

- ✓ Në lidhje me pretendimet e denoncuesit për zvarritje të procesit hetimor, subjektit iu kërkuan shpjegime dhe dokumentacion mbështetës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁴³ (1) Denoncim nr. ** prot., datë 7.1.2020; (2) denoncim nr. ** prot., datë 8.1.2020, i adresuar nga Komisioneri Publik; (3) denoncim nr. *** prot., datë 10.1.2020, i adresuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit; (4) denoncim nr. *** prot., datë 9.3.2021; (5) denoncim nr. *** prot., datë 14.5.2019; (6) denoncim nr. *** prot., datë 15.11.2019, i adresuar nga AKSIK-ja; (7) denoncim nr. ** prot., datë 10.12.2019; (8) denoncim nr. * prot., datë 11.11.2020, i adresuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

79.2 Në prapësime, subjekti ka sqaruar se për çështjet e referuara nga denoncuesi, konkretisht procedimet penale nr. ***/2018 dhe nr. ***/ 2019, ka dhënë dorëheqjen në fazën e hetimit.

79.3 *Lidhur me procedimin penal nr. ***/2018*, subjekti ka shpjeguar se nga studimi i materialit kallëzues, ku pretendohet se shtetasit A.M, përmes gërmimeve dhe rrethimit të truallit shtetëror, ka shkatërruar mjedisin, subjekti ka vlerësuar se ndodhej para veprës penale “Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera”, parashikuar nga neni 154/1 i Kodit Penal, ndaj në datën 5.10.2018 ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2018, si dhe ka deleguar kryerjen e veprimeve hetimore tek oficeri i policisë gjyqësore, duke urdhëruar: (i) këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe territori ku gjendet hotel “M”, me qëllim evidentimin e gjurmëve të punimeve të pretenduara në deklaratimet e kallëzuesit; (ii) caktimin e ekspertit për kryerjen e ekspertimit teknik, me qëllim përcaktimin nëse nga ajo çka është konstatuar në terren përbën “shkatërrim apo dëmtim të pronës”; (iii) administrimin e informacionit nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Sarandë, në lidhje me inspektimet e mundshme të kryera nga ana e inspektorëve dhe të administrohen tabulatet e komunikimeve telefonike; (iv) marrjen e deklaratimeve shtetasit A.M, si dhe të çdo shtetasi që ka dijeni për rrethana të hetimit.

79.4 *Lidhur me procedimin penal nr. **/2019*, subjekti ka shpjeguar se nga studimi i materialit kallëzues ka rezultuar se vëllezërit M kanë në posedim hotelin “M” dhe nga informacioni i ardhur, në krah të hotelit, në plazh, në një territor të mbjellë me ullinj, kishte gërmuar dhe ndërtuar një mur mbajtës shtetasi B.M. Me qëllim verifikimin e këtij informacioni, oficeri i policisë gjyqësore ka kryer këqyrjen e vendit të ngjarjes, ku ka konstatuar gërmim dhe ndërtim të një muri mbajtës. Referuar këtyre fakteve, subjekti ka vlerësuar se ndodhej para veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, kryer në tokë të vet, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, ndaj, në datën 28.3.2019, ka regjistruar procedimin penal nr. **, viti 2019, si dhe ka deleguar veprimet hetimore tek oficeri i policisë gjyqësore, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve si: (i) administrimi i çdo dokumentacioni që disponon përfaqësuesi i subjektit “Hotel M” në lidhje me punimet e konstatuara në terren nga oficeri i policisë gjyqësore, ashtu edhe nga inspektorët e IMT-së pranë Bashkisë Sarandë; (ii) këqyrja e objektit me qëllim evidentimin në mënyrë të saktë dhe të plotë të punimeve, veprim i cili duhet të realizohet në prani të ekspertit kriminalist dhe të dy ekspertëve teknikë ndërtimorë, si dhe të dokumentohet nëpërmjet hartimit të procesverbalit përkatës dhe të shoqërohet edhe me fotografime kriminalistike; (iii) të merren deklaratime nga inspektorët e IMT-së pranë Bashkisë Sarandë, përfaqësuesi i subjektit “Hotel M”, si dhe çdo shtetas tjetër që ka dijeni për rrethana të hetimit.

79.5 Subjekti pretendon se denoncuesi nuk kishte asnjë pozitë procedurale në këtë procedim penal dhe ky shtetas ka parashtruar fakte të paqena në dëm të tij, duke shpifur. Ndaj, në cilësinë e viktimës akuzuese, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke kërkuar deklarinim fajtor për veprën penale “Shpifje” dhe gjykata, me vendimin datë 30.9.2020, ndër të tjera, ka vendosur deklarinim fajtor të të akuzuarit V.P për kundërvajtjen penale “Shpifje” dhe dënimin e tij me gjobë. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër, datë 9.3.2021.

Subjekti ka sqaruar se pas ankimit të tij si viktimë akuzuese ka hequr dorë nga hetimi i mëtejshëm i këtyre procedimeve penale, si dhe nga marrja në shqyrtim e çdo materiali

kallëzues ku ky shtetas ishte kallëzues, duke shmangur kështu gjendjen e konfliktit të interesit.

79.6 Lidhur me çështjen penale ndaj përmbaruesit A.S, subjekti ka shpjeguar se në kushtet e ekzistencës së konfliktit të interesit me ankuesin V.P, në datën 24.9.2019 ka dhënë dorëheqjen nga verifikimi i materialit kallëzues nr. ***/2019, por, pavarësisht këtij fakti, ky shtetas ka kryer ankim para Komisionit, por edhe kallëzim penal ndaj tij, për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në datën 23.11.2020, ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal. Subjekti prapëson se pretendimet e ankuesit për zvarritje të procesit hetimor nuk kanë asnjë bazë reale. Subjekti ka paraqitur si dokumentacion provues kopje të:

- vendimit nr. ***, datë 9.3.2021, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, ku shtetasi V.P deklarohet fajtor;
- vendimit datë 23.11.2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila ka vendosur mosfillimin e procedimit penal ndaj tij;
- *email*-it datë 5.1.2024, ku konfirmohet se këto dy procedime penale, respektivisht nr. ***/2018 dhe nr. ***/2019, rezultojnë me status “nën hetim”.

Vlerësim i Komisionit

79.7 Komisioni vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti në prapësime, si dhe arsyet e heqjes dorë nga hetimi i çështjeve me këtë denoncues, duke i konsideruar ato bindëse, nisur edhe nga fakti që me vendim gjyqësor denoncuesi është deklaruar fajtor për veprën penale “Shpifje”. Në përfundim, trupi gjykues çmon se në këtë rast nuk u provuan pretendimet e denoncuesit.

80. Denoncim i shtetasit A.B¹⁴⁴

80.1 Ky shtetas ankohet për prokurorin Ilir Hoxha, me pretendimin se gjatë hetimit të çështjes penale, të regjistruar në vitin 2017 në ngarkim të shtetasit S.B, nuk kishte kryer asnjë veprim hetimor, në zbatim të detyrave të përcaktuara qartazi nga gjykata. Sipas denoncuesit, prokurori Ilir Hoxha nuk ka hetuar çështjen për veprën penale “Vrasje”, por për “Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, pasi babai i tyre është vrarë jashtë rrugës automobilistike nga drejtuesi i mjetit, i cili ka qenë duke shkarkuar inertet dhe nuk ka ndaluar, por është larguar.

80.2 Nga verifikimi i dosjes penale¹⁴⁵ ka rezultuar se në datën 25.2.2017 është regjistruar procedimi penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit S.B, për veprën penale “Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, lidhur me një ngjarje të ndodhur në datën 24.2.2017, në fshatin Qesarat, ku është gjetur i vdekur shtetasi N.B, pasi ishte shtypur nga një mjet i tonazhit të rëndë, që drejtohej nga shtetasi S.B.

Kjo çështje penale është hetuar fillimisht nga një prokuror tjetër, i cili ka kërkuar dy herë pushimin e çështjes, por nuk është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila herën e dytë me vendimin datë 14.6.2019 ka urdhëruar kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve. Nga aktet në dosje nuk evidentohet momenti se kur kjo çështje i ka kaluar për

¹⁴⁴ Denoncim nr. *** prot., datë 7.8.2022.

¹⁴⁵ Dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2023.

hetim prokurorit Ilir Hoxha. Në përfundim të hetimit, subjekti ka kërkuar pushimin e procedimit, kërkesë e cila sërish nuk është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin gjyqësor të datës 17.2.2021, e cila ka urdhëruar prokurorin të plotësojë hetimet brenda 5 muajsh, duke caktuar si datë për seancën e ardhshme gjyqësore datën 21.7.2021. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, në datën 25.5.2022. Nga aktet evidentohet se subjekti, në përfundim të hetimit, në datën 18.9.2023 ka kërkuar sërish në gjykatë pushimin e çështjes.

80.3 Nga verifikimi i dosjes penale ka rezultuar se:

- Subjekti nuk ka zbatuar urdhërimet e gjykatës sipas vendimit datë 17.2.2021 për kryerjen e veprimeve hetimore në një afat të arsyeshëm (brenda 5 muajve). Kjo çështje ka qenë nën hetim për gati 4 vjet (3 vjet e rreth 10 muaj) dhe nuk evidentohen veprime hetimore të kryera nga subjekti, përveç riekspertimit autoteknik të urdhëruar në prill të vitit 2023.
- ✓ Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti iu kërkuar shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

80.4 Subjekti përmes prapësimeve të tij ka shpjeguar se kjo çështje penale ndodhet për shqyrtim pranë gjyqtarit të seancës paraprake. Subjekti ka shpjeguar në mënyrë të detajuar ecurinë e çështjes penale, hetuar fillimisht nga prokurorë të tjerë, të cilët në përfundim të hetimeve kishin vendosur dy herë pushimin e hetimeve. Konkretisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, përmes vendimit datë 14.6.2019, ndër të tjera, kishte vendosur kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve brenda 3 muajve nga e nesërmeja e komunikimit të vendimit të arsyetuar, duke lënë si detyrë kryerjen e një eksperimenti hetimor në prezencë të një grupi ekspertësh autoteknikë. Subjekti thekson se ky është momenti ku ai ka marrë çështjen për kryerjen e hetimeve të mëtejshme, pasi prokurori i mëparshëm kishte dhënë dorëheqjen nga hetimi i çështjes.

80.5 Subjekti ka shpjeguar se me marrjen e dosjes, përmes vendimit datë 19.11.2019 ka urdhëruar kryerjen e eksperimentit hetimor me qëllim përcaktimin me saktësi të rrethanave të ngjarjes, ku ekspertët, përmes procesverbalit të mbajtur në datën 24.12.2019, kanë konkluduar se eksperimenti hetimor ka qenë absolutisht i pamundur të realizohet, për shkak të transformimit të vendit ku ka ndodhur ngjarja. Për rrjedhojë, ka urdhëruar kryerjen e riekspertimit autoteknik, ku ekspertët, me aktin e datës 20.1.2020, kanë konkluduar se shkaku përcaktues për ndodhjen e aksidentit rrugor dhe ardhjen e pasojës së rëndë është shkelja e konsumuar nga ana e këmbësorit N.B, konkluzion ky që ka qenë në përputhje edhe me konkluzionet e ekspertimeve autoteknike të kryera më parë.

80.6 Subjekti ka shpjeguar se ky akt riekspertimi i është vënë në dispozicion gjyqtarit të seancës paraprake, i cili, në seancën gjyqësore të zhvilluar në datën 19.2.2020, ka vlerësuar se ekspertimi i kryer nuk përmbush të gjitha kërkesat e gjykatës dhe ka kërkuar që të plotësohet ky akt ekspertimi sipas detyrave të përcaktuara prej saj. Ndaj, subjekti, përmes vendimit të datës 24.2.2020, ka vendosur plotësimin e aktit të riekspertimit autoteknik, duke iu dhënë përgjigje pyetjeve lidhur me dinamikën e lëvizjes së automjetit bazuar tek aktet, provat dhe fotografitë kriminalistike të këqyrjes së vendit të ngjarjes. Nga akti i ekspertimit të datës 12.5.2020 është konkluduar se kemi të bëjmë me një aksident rrugor, pasi këmbësori ka lëvizur në vendet ku ka qenë i padukshëm për drejtuesin e mjetit. Subjekti ka shpjeguar

se, paralelisht me sa më sipër, në kuadër të zbatimit të detyrave të lëna nga gjykata, janë marrë deklaratimet e shtetasve të ndryshëm, nga të cilat nuk është përfutur asnjë e dhënë e dobishme për ecurinë e çështjes.

80.7 Sipas shpjegimeve të subjektit, të gjitha faktet dhe provat e administruara iu paraqitën gjyqtarit të seancës paraprake, i cili, përmes vendimit të datës 17.2.2021, ndër të tjera, ka vendosur sërish të urdhërojë prokurorin të plotësojë hetimet brenda një afati prej 5 muajsh, vendim ky që, pas ankimit të prokurorit, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër, në datën 25.5.2022. Subjekti sqaron se ky vendim është vënë në dispozicion të prokurorit nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 22.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ku nga studimi i fashikullit të procedimit penal rezultoi se ishte i mangët, pasi nuk i ishin vënë në dispozicion aktet shkresore dhe provat që ai i kishte paraqitur gjyqtarit të seancës paraprake, të cilat ishin të domosdoshme për ecurinë e mëtejshme të çështjes. Duke qëndruar në pritje të këtyre provave, për të cilat i ishte konfirmuar se kishte ndodhur për shkak të një gabimi njerëzor nga ana e sekretarisë gjyqësore, i është drejtuar me shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila i ka vënë në dispozicion këto prova. Subjekti nuk është në gjendje të specifikojë ekzaktësisht shkresën e prokurorisë apo të gjykatës, por mund të kenë qenë ditët e para të muajit mars 2023.

80.8 Subjekti ka shpjeguar se, pas marrjes së dosjes së plotë, ka hasur vështirësi në gjetjen e ekspertëve autoteknikë, kjo për faktin se në rastin konkret ishin realizuar më parë edhe 4 ekspertime të tjera, ku një pjesë e tyre kishin parashtruar shkaqe përjashtimi nga përmbushja e detyrës. Gjithashtu, një vështirësi në sigurimin e ekspertëve përbënte edhe fakti se ata kishin kërkesa për shpërblimin e punës në vlera të larta, jo të zakonit për organin e hetimit. Në vijim, subjekti ka mundur të kontaktojë me ekspertët, anëtarë të shoqatës “Byroja Inxhinierike e Ekspertëve Profesionistë të Sigurisë Rrugore dhe Aksidenteve”. Kështu, në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata, e cila, ndër të tjera, kishte urdhëruar kryerjen e një eksperimenti hetimor, subjekti, nëpërmjet vendimit datë 6.4.2023, ka urdhëruar kryerjen e riexpertimit autoteknik, për të përcaktuar me saktësi nëse ishte e mundur të realizohej eksperimenti hetimor, bazuar në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes datë 24.2.2017 dhe tabelën fotografike, si dhe të përcaktoheshin rrethanat e ndodhjes së ngjarjes. Pasi është realizuar kryerja e eksperimentit hetimor në datën 3.7.2023, si dhe referuar aktit të riexpertimit autoteknik të datës 20.7.2023, ekspertët kanë konkluduar se nuk mund të provohet shkencërisht se nga ka ardhur dhe çfarë trajektore ka ndjekur këmbësori në raport me mjetin dhe shkaku determinant teknik i ndodhjes së aksidentit është qarkullimi i këmbësorit në zonën e verbër për drejtuesin e mjetit, veprim i cili ka shkaktuar edhe aksidentin. Bazuar në konkluzionet e aktit të riexpertimit, subjekti në datën 18.9.2023 i është drejtuar gjykatës, me kërkesën për pushimin e çështjes.

80.9 Subjekti ka prapësuar se të gjitha veprimet hetimore dhe procedurale për hetimin e çështjes janë kryer në mënyrë ritmike, në përputhje me dinamikën e hetimit, si dhe në respektim të vendimeve gjyqësore. Subjekti ka paraqitur *email*-in datë 5.1.2024, ku konfirmohet se çështja penale nr. ***, viti 2017, rezulton procedim penal në hetim.

Vlerësimi i Komisionit

80.10 Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se kjo çështje penale nuk është hetuar që në fillim prej tij, por ka marrë dosjen për hetime të mëtejshme pas vendimit gjyqësor të datës 14.6.2019, e cila kishte urdhëruar vazhdimin e hetimeve brenda 3 muajve nga e nesërmja e

komunikimit të vendimit të arsyetuar. Nisur nga shpjegimet e subjektit, Komisioni konstaton mangësi dhe zvarritje të veprimeve hetimore nga momenti i dhënies së vendimit gjyqësor datë 14.6.2019 deri më 19.2.2020, kur gjykata është shprehur për plotësimin e aktit të ekspertimit e, më pas, nga ky moment deri në datën 17.2.2021, ku sërish gjykata është shprehur për plotësimin e hetimeve brenda afatit 5-mujor.

80.11 Lidhur me afatin 5-mujor të përcaktuar nga gjykata për kryerjen e hetimeve, Komisioni vlerëson se edhe nëse konsiderohet fakti se dosja është marrë nga subjekti në dhjetor të vitit 2022, sërish evidentohen vonesa në kryerjen e veprimeve hetimore prej 9 muajsh nga data 22.12.2022 deri më 18.9.2023, kur subjekti ka kërkuar sërish pushimin e çështjes.

80.12 Në përfundim, Komisioni evidenton zvarritje dhe mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, të konfirmuara edhe nga kontrolli gjyqësor, që e ka urdhëruar dy herë prokurorin për plotësim të hetimeve.

81. Denoncim i shtetasit M.A¹⁴⁶

81.1 Ky shtetas ankohet për prokurorin Ilir Hoxha lidhur me një kallëzim penal të kryer prej tij në datën 21.10.2019 ndaj shtetases V.T, punonjëse e ASHK-së Sarandë, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Çështja penale konsiston në kryerjen e disa veprimeve nga ana e punonjësve të ish-ZVRPP-së, të cilët nuk kanë regjistruar një dëshmi trashëgimie, por kanë ekzekutuar një testament dhe, për rrjedhojë, në datën 20.11.2018 ky institucion ka lëshuar certifikatat e pronësisë, duke tjetërsuar pasurinë.

81.2 Denoncuesi ankohet se prokurori Ilir Hoxha pa hetuar materialin kallëzues ka vendosur mosfillimin e procedimit, vendim i cili është prishur nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, në datën 23.6.2020, duke e urdhëruar kryerjen e hetimeve të nevojshme. Gjithashtu, denoncuesi ankohet se ka kërkuar informacion për ecurinë e hetimit, si dhe i ka paraqitur subjektit kërkesat e datave 29.11.2020, 1.4.2021 dhe 10.5.2021, për të cilat nuk ka marrë asnjë përgjigje dhe nuk është vënë në dijeni për shkaqet e zgjatjes së afateve të hetimit.

- ✓ Në lidhje me pretendimet e denoncuesit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

81.3 Lidhur me këtë çështje penale, subjekti ka shpjeguar se ajo i përket procedimit penal nr. ***, viti 2020, e cila është ende në fazën e hetimit paraprak. Subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e çështjes penale ku, ndër të tjera, ka shpjeguar se nga të dhënat e administruara i ka rezultuar se certifikatat e pronësisë për pasuritë nr. *** dhe nr. *** janë lëshuar në datën 18.11.2018, datë në të cilën në detyrën e regjistruarit të ish-ZVRPP-së Sarandë ka qenë shtetasi A.H, i cili ka ndërruar jetë në datën 26.2.2019. Bazuar në këtë arsyetim, subjekti ka vlerësuar se ekzistenca e kësaj rrethane nuk lejonte fillimin e ndjekjes penale, ndaj në datën 5.11.2019, bazuar në nenin 290/1/a të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kallëzuesi, i cili është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin datë 10.2.2020, por është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, e cila në datën 23.6.2020 ka vendosur shfuqizimin e vendimit për mosfillimin e procedimit penal, detyrimin e organit të Prokurorisë për të regjistruar procedimin penal dhe kryerjen e hetimeve të nevojshme.

¹⁴⁶ Denoncim nr. *** prot., datë 22.10.2021.

81.4 Subjekti ka shpjeguar se, në zbatim të vendimit gjyqësor, në datën 4.11.2020 ka regjistruar procedimin penal nr. ***/ 2020, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, si dhe ka deleguar kryerjen e veprimeve hetimore tek oficeri i policisë gjyqësore, si: administrimi i dokumentacionit arkivor të pasurive; marrja e informacionit nga ASHK Drejtoria Vendore Sarandë në lidhje me personat që kanë qenë në detyrën e regjistruarit në vitin 2017 dhe cilët punonjës janë marrë me trajtimin e praktikës; marrja e deklarimeve nga kallëzuesi, ish-regjistruari i ZVRPP-së Sarandë dhe punonjës të ish-ZVRPP-së Sarandë etj.

81.5 Në lidhje me kërkesat e parashtruara nga ankuesi, subjekti ka shpjeguar se personalisht nuk i ka marrë në dorëzim këto kërkesa, madje as nga oficeri i policisë gjyqësore, të cilit i kishte deleguar kryerjen e veprimeve hetimore, nuk i është referuar parashtrimi i kërkesave të tilla nga kallëzuesi. Rrjedhimisht, për asnjërën prej tyre nuk është shprehur me vendim mbi kërkesën e palës. Subjekti thekson se nuk ka asnjë arsye që të mos japë përgjigje me shkrim ndaj një kërkesë ligjore të parashtruar nga subjektet e procedimit, përfshirë këtu edhe kallëzuesin. Subjekti ka shpjeguar se, nga sa i kujtohet, një apo dy herë është kontaktuar nga kallëzuesi në këmbë, jashtë ambientit të punës dhe jo në zyrë, të cilin e ka orientuar të kontaktojë me oficerin e policisë gjyqësore.

81.6 Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se nuk është vënë në dijeni për shkaqet e zgjatjes së afateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se në asnjë moment procedural vepra penale “Shpërdorimi i detyrës”, për të cilën është regjistruar procedimi penal, nuk i është atribuar ndonjë shtetasi konkret, emri i të cilit të ishte regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 323, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale, subjekti nuk mund dhe nuk ka marrë ndonjë akt procedural për zgjatjen e afatit të hetimit dhe nuk kishte se me çfarë akti të njoftonte kallëzuesin, në kuptim të këtyre dispozitave penale. Subjekti pretendon se kjo çështje është ende në hetim dhe ka paraqitur si provë *email*-in datë 5.1.2024, ku konfirmohet se kjo çështje penale rezulton procedim penal në hetim.

Vlerësimi i Komisionit

81.7 Komisioni çmon se hetimet e kryera nga subjekti nuk kanë qenë shteruese, e konfirmuar kjo edhe nga Gjykata e Apelit Gjjirokastër, e cila me vendimin e datës 23.6.2020, ndër të tjera, ka evidentuar se regjistrimi i pronës është kryer para se të ndërronte jetë regjistruari, i ndjeri A.H dhe, në vijimësi, janë veprimet e punonjësës V.T ato që i kanë shkaktuar dëm ekonomik kallëzuesit, pasi pjesën e tij të tokës në bashkëpronësi të trashëguar nga nëna ia kanë grabitur duke e regjistruar në emër të personave të tjerë. Referuar vendimit gjyqësor ku konstatohet fakti se regjistrimi i pasurive ishte kryer në kundërshtim me ligjin dhe kishte të dhëna për ekzistencën e kryerjes së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, Komisioni çmon se këto veprime duhej të ishin hetuar nga prokurori. Në prapësime, subjekti ka pohuar se kjo çështje penale aktualisht është nën hetim paraprak, fakt i cili konfirmon se çështja është zvarritur për të paktën 3 vjet, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal në datë 4.11.2020 dhe të paktën deri në datën 30.09.2023, kur subjekti është transferuar në një prokurori tjetër.

81.8 Në përfundim, Komisioni evidenton zvarritje në hetimin e çështjes nga ana e subjektit të rivlerësimit, të cilat përbëjnë mangësi profesionale referuar parashikimeve të pikës 2, të nenit 73 të ligjit 96/2016, i ndryshuar.

81.9 Sa i përket shpjegimeve të subjektit se nuk ka pasur dijeni për kërkesat e paraqitura nga denoncuesi, Komisioni i çmon bindëse shpjegimet e tij, po ashtu edhe shpjegimet lidhur me

faktin se nuk ka ndërmarrë asnjë vendim për zgjatje të afateve hetimore sipas parashikimeve të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, për sa kohë për këtë çështje nuk ka pasur ndonjë shtetas që i është atribuar vepra penale dhe regjistruar në regjistrin e veprave penale.

82. Denoncim i shtetasit A.M¹⁴⁷

82.1 Ky shtetas ankohet ndaj vendimit të prokurorit Ilir Hoxha, datë 4.8.2021, për mosfillimin e procedimit penal. Çështja penale konsiston në një kallëzim penal të kryer nga shtetasi M. M (i përfaqësuar me prokurë nga A.M) në ngarkim të shtetasit F.M, për veprat penale “Shkatërrimi i pronës” “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Pushtimi i tokës”. Kallëzuesi pretendon se si pasojë e veprimeve të të kallëzuarit i është cenuar prona e tij në Njësinë Administrative Lukovë, për të cilën është pronar i ligjshëm, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi. Sipas denoncuesit, mbi pronën e tij kallëzuesi ka kryer punë ndërtimi në mënyrë të kundërligjshme dhe vendimi i prokurorit për mosfillim është jashtë çdo dispozite ligjore, duke i cenuar në mënyrë flagrante pronën e tij, në favor të personave të tjerë, për qëllime përfitimi.

- ✓ Në lidhje me pretendimet e denoncuesit, subjektit iu kërkuan shpjegime, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

82.2 Subjekti në prapësimet e tij ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e çështjes penale, ku shtetasi M.M pretendonte se prona e tij ishte cenuar nga veprimet e të kallëzuarit F.M, i cili ka ndërtuar dy tombine, dy mbulesa metalike për parkimin e mjeteve dhe mbjelljen e palmave dekorative, ku objekti i kallëzimit penal kishte të bënte me ekzistencën e veprave penale “Pushtimi i tokës”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal, “Ndërtimi i paligjshëm”, kryer në tokën e tjetrit, parashikuar nga neni 199/a/3 i Kodit Penal, si dhe “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Për secilën nga këto vepra penale subjekti ka analizuar elementet e figurës së veprave penale, duke shpjeguar se vendimmarrja e tij për mosfillimin e procedimit penal ka qenë dhe është produkt vetëm i bindjes së brendshme të krijuar nga analiza e të gjitha provave të administruara dhe, si e tillë, materializohet në aktin përkatës procedural.

82.3 Lidhur me pretendimin e denoncuesit se nuk është vënë në dijeni të vendimit të mosfillimit të procedimit, subjekti ka shpjeguar se në vendimin e tij të datës 9.8.2021, ndër të tjera, ka vendosur të njoftojë me këtë vendim personat që kanë bërë kallëzim, viktimën e veprës penale ose trashëgimtarët e saj dhe për ekzekutimin e këtij urdhri është ngarkuar zyra e sekretarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Subjekti ka argumentuar se parashtrimi i denoncimit pranë Komisionit nga ana e shtetasit A.M në lidhje me vendimmarrjen e tij tregon faktin se kallëzuesi është vënë në dijeni të kësaj vendimmarrjeje.

82.4 Sipas subjektit, ky shtetas ka kryer ankim edhe pranë ILD-së, e cila pasi ka marrë në shqyrtim të gjitha aktet e çështjes, nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 24.7.2023, ka vendosur arkivimin e ankesës, ku provohet se të gjitha veprimet e kryera prej tij janë në zbatim korrekt të të gjitha normave penale dhe proceduralo-penale. Subjekti ka depozituar kopje të vendimit të ILD-së nr. ***, datë 24.7.2023, e cila ka vendosur arkivimin e ankesës.

¹⁴⁷ Denoncim nr. *** prot., datë 17.11.2021.

82.5 Në vijim, përmes prapësimeve të datës 10.1.2024, subjekti ka shpjeguar se vendimi i tij për mosfillimin e procedimit penal është shfuqizuar pjesërisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin datë 9.11.2021, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve vetëm për dy veprat penale, “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Shkatërrimi i pronës”. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, në datën 1.11.2021. Për rrjedhojë, në zbatim të vendimit gjyqësor, në datën 2.3.2023 ka regjistruar procedimin penal nr. **, viti 2023, për veprat penale “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Shkatërrimi i pronës”, të parashikuara nga nenet 199/a/3 dhe 150 të Kodit Penal. Subjekti ka shpjeguar se duke vlerësuar se nga provat e administruara ka rezultuar se fakti penal ka ndodhur në Njësinë Administrative Lukovë, Bashkia Himarë, brenda territorit në të cilin ushtron kompetencat e saj Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në referim të nenit 76 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka vlerësuar që kompetenca tokësore për hetimin e mëtejshëm i përket kësaj Prokurorie. Ndaj, nëpërmjet vendimit të datës 17.3.2023, ka vendosur të shpallë moskompetencën tokësore dhe t’i kalojë aktet e procedimit penal nr. **, viti 2023, Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vlerësimi i Komisionit

82.6 Subjekti në prapësime ka shpjeguar se vendimmarrja e tij është kryer bazuar në bindjen e brendshme, nga analiza e të gjitha provave të administruara dhe e materializuara në aktin përkatës procedural.

82.7 Komisioni vëren se subjekti në vendimin e tij për mosfillimin e procedimit, datë 9.8.2021, ka kryer një analizë të thelluar të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, si dhe ka analizuar elementet e figurës për të tria veprat penale të pretenduara nga kallëzuesi, por në asnjë pikë të vendimit nuk ka cituar veprimet hetimore të kryera me qëllim verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit, nuk ka një analizë të fakteve që ka rezultuar nga provat e mbledhura gjatë hetimit dhe as një analizë të tyre në funksion të përcaktimit të faktit penal. Vendimi i prokurorit për të mos filluar procedimin, me arsyetimin se nuk ka ndërtime, meqenëse nuk janë konstatuar të tilla nga inspektoratet, nuk është i dokumentuar nga subjekti. Gjykatat përmes shfuqizimit të pjesshëm të vendimit të prokurorit dhe urdhërimit për vazhdimin e hetimeve për dy nga veprat penale, “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Shkatërrimi i pronës”, ndër të tjera kanë konstatuar se organi i Prokurorisë duhet të kishte kryer këqyrje të pronës, ku pretendohet se janë kryer ndërtime dhe eventualisht, sipas nevojës, të kryejë një akt ekspertimi, nëse nga këqyrja rezultojnë ndërtime të lidhura në mënyrë të pazgjidshme me tokën dhe përbëjnë ndërtim.

82.8 Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion, i cili provon veprimet hetimore të kryera prej tij për këtë çështje penale. Komisioni konkludon se nga ana e subjektit nuk janë ndërmarrë veprime hetimore verifikuese dhe nuk është hetuar për rrethanat e çështjes, me qëllim verifikimin e kushteve për ekzistencën e veprave penale të pretenduara nga kallëzuesi.

83. Denoncim i shtetasit A.K¹⁴⁸

83.1 Ky shtetas ankohet për prokurorin Ilir Hoxha, pasi gjatë hetimit të çështjes së tij penale ka treguar qëndrim të njëanshëm në favor të të pandehurit dhe në dëm të tij si viktimë e veprës penale. Çështja penale konsiston në një aksident rrugor të ndodhur në datën 19.10.2021, ku denoncuesi, duke qenë me makinë të parkuar në anë të rrugës, është goditur

¹⁴⁸ Denoncim nr. *** prot., datë 25.1.2022.

nga një automjet i drejtuar nga shtetasi L.M dhe, si pasojë e aksidentit, ka humbur një tërësi prej gjymtyrëve.

Denoncuesi pretendon se prokurori ka arritur mbylljen e hetimeve dhe realizimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë pa marrë deklarim apo dëshminë e tij si viktimë e veprës penale. Gjithashtu, denoncuesi ankohet se organi i Prokurorisë ka mbyllur hetimet bazuar në një akt ekspertimi mjekoligjor 1-ditor, i cili nuk pasqyron pasojat e vërteta shëndetësore të shkaktuara nga ky aksident (prerja e këmbës në Turqi), si dhe ka aplikuar nenin 59 të Kodit Penal ndaj të pandehurit, i cili nuk është një person i respektuar, siç e referon prokurori. Kjo çështje gjendet e publikuar¹⁴⁹ edhe në emisionin investigativ “Fiks Fare”.

83.2 Nga verifikimi i dosjes penale ka rezultuar se:

- Prokurori përmes kërkesës për realizimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe pezullimit të ekzekutimit të dënimit në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal (e cila nuk është pranuar nga gjykata), duket se ka lehtësuar pozitën e të pandehurit në procesin penal.
- ✓ Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

83.3 Subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e çështjes, duke saktësuar se kjo çështje është në fazën e gjykimit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Lidhur me pretendimin e denoncuesit se nuk i është marrë deklarim apo dëshmi si viktimë e veprës penale, referuar nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka shpjeguar se ky veprim procedural nuk është kryer nga ana e tij, pasi nga aktet e ekspertimit ka rezultuar e qartë dinamika e ngjarjes dhe provohet fajësia e të pandehurit, si dhe plagosja e rëndë e shkaktuar ndaj viktimës. Për rrjedhojë, ky veprim nuk ka rezultuar detyrimisht i nevojshëm për t’u kryer nga organi i akuzës dhe nuk ka ndikuar aspak në kualifikimin apo dokumentimin e faktit penal.

83.4 Subjekti ka shpjeguar se nga vlerësimi paraprak i rrethanave oficeri i policisë gjyqësore ka kryer arrestimin në flagrancë të shtetasit L.M dhe, në vijim, bazuar në kërkesën e prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin datë 21.10.2021 ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë, duke vendosur si masë sigurimi “Arrest në burg”. Subjekti ka shpjeguar se në datën 7.1.2022 ka vendosur njoftimin e akuzës të pandehurit L.M për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, me pasojë plagosjen e rëndë të shtetasit A.K, si dhe veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, në gjendje të dehur. Sipas subjektit, i pandehuri ka pranuar dhe pohuar fajësinë e tij dhe përmes aktit të datës 28.12.2021 ka propozuar arritjen e marrëveshjes mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimit të dënimit.

83.5 Subjekti ka argumentuar se nisur nga fakti që i pandehuri L.M është akuzuar për veprat penale, të cilat parashikojnë si masë dënimi burgim nga 1 deri në 5 vjet dhe burgim nga 10 ditë deri në 3 vjet dhe në referim të nenit 406/d, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se arritja e marrëveshjes lejohet për veprat penale, për të cilat ligji parashikon një dënim në maksimum jo më shumë se 7 vjet burgim. Gjithashtu, në kushtet kur i pandehuri ka pohuar fajësinë e tij, procedimi penal ndodhej ende në fazën e hetimit paraprak, pra ende

¹⁴⁹ Fiks Fare/prokurori Hoxha: “Dëshmia s’më duhej, nëse vdiste, do e dokumentoja”, YouTube.

nuk kishte filluar shqyrtimi gjyqësor, pas bisedimeve të zhvilluara ranë dakord mbi marrëveshjen mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe për caktimin e dënimit.

83.6 Lidhur me aplikimin e dënimit alternativ, subjekti ka vlerësuar se dënimi me burgim duhet të merret në konsideratë si njëri prej opsioneve të dënimit që duhet të akordohet ndaj shkelësve të ligjit që paraqesin risk të lartë për të rikryer krime serioze, ndërsa për ata shkelës të ligjit që paraqesin një rrezikshmëri të ulët, vlerëson se duhet të aplikohen sanksione penale të një natyre të ndryshme nga dënimi me burgim. Sipas subjektit, një konkluzion i tillë referohet edhe tek rekomandimet dhe rezolutat e Këshillit të Europës, që në tërësinë e tyre kanë inkurajuar dhe nxitur përdorimin e alternativave të dënimit me burgim, duke i vlerësuar këto të fundit se kanë një rol të rëndësishëm në riedukimin dhe riintegrimin e të dënuarve.

83.7 Subjekti ka shpjeguar se për një aplikim sa më të drejtë dhe objektiv të dënimit alternativ të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë e të pandehurit, e ka vlerësuar të ulët rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurit; personaliteti i të pandehurit, ku rezulton i padënuar më parë; pranimi i fajit nga i pandehuri, si dhe ndihma përmes përballimit të shpenzimeve për kurimin emergjent të viktimës së veprës penale, rrethana lehtësuese këto, që vlerësohet se tregojnë një sjellje shumë të mirë të të pandehurit pas kryerjes së veprës penale. Gjithashtu, subjekti ka vlerësuar faktin se i pandehuri kishte në përbërje familjare tre fëmijë, dy prej të cilëve të mitur, si dhe faktin se i pandehuri rezultonte i regjistruar si person fizik për ushtrimin e aktivitetit tregtar, ku ka të punësuar edhe dy shtetas të tjerë, me detyrime konkrete ndaj punës. Në të tilla rrethana, në referim të nenit 59/1 të Kodit Penal, ka vlerësuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim.

83.8 Nisur nga rrethanat e sipërcituara, në përfundim të bisedimeve, në datën 18.1.2022, subjekti, i pandehuri dhe mbrojtësi i zgjedhur prej tij ranë dakord mbi marrëveshjen mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe për caktimin e dënimit, duke konkluduar në mënyrë përfundimtare deklarinimin fajtor të të pandehurit L.M për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe dënimin me 3 vjet e 6 muaj burgim, si dhe veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, në gjendje të dehur dhe dënimin me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, pas bashkimit të dënimeve, në mënyrë përfundimtare i pandehuri L.M dënohet me 4 vjet burgim dhe, në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurit L.M dhe vënien në provë për një periudhë kohe prej 3 vjetësh e 6 muajsh. Gjithashtu, kanë rënë dakord që në aplikim të neneve 30/1/3 dhe 37 të Kodit Penal, i pandehuri L.M të dënohet edhe me dënimin plotësues, duke iu ndaluar të drejtojë automjete për një periudhë njëvjeçare, t’i shuhet masa e sigurimit “Arrestimi në burg”, caktuar me vendimin gjyqësor; si dhe të lirohet menjëherë i pandehuri L.M nga IEVP Sarandë.

83.9 Subjekti ka shpjeguar se pas nënshkrimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, me kërkesën e datës 18.1.2022 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke i kërkuar miratimin e kësaj marrëveshjeje, por kjo gjykatë ka vlerësuar se masa e dënimit nuk është e përshtatshme dhe ka vendosur të mos e miratojë atë.

83.10 Subjekti ka sqaruar se, pasi gjykata ka përcjellë aktet e çështjes, bazuar edhe në kërkesën e viktimës së veprës penale, Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e tij me një tjetër prokuror, rrethanë kjo që nuk është kundërshtuar nga subjekti. Subjekti ka prapësuar se, ashtu sikurse pasqyrojnë edhe aktet procedurale, në këtë moment nuk është administruar asnjë provë që të vijë në kundërshtim me konkluzionet e arritura më herët prej

tij, si në drejtim të evidentimit të rrethanave të faktit penal, konkluzioneve të akteve të ekspertimit mjekoligjor dhe atij autoteknik, ngritjes së akuzës dhe pranimi të fajit nga ana e të pandehurit, pasi në përfundim të gjyqimit, i cili u zhvillua me gjykim të shkurtuar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin datë 21.11.2022, ka dhënë të njëjtat lloje dënimi kryesor dhe atij plotësues, sikurse ishte materializuar në marrëveshjen e pranimi të fajësisë.

83.11 Subjekti ka prapësuar se qëndrimi i mbajtur në momentin e lidhjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe caktimit të dënimit përfaqëson një qëndrim korrekt të arritur vetëm mbi provat e administruara dhe vetëm mbi rrethanat e vërtetuara me anë shkresash se ekzistojnë. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se ankuesi A.K ka paraqitur ankesën edhe para Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili, pasi e ka marrë në shqyrtim, me vendimin nr. ***, datë 31.7.2023, ka vendosur arkivimin e saj, çka provon se të gjitha veprimet e kryera prej tij janë në zbatim korrekt të të gjitha normave penale dhe procedurale penale. Subjekti ka depozituar:

- vendimin nr. *** prot., datë 31.7.2023, të ILD-së, për arkivimin e ankesës;
- *email*-et e datave 5.1.2024 dhe 10.1.2024, ku konfirmohet se çështja penale nr. ***, viti 2021, është me status “përfunduar gjykimi në shkallë të parë”.

Vlerësimi i Komisionit

83.12 Trupi gjykues vlerëson se subjekti ka shpjeguar bindshëm arsyet në bazë të të cilave ka vendosur arritjen e një marrëveshjeje mbi kushtet e pranimi të fajësisë nga i pandehuri, si dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit, duke marrë në konsideratë edhe faktin se prokurori tjetër i cili ka zëvendësuar subjektin dhe ka vijuar hetimet e kësaj çështjeje, në përfundim ka dërguar çështjen në gjyq dhe gjykata me vendimin datë 21.11.2022 e ka dënuar përfundimisht të pandehurin me 2 vjet burgim (në aplikim të neneve 55 dhe 406/1 të Kodit Penal), si dhe me një dënim plotësues, duke e ndaluar të drejtojë automjetin për 1 vit. Komisioni evidenton se gjykata ka caktuar ndaj të pandehurit një masë dënimi më të ulët se ajo e propozuar nga subjekti përmes marrëveshjes mbi kushtet e pranimi të fajësisë, për dënimin e të pandehurit me 4 vjet burgim, duke përjashtuar mundësinë për favorizim të të pandehurit nga subjekti. Për rrjedhojë, në vlerësimin final lidhur me këtë çështje, trupit gjykues nuk i rezultuan *indicie* apo rrethana për fakte konkrete, të cilat të krijojnë bindjen se subjekti ka kryer shkelje ligjore.

84. Dy denoncime të shtetasit A.H¹⁵⁰

84.1 Ky shtetas ankohet ndaj prokurorit Ilir Hoxha për zvarritje të hetimeve prej 6 vitesh lidhur me çështjen penale nr. ***, viti 2017, për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”. Denoncuesi pretendon se çështja e tij është zvarritur sa në gjykatë dhe në prokurori, ku gjykata ia ka kthyer 3 herë çështjen prokurorit Ilir Hoxha për hetime të mëtejshme. Gjithashtu, denoncuesi pretendon se për këtë dosje nuk ka kryer njoftim për shtyrje të afatit në 5 vjet hetime.

84.2 Rrethanat e çështjes penale konsistojnë në një kallëzim penal të kryer në datën 19.1.2017 nga denoncuesi në ngarkim të sipërmarrësit O.B, ish-drejtorit të Ndërmarrjes së Ujësjellësit Sarandë, z. D.B, ish-kryetarit të Komunës, z. Dh.S.K, dhe ish-kryetarit të fshatit N, z. K.M, si dhe ndaj inxhinierëve të firmës, pasi nga punimet e kryera për ndërtimin e ujësjellësit kanë kryer veprime të paligjshme, duke i dëmtuar pronën private prej 5.000 m²,

¹⁵⁰ Denoncim nr. *** prot., datë 7.4.2022; denoncim nr. *** prot., datë 8.6.2023.

së bashku me truallin e shtëpisë. Kallëzuesi ankohet se kompania e drejtuar nga shtetasi O. B ka fituar tenderin për ndërtimin e ujësjellësit dhe nuk e ka zbatuar projektin e Bankës Botërore.

84.3 Nga verifikimi i dosjes penale:

- Duket se subjekti ka zvarritur hetimin, pasi ka kërkuar marrjen e dosjes penale nga Gjykata e Apelit Gjirokastër në datën 11.1.2022, rreth 6 muaj me vonesë nga data e dhënies së vendimit gjyqësor, datë 4.6.2021, nisur nga fakti se kjo gjykatë ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve.
- Nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin datë 4.6.2021, janë konstatuar mangësi në veprimet hetimore të subjektit, nga ku nuk është marrë një kopje e projektit të miratuar për ndërtimin e ujësjellës-kanalizimeve sipas urdhërimeve të gjykatës me vendimin datë 7.6.2019, si dhe nuk është kryer një analizë dhe vlerësim logjik i provave të reja.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

84.4 Subjekti ka parashtruar me detaje rrethanat e faktit penal, duke sqaruar se kjo çështje penale gjendet pranë gjyqtarit të seancës paraprake. Në lidhje me konstatimin e Komisionit për zvarritje të hetimit dhe marrjen e dosjes penale në datën 11.1.2022 nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, rreth 6 muaj me vonesë nga data e dhënies së vendimit, subjekti ka shpjeguar se ky vendim gjyqësor është administruar bazuar në kërkesën e parashtruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe vetëm pasi ai është vënë në dijeni të këtij vendimi nga kërkesa e shtetasit A.H, protokolluar me nr. **, datë 11.1.2022, i cili ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë kërkesën për përjashtimin e tij si prokuror i çështjes. Sipas subjektit, konstatimi për zvarritje të hetimit nuk përfaqëson një pasqyrim të saktë të realitetit dhe provave.

84.5 Në lidhje me konstatimin e Komisionit për moskryerje të veprimeve hetimore shteruese në lidhje me gjetjen e projektit të miratuar për ndërtimin e ujësjellës-kanalizimeve, subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se një projekt i një pune publike do të gjendet ose në institucionin që e ka hartuar atë, ose në institucionin që e ka administruar pas përfundimit të punës publike, që në këtë rast janë ose Banka Botërore, ose Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Sarandë, ku asnjëri prej tyre nuk e ka vënë në dispozicion: i pari ka refuzuar dhe i dyti nuk e ka administruar asnjëherë dhe nuk kishte se si ta vinte në dispozicion të hetimit. Subjekti vlerëson se në këtë pikë kanë qenë kërkime shteruese dhe pamundësi objektive të administrimit të projektit.

84.6 Subjekti ka shpjeguar se veprimet hetimore kanë qenë të tilla që e kanë çuar në administrimin e provave të mjaftueshme mbi bazën e të cilave ka kryer një vlerësim objektiv dhe të logjikshëm, duke dalë në përfundimin se në rastin konkret vërtetohet mosekzistenca e anës objektive dhe anës subjektive të figurës së veprës penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Ndaj, fakti i ndodhur nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Vlerësimi i Komisionit

84.7 Trupi gjykues, në analizë të akteve që pasqyrojnë veprimet hetimore, si dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerësoi se pretendimet e denoncuesit për zvarritje të hetimit prej

6 vitesh nuk mund të konsiderohen relevante, pasi duket se zgjatja e hetimeve për një kohë të gjatë nuk i dedikohet vetëm veprimtarisë hetimore të subjektit të rivlerësimit, por edhe prokurorit tjetër E. A, i cili ka hetuar fillimisht këtë çështje penale dhe, më pas, pas kthimit të çështjes dy herë nga gjykata, në qershor të vitit 2019 dosja i ka kaluar për hetime të mëtejshme prokurorit Ilir Hoxha.

84.8 Pavarësisht faktit të mësipërm, nga verifikimi i akteve në dosjen penale, si dhe në analizë të prapësimeve të subjektit, Komisioni sërish evidenton zvarritje të hetimeve nga subjekti për një periudhë gati 1 vit e 3 muaj, nga momenti i marrjes së dosjes në dorëzim në qershor të vitit 2019 deri në datën 8.10.2020, kur subjekti ka kërkuar në gjykatë pushimin e çështjes. Gjithashtu, nga kontrolli gjyqësor, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka evidentuar faktin se prokurori nuk ka kryer një analizë dhe vlerësim logjik dhe koherent të provave të reja, por ka paraqitur në gjykatë pa më të voglin ndryshim, kërkesën e përsëritur për pushimin e hetimeve me të njëjtën bazë ligjore. Gjithashtu, kjo gjykatë ka vënë në dukje edhe faktin se në kundërshtim me dispozitat ligjore, prokurori nuk ka kryer veprime hetimore shteruese në lidhje me gjetjen e projektit të miratuar për ndërtimin e linjave të ujësjellës-kanalizimeve, si dhe nuk është vlerësuar në mënyrën e duhur akti i ekspertit agronom, çka tregon moskryerje të detyrës nga ana e subjektit, duke afektuar në këtë mënyrë kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale sipas nënindikatoreve të parashikuar prej nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

85. Denoncim i shtetasës D.B¹⁵¹

85.1 Kjo shtetase referon disa çështje penale të hetuara nga prokurori Ilir Hoxha, duke u ankuar për shkelje flagrante të ligjit material dhe procedural. Denoncuesja pretendon se nga ana e prokurorit nuk ka asnjë veprim hetimor për të gjitha kallëzimet e kryera prej saj.

85.2 Komisioni ka kërkuar dosjet penale përkatëse nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë¹⁵², ku ka evidentuar se:

- *Materiali kallëzues nr. ***, datë 17.5.2017*, lidhet me një kallëzim të kryer në datën 16.5.2017 nga shtetasja D.B për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, pasi në pronën e saj në Borsh, me sipërfaqe 700 m², ka konstatuar vendosjen e një barake druri të ndërtuar nga një shtetas, i cili pretendonte se e kishte marrë me qira nga banori G.H (të cilit i ishte hequr titulli i pronësisë mbi këtë sipërfaqe me vendim gjyqësor). Lidhur me këtë çështje, subjekti në datën 13.6.2017 ka disponuar me vendim për mosfillimin e procedimit penal.
- *Materiali kallëzues nr. ***, datë 4.3.2022*, konsiston në një kallëzim penal të kryer në datën 27.2.2022 nga shtetasja D.B ndaj personelit të ASHK-së për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Falsifikimi kompjuterik”, pasi përmes veprimeve të tyre kanë pasqyruar gabim të dhënat kadastrale në pronën e saj. Lidhur me këtë çështje, prokurori Ilir Hoxha në datën 17.3.2022 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

85.3 Konstatime të Komisionit

¹⁵¹ Denoncim nr. *** prot., datë 3.8.2022.

¹⁵² Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2023.

- Nga verifikimi i dosjeve penale ka rezultuar se nuk është ndërmarrë asnjë veprim hetimor¹⁵³ nga ana e subjektit të rivlerësimit, ndaj dhe ka disponuar me vendim për mosfillimin e procedimeve.
- ✓ Lidhur me këtë konstatim, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

85.4 Lidhur me çështjen penale nr. ***, datë 17.5.2017, subjekti ka prapësuar se edhe nëse shtetas D.B i është shkatërruar prona, nuk vërtetohet ekzistenca e dashjes së shtetasit G.H për të shkatërruar pronën e saj. Për rrjedhojë, nuk krijohet bindja mbi ekzistencën e anës subjektive të veprës penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Sipas subjektit, në kushtet kur kallëzuesja pretendonte se në pronën e saj ishte vendosur një barakë e madhe druri nga banori G.H, u krijuan dyshime mbi ekzistencën e veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, e kryer minimalisht para datës 1.4.2016, data e lidhjes së kontratës së qirasë. Subjekti ka shpjeguar se në referencë të ligjit nr. 141/2016, “Për dhënie amnistie”, parashikohej pushimi i ndjekjeve penale për kallëzimet që ndodhen në këto organe, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, për veprat penale të kryera deri në datën 25.12.2016, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim në maksimum deri në 2 vjet, ose çdolloj dënimi tjetër më të butë. Për rrjedhojë, duke qenë se masa e dënimit e parashikuar në dispozitën e nenit 199/a/1 të Kodit Penal është “Me burgim deri në një vit”, për këtë veprë penale të kryer para datës 25.12.2016 është dhënë amnisti, rrethanë kjo që nuk lejonte fillimin e ndjekjes penale. Ndaj, në datën 13.6.2017, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

85.5 *Sa i përket çështjes tjetër penale nr. ***, datë 4.2.2022*, subjekti ka parashtruar rrethanat e faktit penal lidhur me kallëzimin e paraqitur nga shtetasit D.B dhe A.B mbi ekzistencën e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, ku objekti i kallëzimit të tyre kishte të bënte me veprimet e kryera nga personeli i ASHK-së, Drejtoria Vendore Sarandë, në regjistrimin e një prone të fituar me vendimin gjyqësor nr. **, datë 27.5.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se në kohën kur është kryer regjistrimi i pasurisë bazuar në vendimin gjyqësor (duke e marrë të mirëqenë një fakt të tillë, pasi kallëzuesit nuk i kanë bashkëngjitur kallëzimit të tyre asnjë akt të prodhuar nga ASHK Sarandë, që t’i përkasë regjistrimit të kryer), veprimtaria e ASHK-së normohej me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, hyrë në fuqi në datën 21.3.2019.

Subjekti ka shpjeguar se nisur nga pretendimi i kallëzuesve lidhur me gabimet në pasqyrimin e të dhënave në hartën kadastrale dhe regjistrimin e gabuar të vendndodhjes së pronës në një pronë tjetër disa kilometra larg, e cila është e një pronari tjetër, përfaqëson një gabim njerëzor, që parashikohet si mundësi ndodhjeje edhe nga neni 16 i ligjit nr. 111/2018, gabime të cilat janë lehtësisht të korigjueshme.

Subjekti ka argumentuar se këto gabime nuk përmbajnë elemente të “veprimeve a mosveprimeve” që vijnë “në kundërshtim me ligjin” apo që përbëjnë “mospërmbushje të rregullt të detyrës”, sipas përmbajtjes së dispozitës së nenit 248 të Kodit Penal.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ka vlerësuar se në rastin konkret provohet mosekzistenca e anës objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”,

¹⁵³ Përveç procesverbalit datë 13.6.2017 për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale (shtetasi F.H dhe procesverbalit datë 8.6.2017 për këqyrjen dhe marrjen e objektit.

parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ndaj, në datën 17.3.2022 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Subjekti thekson se këto vendimmarrje kanë qenë dhe janë produkt vetëm i bindjes së brendshme të krijuar nga analiza e të gjitha provave të administruara dhe, si të tilla, materializohen në aktin përkatës procedural.

85.6 Në lidhje me konstatimin e Komisionit për moskryerjen e veprimeve hetimore, subjekti i referohet vendimit unifikues penal nr. 2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, e cila, ndër të tjera, përcakton se rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Sipas subjektit, jo vetëm duke u bazuar në këto përcaktime të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por edhe në të gjithë praktikën e deritanishme mbi verifikimin e rrethanave të parashikuara në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale, ka vlerësuar në mënyrë objektive të gjitha provat që kallëzuesja ka vënë në dispozicion bashkëlidhur kallëzimeve të parashtruara, të cilat, pasi i ka ballafaquar me kuadrin ligjor në fuqi, ka vlerësuar se faktet e ndodhura nuk përmbajnë elementet përbërëse të ndonjë figure vepre penale, duke marrë kështu vendimet respektive për mosfillimin e procedimit penal.

Vlerësimi i Komisionit

85.7 Lidhur me prapësimet e subjektit se në vendimmarrjen e tij për mosfillimin e procedimit ka vepruar në zbatim të vendimit unifikues nr. 2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Komisioni çmon se, pavarësisht se në përmbajtje të këtij vendimi unifikues përcaktohet se rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thelluar, një konkluzion i tillë nuk përjashton organin e akuzës nga detyrimi për kryerjen e veprimeve hetimore me qëllim verifikimin e pretendimeve të ngritura nga kallëzuesi për kryerjen e një vepre penale, atëherë kur nga përmbajtja e fakteve objekt kallëzimi nuk rezulton në mënyrë të qartë dhe pa ekuivoke ekzistenca e rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal sipas përmbajtjes së nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale.

85.8 Komisioni konstaton mungesën e angazhimit të subjektit të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të çështjes, si dhe kryerjes së veprimeve verifikuese mbi bazën e kallëzimit të paraqitur prej këtij denoncuesi, veprime të cilat nuk evidentohet të jenë kryer nga aktet e dosjeve penale.

86. Denoncim i shtetasit J.D¹⁵⁴

86.1 Ky shtetas ankohet për prokurorin Ilir Hoxha për veprime të kundërligjshme, duke ndihmuar zaptuesit e pronave. Denoncuesi ka kryer një kallëzim penal në datën 25.5.2019 ndaj shtetasit B.G (K.G) për veprat penale të parashikuara nga nenet 150, 199, 199/a dhe 200 të Kodit Penal, me pretendimin se ky shtetas i ka pushtuar pronën e tij në Sarandë. Prokurori Ilir Hoxha ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili është kthyer nga gjykata në datën 29.10.2019. Denoncuesi pretendon se pas kthimit të dosjes nga gjykata, prokurori Ilir Hoxha prej 2 vitesh nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, duke ndihmuar zaptuesit e pronave, si dhe duke i cenuar denoncuesit të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm.

86.2 Komisioni ka administruar dosjen përkatëse penale nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë¹⁵⁵ lidhur me materialin kallëzues nr. ***, datë 28.5.2019, për veprat penale “Shpërdorimi i tokës”, “Ndërtimi i paligjshëm”, kryer në tokën e tjetrit dhe “Pushtimi i tokës”, të parashikuara nga nenet 199, 199/a/2 dhe 200 të Kodit Penal. Në

¹⁵⁴ Denoncim nr. ***prot., datë 29.9.2022.

¹⁵⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2023.

përfundim të veprimeve verifikuese, në datën 10.6.2019, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për këto vepra penale, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Kundër këtij vendimi, në datën 2.7.2019 ka ushtruar ankim av.A.H, përfaqësuesja e kallëzuesit J.D dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin nr. **, datë 29.10.2019, ka vendosur pranimin e ankimit, prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit, duke urdhëruar prokurorinë për regjistrimin e procedimit penal dhe të kryejë veprime hetimore. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë në datën 16.6.2020.

86.3 Nga verifikimi i dosjes penale duket se:

- Subjekti përmes urdhrit në datën 23.9.2020 ka vendosur delegimin e veprimeve hetimore tek oficeri i policisë gjyqësore sipas urdhërimeve të gjykatës, por nga aktet nuk evidentohet të jetë kryer asnjë veprim hetimor i deleguar, si dhe statusi aktual i këtij procedimi penal.
- ✓ Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

86.4 Subjekti ka shpjeguar se kjo çështje penale gjendet ende në fazën e hetimit paraprak. Subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e çështjes penale lidhur me materialin kallëzues nr. ***, datë 28.5.2019, për veprat penale “Shpërdorimi i tokës”, parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal, “Ndërtimi i paligjshëm”, kryer në tokë të tjetrit, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal, “Pushtimi i tokës”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal, si dhe “Kanosja për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal.

Në përfundim të veprimeve verifikuese, në datën 10.6.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë në datën 29.10.2019, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin datë 16.6.2020, ku është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal dhe kryerja e hetimeve të mëtejshme.

86.5 Subjekti ka shpjeguar se në zbatim të vendimit gjyqësor, në datën 30.7.2020 ka regjistruar procedimin penal dhe në datën 23.9.2020 ka deleguar kryerjen e veprimeve hetimore tek oficeri i policisë gjyqësore, konkretisht hetimin në lidhje me zërin kadastral të kësaj pasurie, mënyrën e ndërtimit nga shtetasi K.G në këtë pasuri, nëse është pushtuar kjo tokë nga ky shtetas, pyetja e institucioneve përkatëse si IKMT-ja, nëse ka vepruar ose jo administrativisht për këtë ndërtim në buzë të detit, caktimi i ekspertëve të fushës së ndërtimit për të përcaktuar çfarë veprimesh janë kryer nga shtetasi K.G në tokë të tij, të shtetit apo individit tjetër, a ka leje ndërtimi për këtë punim, si dhe pyetjen e kallëzuesve dhe të kallëzuarit në lidhje me këto rrethana fakti, si dhe hetimin në lidhje me kanosjen që pretendon shtetasja A.H.

86.6 Subjekti ka shpjeguar se këto veprime i ka deleguar pranë oficerit të policisë gjyqësore dhe, në momentin e transferimit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë në një prokurori tjetër, dosja e procedimit penal nr. *** të vitit 2020 është dorëzuar teksa gjendej në fazën e hetimit paraprak. Në të tilla rrethana, subjekti shpjegon se nuk mund të shprehet për ecurinë e mëtejshme të këtij procedimi penal dhe njëkohësisht nuk mund të vërë në dispozicion kopje dokumentacioni të fashikullit të procedimit penal në fjalë.

Vlerësimi i Komisionit

86.7 Trupi gjykues konstaton mangësi të hetimit nga ana e subjektit, konfirmuar kjo edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe ajo e Apelit, e cila ka evidentuar se nga ana e prokurorit nuk është vendosur drejt në bazë të ligjit dhe nuk është kryer një hetim paraprak minimal, por është mjaftuar vetëm me procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes të bërë nga policia gjyqësore, nuk ka hetuar fare për veprat penale të parashikuara nga nenet 199/a/2, 200 dhe 237 të Kodit Penal, duke dalë në konkluzion *apriori*.

86.8 Në prapësimet e tij, subjekti nuk depozitoi dokumentacion provues lidhur me veprimet hetimore të kryera në zbatim të urdhërimeve të Gjykatës së Apelit të datës 16.6.2020, duke mos provuar të kundërtën e barrës së provës. Shpjegimi i subjektit se ka deleguar veprimet hetimore tek oficeri i policisë gjyqësore në datën 23.9.2020 dhe më pas është transferuar në prokurori tjetër, duke e dorëzuar dosjen në fazën e hetimit paraprak, konfirmon mungesën e hetimit të kësaj çështjeje penale për një periudhë rreth 3-vjeçare, nga muaji shtator 2020 kur janë deleguar veprimet tek OPGJ-ja deri në shtator 2023, kur subjekti është transferuar me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur hetimin e kësaj çështjeje penale.

87. Denoncim i shoqërisë tregtare “R” sh.p.k.¹⁵⁶

87.1 Kjo shoqëri kërkon verifikimin e veprimeve hetimore të prokurorit Ilir Hoxha në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2019, në ngarkim të shtetasit B.K, për veprat penale “Dhunimi i banesës” dhe “Vetëgjyqësia”.

87.2 Denoncuesi pretendon se që prej vitit 2013 është pronar i një apartamenti, të cilin e ka blerë nga shoqëria “M” sh.p.k., por ky apartament posedohej nga shtetasi B.K, i cili nuk kryente asnjë veprim për lirimin e tij. Denoncuesi pretendon se prej 3 vitesh nuk ka dijeni për ecurinë e çështjes, ku gjithashtu ka paraqitur pranë prokurorit një kërkesë memorie, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Pasi është interesuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në datën 26.9.2022 prokurori Ilir Hoxha ka informuar se çështja është dërguar në gjykatë për gjykim në ngarkim të shoqërisë “M” sh.p.k. dhe administratorit të saj për mashtrim, ndërsa e ka konsideruar shtetasin B.K viktimë të kësaj vepre penale.

87.3 Nga verifikimi i dosjes penale ka rezultuar se:

- Ka zvarritje të veprimeve ¹⁵⁷ hetimore, ku evidentohet se subjekti ka vendosur/disponuar 4 herë me vendim¹⁵⁸ për zgjatje të afatit të hetimeve, duke mos dhënë arsyet e zgjatjes së afateve hetimore.

¹⁵⁶ Denoncim nr. *** prot., datë 21.10.2022.

¹⁵⁷ Nga prill 2020 në prill 2022, ku duket se nga ana e subjektit nuk është ndërmarrë asnjë veprim hetimor.

¹⁵⁸ 1) Në datën 13.7.2021, subjekti ka disponuar me vendim për zgjatjen e afatit (deri më 13.10.2021) për shkak të pamundësisë objektive për përfundimin e hetimeve. 2) Në datën 13.10.2021, subjekti ka disponuar me vendim për zgjatjen e afatit (deri më 13.1.2022) me të njëjtin argument sa më sipër. 3) Në datën 13.1.2022, subjekti ka disponuar me vendim për zgjatjen e afatit (deri më 13.4.2022), me argumentin se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin datë 14.4.2022 ka rrëzuar kërkesën e tij për caktimin e masës së sigurimit, vendim ky i cili pas ankimit të prokurorit ka ndryshuar nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër, datë 6.5.2021, dhe për arsye të mosekzekutimit të këtij vendimi dhe mosmarrjes së deklarimeve nga shtetasi D. M është zgjatur afati i hetimit. 4) Në datën 13.4.2022, subjekti ka disponuar me vendim për zgjatjen e afatit (deri më 13.7.2022) me të njëjtin argument sa më sipër.

- Subjekti ka kryer njoftimin e të pandehurit dhe kallzuesit B.K për përfundimin e hetimeve, por nuk evidentohet të ketë njoftuar edhe shoqërinë “R” sh.p.k., e cila gjithashtu është palë kallzuese në këtë proces penal.
 - Në dosje mungon akti i njoftimit të shoqërisë “R” sh.p.k. lidhur me vendimin e subjektit, datë 27.12.2019, për pushimin e çështjes për veprën “Vetëgjyqësia”.
 - Subjekti nuk e ka informuar shoqërinë “R” sh.p.k. lidhur me ecurinë e hetimeve, edhe pse kishte paraqitur disa kërkesa pranë organit të Prokurorisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme¹⁵⁹.
- ✓ Lidhur me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime, si dhe statusi aktual i këtij procedimi, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

87.4 Subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat e çështjes penale dhe ka sqaruar se kjo çështje gjendet në shqyrtim gjyqësor. Lidhur me zgjatjet e afateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se çështja e procedimit penal nr. ***, viti 2019, është regjistruar në datën 21.6.2019, fillimisht për veprën penale “Mashtrimi”, me pasoja të rënda në dëm të shtetasit B.K, e cila i është atribuar personit juridik shoqëria “M” sh.p.k. dhe shtetasit D.M, emrat e të cilëve janë regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale në datën 13.4.2021. Sipas subjektit, e gjithë kjo periudhë kohore 21.6.2019 – 13.4.2021 ka shërbyer për administrimin e të gjitha provave, kryerjen e ekspertimit teknik, mbi bazën e të cilave është konkluduar që me akt të veçantë vepra penale t’u atribuohet personit juridik, shoqëria “M” sh.p.k. dhe shtetasit D.M.

87.5 Në vijim janë kryer veprime procedurale, që konsistojnë në kërkimin për caktimin ndaj shtetasit D.M të masës së sigurimit “Arrest në burg”, masë kjo e miratuar nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër me vendimin datë 6.5.2021, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë nuk e miratoi këtë kërkim të prokurorit, masë sigurimi e cila ende nuk është ekzekutuar.

Subjekti ka shpjeguar se mosekzekutimi i kësaj mase nuk ka bërë të mundur marrjen e deklarimeve nga shtetasi D.M, të cilit i atribuohet vepra penale dhe kështu, për shkaqe të pavarura nga vullneti i prokurorit, hetimet për këtë procedim penal nuk kanë mundur të përfundohen brenda afatit. Në pamundësi të gjetjes së të pandehurit D.M dhe pasi nëpërmjet aktit datë 25.5.2022 është urdhëruar shpallja në kërkim ndërkombëtar, subjekti ka konkluduar që hetimet për këtë procedim penal të përfundojnë në mungesë të këtij të pandehuri. Subjekti ka shpjeguar se në rastin konkret kanë qenë arsyet objektive ato të cilat nuk kanë mundur të përfundimin e hetimeve paraprake brenda një afati të shkurtër kohor.

87.6 Në përfundim të hetimeve, në datën 9.5.2022 i është drejtuar gjykatës për dërgimin për gjykim të çështjes në ngarkim të të pandehurve, shoqëria “M” sh.p.k. dhe shtetasit D.M. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj çështjeje, gjykata ka vendosur ndarjen e çështjeve, duke vendosur pezullimin e gjykimit ndaj të pandehurit D.M për shkak të mosgjetyes së tij dhe dërgimin për gjykim të çështjes ndaj personit juridik, shoqëria “M” sh.p.k. Subjekti përmes prapësimeve të datës 10.1.2024 ka depozituar:

- vendimin gjyqësor nr. ***, datë 17.1.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila ka pranuar kërkesën për dërgimin në gjyq të të pandehurve;

¹⁵⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2020 dhe shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar për kompetencë kërkesat e kallzuesit, datë 13.10.2021, datë 20.1.2020 dhe datë 24.1.2020.

- informacionin mbi çështjen e nxjerrë elektronikisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, ku evidentohet se kjo çështje deri në datën 23.11.2023 është në fazë gjykimi.

87.7 Lidhur me pushimin e hetimeve për veprën penale “Vetëgjyqësia”, subjekti ndër të tjera ka shpjeguar se shoqëria “R” sh.p.k. ka depozituar një kallëzim penal, mbi bazën e të cilit në datën 6.9.2019 është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2019, për kundërvajtjen penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, procedim ky që është bashkuar me procedimin penal të sipërpërmendur nr. ***, viti 2019. Subjekti sqaron se vendimmarrja për këtë bashkim të procedimeve është marrë nga një tjetër prokuror. Në lidhje me kundërvajtjen penale “Vetëgjyqësia”, subjekti ka argumentuar se nga aktet shkresore të dokumentuara ka rezultuar e provuar se posedimi nga shtetasi B.K i apartamentit është kryer bazuar në një akt noterial “Kontratë premtim shitjeje” të datës 13.2.2012 të lidhur me shoqërinë “M” sh.p.k., rrethanë kjo që përbën jo vetëm një posedim të ligjshëm, por edhe të realizuar kohë përpara se kjo shoqëri të posedonte dokumentin certifikatë e pronësisë. Ndaj, në rastin konkret provohej mosekzistenca e anës objektive të figurës së kundërvajtjes penale “Vetëgjyqësia” dhe në datën 27.12.2019 ka vendosur pushimin e hetimeve.

87.8 Sa i përket njoftimit të vendimit të pushimit, subjekti ka shpjeguar se ashtu si në çdo akt procedural, edhe tek vendimi i datës 27.12.2019, në pikat nr. 2, 3 dhe 4 të tij, ka vendosur që të njihen me këtë vendim të interesuarit, duke ngarkuar zyrën e sekretarisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për ekzekutimin e urdhërimit të tij. Ndaj, subjekti vlerëson se realizimi i njoftimit të palëve me këtë akt procedural është detyrë vetëm e administratës së organit të Prokurorisë, të cilëve u është ngarkuar kjo detyrë jo vetëm nga kjo vendimmarrje, por edhe nga rregullorja e brendshme e institucionit të Prokurorisë. Ndërsa në rastin konkret mban mend që oficerit të policisë gjyqësore, të cilit i ishte deleguar kryerja e veprimeve hetimore, në mënyrë verbale i është ngarkuar njoftimi i shoqërisë kallëzuese.

87.9 Në lidhje me mosnjoftimin e shoqërisë “R” sh.p.k. mbi ecurinë e procedimit, subjekti ka shpjeguar se për shkak të kohës që ka kaluar, nuk është në gjendje të shpjegojë në lidhje me shkaqet e mosdhënies së këtij informacioni shoqërisë “R” sh.p.k.

Vlerësimi i Komisionit

87.10 Komisioni, në analizë të prapësimeve të subjektit, pavarësisht shpjegimeve të tij, evidenton se vendimet e disponuara prej tij për zgjatje të afatit janë të paarsyetuara dhe nuk justifikohen me kryerje të hetimeve shtesë, për të përlligjur këto vendimmarrje.

87.11 Lidhur me mosnjoftimin e kallëzuesit “R” sh.p.k. për vendimin e pushimit të çështjes, subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, me pretendimin se kjo është detyrë e sekretarisë. Trupi gjykues sjell në vëmendje se në dispozitat procedurale penale, konkretisht neni 134 i Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se njoftimi i akteve të prokurorit kryhet nga policia gjyqësore dhe sekretaria, por është detyrë e prokurorit të ndjekë zbatimin e urdhërimit për njoftimin e palëve, si dhe të orientojë për kryerjen e veprimeve të nevojshme. Në rastin konkret, shpjegimi i subjektit se sekretaria gjyqësore kishte detyrimin të njoftonte vendimin dhe jo prokurori, vlerësohet prej trupit gjykues pa relevancë, për sa kohë që në vendimin e prokurorit është bërë shënimi “Me këtë vendim të njoh të interesuarit”, pa u identifikuar se cilët ishin ata. Sekretaria gjyqësore ka për detyrë të zbatojë urdhërimet e prokurorit kur ato janë të qarta dhe të identifikueshme, ajo nuk mund të marrë një rol aktiv në identifikimin e shtetasve që kanë statusin e të interesuarit, sipas asaj që prokurori kishte

disponuar në vendim. Për pasojë, pretendimi se kjo detyrë i takonte sekretarisë gjyqësore dhe jo subjektit të rivlerësimit, u konsiderua i pambështetur në ligj. Kjo mangësi procedurale në veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit i ka mohuar kallëzuesit, shoqërisë “R” sh.p.k., aksesin në organet e drejtësisë, për të realizuar mbrojtjen e interesave të ligjshëm në hapat e mëtejshëm proceduralë, duke i pamundësuar për të ushtruar të drejtën e ankimit dhe duke evituar në këtë mënyrë kontrollin e ligjshmërisë së akteve të prokurorisë. Gjithashtu, në prapësi, subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës sa i përket njoftimit të kallëzuesit për ecurinë dhe përfundimin e hetimit.

87.12 Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se për këtë procedim penal subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e shkeljes së nenit 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, pasi njoftimi i vendimmarrjes së prokurorit si veprimtari e rëndësishme e procedurave hetimore duket se është cenuar.

88. Denoncim i shtetasit G.A¹⁶⁰

88.1 Ky shtetas ankohet për prokurorin Ilir Hoxha, sepse nuk e ka informuar për ecurinë e kallëzimit të tij të datës 29.12.2022, pasi një grup personash kishin sulmuar dhe shkatërruar banesën dhe për këtë çështje denoncuesi nuk kishte informacion prej 6 muajsh. Denoncuesi pretendon për një zvarritje të qëllimshme të çështjes, për të prishur provat dhe pushuar çështjen.

- ✓ Lidhur me pretendimet e denoncuesit, subjektit iu kërkuan shpjegime të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

88.2 Subjekti ka sqaruar se kjo çështje i referohet procedimit penal nr. * të vitit 2023, regjistruar në datën 12.1.2023, e cila gjendet ende në fazën e hetimit paraprak. Subjekti ka parashtruar rrethanat e faktit penal, duke shpjeguar se për këtë çështje është kryer këqyrja e vendit të ngjarjes në banesën e shtetasit G.A, marrja e provave materiale, të cilat u dërguan pranë Institutit të Policisë Shkencore Tiranë për t’iu nënshtruar ekzaminimit daktiloskopik vlerësues. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se referuar aktit të ekspertimit daktiloskopik vlerësues nr. ***, datë 12.1.2023, nuk kanë rezultuar gjurmë papilare të vlefshme për identifikim. Gjithashtu, gjatë hetimit janë marrë deklarime nga shtetasi M.A lidhur me rrethanat e ngjarjes, i cili ka deklaruar se ka dëgjuar zhurma sikur ziheshin dhe, pasi telefoni shokun e tij Xh.P për ta pyetur, ai i është përgjigjur se po i ndjek njëri nga mbrapa, sepse i hodhën fishekzjarrë afër shtëpisë.

88.3 Në lidhje me këtë fakt, pasi janë kryer veprimet e para hetimore, në datën 12.1.2023 është regjistruar procedimi penal nr. * i vitit 2023 për kundërvajtjen penale “Prishja e qetësisë publike”, kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, në dëm të shtetasit G.A, e cila i është atribuar shtetasit Xh.P, emri i të cilit është regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale në datën 12.1.2023. Subjekti ka sqaruar se nëpërmjet vendimit përkatës të datës 10.2.2023 veprimet hetimore për këtë procedim i janë deleguar oficerit të policisë gjyqësore në Komisaratin e Policisë Sarandë, z. E.C dhe, pasi ky oficer në bazë të urdhrin nr. ***, datë 24.3.2023, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është transferuar në një detyrë dhe komisarjat tjetër, nëpërmjet vendimit përkatës të datës 27.4.2023, veprimet hetimore për

¹⁶⁰ Denoncim nr. *** prot., datë 27.6.2023.

këtë procedim penal i janë deleguar oficerit të policisë gjyqësore në Komisaratin e Policisë Sarandë, z. R.K.

88.4 Subjekti ka shpjeguar se pas transferimit të tij në një prokurori tjetër dosja e procedimit penal është dorëzuar teksa gjendej në fazën e hetimit paraprak. Në të tilla rrethana, subjekti deklaron se nuk mund të shprehet për ecurinë e mëtejshme të këtij procedimi penal dhe njëkohësisht nuk mund të paraqesë dokument mbështetës. Subjekti ka sqaruar se në kujtesën e tij nuk i rezulton ndonjë kërkesë e shtetasit G.A për dhënie informacion mbi gjendjen e procedimit. Subjekti pretendon se pretendimet e ankuesit G.A nuk kanë asnjë bazë reale.

Vlerësimi i Komisionit

88.5 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka dhënë sqarime të hollësishme në lidhje me veprimtarinë hetimore të kryer nga prej tij për hetimin e kësaj çështjeje penale. Trupi gjykues i çmon bindëse shpjegimet e subjektit, i cili duket se ka vepruar në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

89. Denoncim i shtetasit K.R¹⁶¹

89.1 Ky shtetas ankohet për subjektin e rivlerësimit Ilir Hoxha, me pretendimin se prokurori nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, nuk ka zbatuar urdhërimet e gjykatës, ka shkelur ligjin, pasi ka komunikuar drejtpërdrejt me të si kallëzues për të pushuar çështjen, ka kryer në fshehtësi veprime korruptive për të pushuar dhe zvarritur çështjen, si dhe ka konsumuar veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Korrupsioni” dhe “Mashtrimi”. Denoncuesi referon dy çështje penale të hetuara nga prokurori Ilir Hoxha, ku nga dokumentacioni i paraqitur prej tij ka rezultuar se:

- *Materiali kallëzues nr. ***, datë 27.9.2019*, bazuar në kallëzimin e kryer nga denoncuesi ndaj shtetasve A.H, L.E, ish-drejtuesit dhe punonjësve të ZVRPP-së Sarandë, dhe noterit publik A.L për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi” e “Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara”. Sipas këtij materiali, kallëzuesi K.R ka një shtëpi banimi, të cilën e ka në proces legalizimi, por shtetasi A.H nuk e lejon të gëzojë pronën e tij dhe po pengon procedurat e legalizimit, pasi pretendon se kjo shtëpi është përfituar prej tij nga privatizimi i banesave shtetërore. Pas një sërë procesesh gjyqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin datë 15.1.2018 ka vendosur të shpallë të falsifikuara dokumentet e privatizimit, në bazë të të cilave shtetasi A.H pretendon pronësinë. Për këtë çështje prokurori Ilir Hoxha në datën 10.10.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë në datën 24.6.2020, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit dhe vazhdimin e hetimeve sipas urdhërimeve të gjykatës.
- *Materiali kallëzues nr. ***, viti 2022*, në bazë të kallëzimit të denoncuesit të kryer në datën 13.6.2022, ndaj ish-drejtuesve dhe punonjësve të Drejtorisë së ALUIZNI-t dhe ASHK-së Sarandë, drejtueses së ASHK-së znj. A.D dhe shtetasit A.H, për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Korrupsionit aktiv e pasiv”, si dhe “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”. Për këtë çështje, prokurori Ilir Hoxha në datën 24.6.2022 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Denoncuesi

¹⁶¹ Denoncim nr. *** prot., datë 11.10.2023.

ankohet se edhe për këtë çështje prokurori ka shkelur ligjin penal material dhe procedural, duke mos kryer asnjë veprim hetimor, duke i kërkuar kallëzuesit që të heqë dorë nga çështja, pasi do të ndërhynte tek drejtoresha e ASHK-së për t'i përfunduar procedurat e legalizimit të objektit në emrin e tij.

89.2 Nga hetimi i Komisionit:

- Lidhur me materialin kallëzues nr. ***, viti 2019, referuar vendimit gjyqësor, duket se subjekti nuk ka kryer veprime hetimore, në bazë të të cilave ka vendosur mosfillimin e procedimit. Gjithashtu, nuk evidentohet statusi aktual i këtij procedimi, nëse subjekti ka regjistruar procedimin penal në zbatim të vendimit gjyqësor dhe nëse i ka kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga gjykata.
- Për materialin kallëzues nr. ***, viti 2022, subjekti në vendimin e mosfillimit ka analizuar elementet e veprave penale, por nuk ka evidentuar veprime konkrete hetimore të kryera, në bazë të të cilave ka vendosur mosfillimin e procedimit.
- ✓ Në lidhje me këto konstatime dhe pretendimet e denoncuesit, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Prapësimet e subjektit të rivlerësimit

89.3 Në prapësime, subjekti ka sqaruar se këto çështje penale gjenden ende në fazën e hetimit paraprak. Lidhur me procedimin penal nr. ***/2020, subjekti ka parashtruar rrethanat e çështjes penale, për të cilën në datën 10.10.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me argumentin se deri në momentin e parashtrimit të kallëzimit penal, në datën 27.9.2019, vendimi gjyqësor i datës 24.12.2018, i cili kishte shpallur si të falsifikuara aktet, nuk kishte marrë ende formë të prerë. Për rrjedhojë, subjekti ka vlerësuar se ekzistenca e kësaj rrethane nuk lejonte fillimin e ndjekjes penale, ndaj bazuar në nenin 290/1/e të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim shtetasi K.R, i cili është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin datë 24.6.2020, duke urdhëruar organin e akuzës të regjistrojë procedim penal dhe vazhdojë hetimet. Subjekti ka sqaruar se nuk ka kryer ankim kundër këtij vendimi.

89.4 Subjekti ka shpjeguar se në zbatim të vendimit gjyqësor, në datën 13.10.2020 ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2020 për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, si dhe po në këtë datë ka deleguar kryerjen e veprimeve hetimore tek oficeri i policisë gjyqësore, sipas urdhërimeve të gjykatës. Subjekti ka shpjeguar se, duke qenë se oficeri i policisë gjyqësore i ngarkuar me kryerjen e veprimeve hetimore është transferuar në një detyrë tjetër, ka vendosur t’i përmbyllë veprimet hetimore të domosdoshme për ecurinë e këtij procedimi penal. Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se ka kërkuar informacion pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë në lidhje me faktin nëse pranë kësaj gjykate administrohen dokumentet e rezultuara të falsifikuara gjatë këtij procesi gjyqësor, si dhe në cilën shkallë të gjyqësorit gjendet aktualisht fashikulli i çështjes gjyqësore. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se përmes vendimit të datës 18.7.2023 ka urdhëruar sekuestrimit me cilësinë e provës materiale të dokumentacionit arkivor të pasurisë së paluajtshme pranë ASHK-së Drejtoria Rajonale Sarandë, duke ngarkuar me këtë detyrë oficerin e policisë gjyqësore.

89.5 Subjekti sqaron se teksa çështja gjyqësore civile gjendej për shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë, përmes vendimit datë 13.7.2023 ka urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore për

këqyrjen e fashikullit të çështjes gjyqësore, administruar pranë kësaj gjykate, me qëllim evidentimin e faktit nëse në këtë proces gjyqësor civil janë depozituar dokumentet e konstatuara si të falsifikuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe në çfarë gjendjeje paraqiten këto dokumente (origjinale, të njësuara me origjinalin apo fotokopje e thjeshtë). Po ashtu, nëpërmjet vendimit datë 13.7.2023 ka urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore për sekuestrimin në cilësinë e provës materiale të dokumentacionit origjinal të administruar, fashikullin e çështjes gjyqësore. Subjekti sqaron se në momentin e transferimit të tij në një prokurori tjetër, dosja e procedimit penal nr. *** e vitit 2020 është dorëzuar tekta gjendej në fazën e hetimit paraprak. Në të tilla rrethana nuk mund të shprehet për ecurinë e mëtejshme të këtij procedimi penal.

89.6 Lidhur me materialin kallëzues nr. ***, datë 13.6.2022, subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar rrethanat dhe faktet e çështjes penale mbi ekzistencën e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, si dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”. Për secilën nga këto vepra penale, subjekti ka analizuar elementet e figurave të veprave penale, duke shpjeguar se në përfundim ka vlerësuar se fakti i ndodhur, për të cilin është ushtruar kallëzim penal, nuk përmban elementet e asnjërës prej figurave të veprave penale për të cilat është ushtruar kallëzim penal. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 290/1/ç të Kodit të Procedurës Penale, në datën 24.6.2022 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

89.7 Subjekti rithekson se çdo vendimmarrje e tij është bazuar vetëm në bindjen e krijuar nga marrja në analizë objektive e të gjitha provave të administruara. Sipas subjektit, çdo vendimmarrje u është bërë me dije palëve, të cilat kanë të drejtë të ushtrojnë ose jo ankim ndaj vendimit të tij. Edhe në rastin konkret, vendimi i datës 24.6.2022 për mosfillimin e procedimit penal nuk është ankimuar nga shtetasi K.R, jo se është ndalur prej subjektit, por për shkaqe të pavarura nga subjekti.

Vlerësimi i Komisionit

89.8 Subjekti përmes prapësimeve ka shpjeguar në mënyrë të hollësishme veprimet hetimore të kryera prej tij, në zbatim të urdhërimeve të gjykatës me vendimin e datës 24.6.2020, por nuk ka paraqitur dokumentacion provues. Komisioni evidenton faktin se gjykata e rrethit gjyqësor përmes vendimit datë 24.6.2020 ka konstatuar se nga ana e prokurorit nuk është kryer asnjë veprim hetimor sipas ligjit procedural penal, nuk ka marrë në pyetje kallëzuesin, nuk ka marrë asnjë informacion për ecurinë e çështjes gjyqësore civile dhe, për rrjedhojë, edhe vendimi i tij është i cenusshëm në këtë rast, në kundërshtim të plotë me parashikimin e nenit 291, pikat 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale.

89.9 Lidhur me çështjen penale nr. ***, datë 13.6.2022, Komisioni konstaton se subjekti nuk arriti të provojë veprimet hetimore të kryera në kuadër të këtij materiali kallëzues, përveçse kryerjes së një analize të elementeve të figurës së veprave penale. Komisioni vëren se subjekti as në prapësime dhe as në vendimin e tij të mosfillimit nuk ka cituar asnjë veprim konkret hetimor të kryera me qëllim verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit, ku mungon një analizë e fakteve që kanë rezultuar nga provat e mbledhura gjatë hetimit.

89.10 Komisioni konkludon se nga ana e subjektit nuk janë ndërmarrë veprime hetimore verifikuese dhe nuk është hetuar për rrethanat e çështjes, me qëllim verifikimin e kushteve për ekzistencën e veprave penale të pretenduara nga kallëzuesi.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

90. Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, në tërësi, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:

- Ka shfaqur mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore, në mënyrë të përsëritur, si dhe zgjatje të afateve të hetimit pa arsye.
- Nuk ka ndërmarrë veprime konkrete hetimore për verifikimin e fakteve dhe rrethanave për disa prej çështjeve penale, të konfirmuara këto edhe nga kontrolli gjyqësor.
- Në disa raste evidentohet mungesë e njoftimit të palëve lidhur me vendimmarrjet e tij, të cilat në dukje kanë cenuar paanshmërinë e magjistratit.
- Është shoqëruar me persona të proceduar penalisht/të dënuar për vepra të ndryshme penale, duke cenuar indikatorin e etikës lidhur me sjelljen e magjistratit jashtë funksionit.

90.1 Nga vlerësimi tërësor i kriterit profesional janë konstatuar mangësi dhe problematika, por trupi gjykues vlerëson se ato nuk janë deri në atë masë që të plotësojnë parashikimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve, mbështetur në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se pavarësisht se nuk u vlerësua që problematikat e konstatuara për secilin komponent përbëjnë më vete shkak për shkarkim nga detyra, por duke u analizuar në tërësinë e tyre, në vlerësim përfundimtar, konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia, nisur nga faktet se: (i) subjekti rezulton me mungese burimesh financiare në shumën rreth 3.2 milionë lekë, të cilat meqënëse janë para detyrës, nuk konsiderohen si shkak i vetëm për shkarkim; (ii) subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën Vetting; (iii) lidhur me kriterin e aftësive profesionale, të paktën në nëntë dosje janë konstatuar probleme proceduriale; (iv) si dhe të paktën në një rast është konstatuar shoqërimi i subjektit me persona me precedente penale, fakt për të cilin ka patur dijeni, duke cenuar sjelljen jashtëgjyqësore të magjistratit.

Këto rrethana, të marra së bashku, në vlerësimin të të tria kritereve, subjekti me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, duke sjellë për pasojë aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të pikës 2 të nenit 4, pikës 1, shkronja “c”, nenit 58, pika 2 e nenit 59 dhe të pikës 5 të

nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ilir Hoxha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 22.1.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Suela ZHEGU
Relatore

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha